RAPORT I GJENDJES SË NATYRËS 2006 - 2007

MINISTRIA E MJEDISIT
DHE PLANIFIKIMIT
HAPSINOR

gtz

AGJENCIA E KOSOVËS
PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT
AKMM

AGJENCIA E KOSOVËS PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

RAPORT
I GJENDJES SË NATYRËS

2006 - 2007

Prishtinë 2008

Të nderuar lexues,
dashamirës të natyrës...

Njeriu dhe natyra kanë bashkëjetuar në harmoni të plotë që nga epokat parahistorike, duke qenë gjithmonë pjesë të pandashme. Breza të tërë të njerëzimit kanë mbijetuar duke i shfrytëzuar të mirat e natyrës dhe duke i përdorur ato në mënyrë të drejtë. Pyjet, kullosat, burimet ujore, kafshët dhe bimët kanë luajtur rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.

Fatkeqësisht, brezi i njeriut të epokës moderne, më shumë se kurrë më parë është duke ndikuar në prishjen e baraspeshës ekologjike të natyrës në planetin tonë. Shkatërrimi i pyjeve, fragmentimi i habitateve, shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore janë vetëm disa prej aktiviteteve të njeriut, pasojat e të cilave tani më janë evidente. Si asnjëherë më parë, numri i llojeve që zhduken dhe atyre që kërcënohen për zhdukje është duke marrë përmasa alarmante. Zvogëlimi i resurseve ujore, zgjerimi i thatësisë, katastrofat natyrore, shkrirja e akullnajave polare, janë vetëm disa prej manifestimeve të ndryshimeve klimatike që sot po i ndjejmë në secilën pjesë të globit.

Përkundër faktit se gjeneratat e tanishme kanë nevoja të shumta për t'i plotësuar kërkesat e tyre, është obligim moral që gjeneratave të ardhshme të ju lëmë në trashëgim një natyrë po aq të pasur e të larmishme siç e kemi trashëguar ne nga paraardhësit tanë. Është në ndërgjegjen e njeriut të sotëm të mendoj për të ardhmen e brezave që do vijnë, është në dorën tonë të vendosim për fatin e shumë specieve që kërcënohen për zhdukje. Andaj, është koha e fundit që veprimet tona t'i orientojmë në dobi të natyrës dhe të ardhmes së planetit tonë.

Edhe pse mbrojtja e biodiversitetit konsiderohet njëra prej sfidave më të mëdha me të cilat po përballet njerëzimi sot, ne duhet menduar se çdo qenie e gjallë e këtij globi ka rëndësinë dhe të drejtën për të ekzistuar, ashtu si edhe vetë njeriu.

Kosova edhe pse është një vend i vogël në hartën e globit, karakterizohet me natyrë të pasur, me peizazhe, botë të larmishme bimore dhe shtazore. Edhe vlerat e trashëgimisë sonë natyrore po përballen me presionin e vazhdueshëm nga shfrytëzimi i pakontrolluar dhe i pa planifikuar.

Përkundër kësaj, orientimi ynë është që të intensifikojmë përpjekjet për ruajtjen dhe konservimin e këtyre vlerave të rralla natyrore. Duke hartuar politika efikase për mbrojtjen e natyrës, duke rritur sipërfaqet e zonave të mbrojtura, duke ngritur cilësinë e menaxhimit të këtyre zonave, duke mbrojtur llojet e rralla bimore dhe shtazore dhe duke mbrojtur pyjet, ne përmbushim obligimin që gjeneratave pasardhëse t 'u japim rastin t'i shijojnë vlerat e rralla natyrore të Kosovës.

Ilir Morina,
Kryeshef i AKMM-së

RAPORT I GJENDJES SË NATYRËS
2006- 2007

Botues:
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Raportin e përgatitën:
Ylber Sherifi, shef i sektorit për mbrojtjen e natyrës
Afrim Berisha, shef i sektorit për raporte dhe progr. mjedisore
Qenan Maxhuni, zyrtar për biodiversitet
Fadil Bajraktari, zyrtar për zona të mbrojtura

Këshilli redaktues:
Ylber Sherifi,
Sabit Restelica,
Rizah Hajdari,
Tomor Qela

Lektor:
Tone Buzhala-Gashi

Dizajni:
Design House

Ballina:
Ylber Sherifi
Foto nga Faqja e parë dhe e fundit, Parku Nacional “Mali Sharr”

U shtyp në shtypshkronjën:
designhouse

Katalogimi në botim- (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

Hyrje

Ky raport është përgatitë nga Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, me qëllim të informimit dhe sensibilizimit të publikut dhe institucioneve për gjendjen e natyrës.

Gjatë periudhës së pasluftës Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës vazhdimisht ka monitoruar gjendjen e natyrës, veçanërisht zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin. Nga këto raporte janë konstatuar probleme në terren si dhe janë rekomanduar masat për tejkalimin e tyre.

Po ashtu është punuar edhe në evidentimin e zonave të reja të natyrës dhe procedimin për marrjen nën mbrojtje ligjore të tyre. Njohja dhe evidentimi i vlerave të reja të natyrës ka përfunduar në 16 Komuna të Kosovës me ç'rast janë evidentuar mbi 200 vlera të natyrës si zona potenciale për mbrojtje.

Regjistrit të zonave të mbrojtura gjatë viteve 2006/ 2007 i janë shtuar edhe 24 zona të reja (7.25 ha), duke rritur numrin e përgjithshëm të zonave të mbrojtura në 75 (46.437 ha), që përfshinë 4.25 % të territorit të Kosovës.

Zhvillimi i veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë siç janë: zgjerimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malor, ndërtimi i objekteve industriale dhe hoteliere, prerja e pyjeve, shfrytëzimi i inerteve dhe veprimtaritë tjera shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm dhe kanë qenë faktorë kërcënues për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin. Nga fragmentimi i habitateve, dëmtimi dhe degradimi i ekosistemeve, shqetësimi dhe kërcënimi i specieve nuk janë kursyer as zonat me vlera siç janë: Parku i vetëm Nacional "Mali Sharr", "Bjeshkët e Nemuna", Parku "Mirusha", Parku "Gërmia" etj.

Gjatë kësaj periudhe nuk kanë munguar edhe iniciativa ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës në Kosovë. Projekti për fillimin e identifikimit të zonave potenciale për rrjetin "Natyra 2000" dhe projektet për parqet ndërkufitare janë disa nga këto, që janë përkrahur edhe nga MMPH.

Raporti përmban mbi 100 fotografi, 17 tabela, 13 harta dhe 5 grafike, përmes të cilave është paraqitë gjendja reale në terren dhe tendencat në rritje të ndikimit të aktivitetit njerëzor në natyrë.

Gjithashtu segment me rëndësi në këtë raport paraqet edhe dhënia e rekomandimeve për tejkalimin e problemeve të evidentuara.

Treguesi i shkurtesave

AEM	Agjencia Evropiane e Mjedisit
AER	Agjencioni Evropian për Rindërtim
AKM	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
AKMM	Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
APK	Agjencioni Pyjor i Kosovës
BE	Bashkësia Evropiane
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
CITES	Konventa për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës
FAO	Organizata për Ushqim dhe Bujqësi (Food and Agriculture Organisation)
GIS	Sistemi Gjeografik i Informatave (Geographical Information System)
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
IUCN	Unioni Botëror për Ruajtjen e Natyrës
GZK	Gazeta Zyrtare e Kosovës
KK	Kuvendi Komunal
KFOR	Kosovo Force
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
OJQ	Organizata Joqeveritare
OMGJ	Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
PN	Park Nacional
QEVERIA	Qeveria e Republikës së Kosovës
SKM	Strategjia e Kosovës për Mjedis
TMK	Trupat Mbrojtëse të Kosovës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
UNSECO	Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VSM	Vlerësimi Strategjik i Mjedisit

Historiku i Shkurtër i Mbrojtjes së Natyrës

Hapat e parë të mbrojtjes së natyrës dhe mjedisit në Kosovë fillojnë në fund të viteve të 60, ndonëse iniciativa për mbrojtje ligjore të vlerave të natyrës ka pasur edhe më herët. Në vitin 1968 formohet njësia për mbrojtjen e natyrës në kuadër të Entit për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës të Kosovës.

Në vitin 1974 me Vendimin mbi ndarjen e Seksionit për Mbrojtjen e Natyrës nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës themelohet Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës[1] dhe vazhdoi punën me të njëjtin emër sipas Ligjit mbi Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës [2]

Ndërsa në vitin 1988 Kuvendi i Kosovës nxjerrë Ligjin për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Vlerave Natyrore dhe të Vlerave të Krijuara me Punë të Ambientit të Njeriut [3], ku në nenin 78 paragrafi 2 të këtij ligji është përcaktuar veprimtaria e Entit . Në bazë të këtij ligji një vit më vonë Kuvendi i Kosovës nxjerrë ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit [4]

Pas luftës në Kosovë, me krijimin e rrethanave të reja të qeverisjes , UNMIK-u ka vepruar në bazë të rregullores 1999/1 me të cilën " i gjithë pushteti legjislativ dhe ekzekutiv në Kosovë i vihet UNMIK-ut".

Në vitin 2000 ish Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit regjistrohet në Administratën e Përkohshme Civile të OKB-së me emërtim " Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës" me seli në Prishtinë.[5]

Në maj të vitit 2000 themelohet *Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit*, dhe në kuadër të tij inkorporohen dhe veprojnë edhe institucionet ekzistuese: *Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës*, *Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës dhe Drejtoria e Parkut Kombëtar "Malet e Sharrit".*

Pas zgjedhjeve të përgjithshme (2001) dhe formimit të organeve qeverisëse të Kosovës formohet edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor [6] e cila përveç tjerash është përgjegjëse që: "të krijojë politikën, të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyrë aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën dhe biodiversitetin".

Aktualisht IKMN vepron në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit.

---

1 Vendimi për ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyrës ("GZK". 42/74)

2 Ligji për themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës ("GZK". 15/81)

3 Ligji për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut ("GZK" 39/88)

4 Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit ("GZK"nr. 38/89)

5 nr.i regjistrit të përkohshëm të subjektit Afarist 80156359, data 14.08.00) me emërtim " Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Ambientit të Kosovës"

6 Formimi I MMPH-se (Rreg. 2001/19 dhe 2002/5).

Qëllimet e Mbrojtjes së Natyrës

Baza ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj dhe qëllimet e mbrojtjes së natyrës, qëndrojnë në ligjin për mbrojtjen e natyrës.

- mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të natyrës dhe burimeve të përtëritshme të natyrës;
- rivitalizimin e territoreve të dëmtuara të natyrës ose pjesëve të saj dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- ruajtjen dhe restaurimin e baraspeshës ekologjike në natyrë;
- vendosjen e sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim, për mbrojtjen e natyrës;
- realizimin e qëllimeve, të përcaktuara në politikat e mbrojtjes së natyrës;
- zvogëlimin e shfrytëzimit tej mase dhe rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe i habitateve të tyre;
- Sigurimin e së drejtës për informim publik dhe pjesëmarrje të publikut në lëmin e mbrojtjes së natyrës;
- sigurimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- sigurimin e biodiversitetit përmes ruajtjes së habitateve të rëndësishme natyrore dhe llojeve me rëndësi të florës dhe faunës në statusin e favorshëm të ruajtjes;
- sjelljen e standardeve të Kosovës në harmoni me ato të Bashkimit Evropian.

I.

Zonat e Mbrojtura

1. Klasifikimi i zonave të mbrojtura

Klasifikimi i zonave të mbrojtura bëhet sipas ligjit për mbrojtjen e natyrës *(Rreg. 2006/22).*

Zonë e mbrojtur e natyrës është zona e shpallur me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peizazheve, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore dhe për ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe mjeteve të tjera.

Zona të mbrojtura sipas këtij Ligji janë:

I. Rezervati Strikt i Natyrës- zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime shkencore.
II. Parku Nacional- zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të mbrojtjes së ekosistemeve dhe rekreacionit.
III. Monumenti Natyror- zonë e mbrojtur kryesisht për qëllime të konservimit të karakteristikave specifike natyrore.
IV. Zona Menaxhuese e Habitateve ose Llojeve të Mbrojtura- zonë e mbrojtur për ruajtjen e habitateve ose llojeve të mbrojtura.
V. Peizazhet e Mbrojtura- zonë e mbrojtur për qëllime të ruajtjes së peizazheve.
VI. Zona e Mbrojtur e Resurseve Natyrore- zonë e mbrojtur me qëllim të shfrytëzimit të qëndrueshëm të ekosistemeve natyrore.

Kategorizimi i Zonave të Mbrojtura në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës është bërë sipas Unionit Botëror për Ruajtjen e Natyrës IUCN[7] (*The World Conservation Union*).

2. Zonat e mbrojtura të natyrës

Mbrojtja e natyrës përmes zonave të mbrojtura është instrument i rëndësishëm ligjor për ruajtjen e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit. Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura përbëhet prej 75 zonave të natyrës me sipërfaqe 46.437 ha (4.25 % e territorit të Kosovës). Sipërfaqen më të madhe të zonave të mbrojtura e zënë Parku Nacional "Mali Sharr". Në kuadër të këtyre zonave hyjnë: 11 Rezervate të Natyrës ("Bifurkacioni i lumit Nerodime", "Rezervati i Arnenit", "Maja e Ropsit", "Rusenica", etj.), 1 Park Kombëtar ("Mali Sharr"), 59 Monumente të Natyrës ("Burimi i Drinit të Bardhë", "Shpella e Gadimes", "Gryka e Rugovës", "Ura e Fshajtë", "Trungjet e Vjetra", etj.), 2 Parqe Regjionale të Natyrës ("Gërmia"

7 IUCN(The World Conservation Union) është organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 1948

dhe “Mirusha”) dhe 2 Parqe Pylli (“Pishat e Deçanit” dhe “Rahavani”). (tab.1& 2).

Zona të propozuara për mbrojtje janë195, përfshirë këtu edhe “Bjeshkët e Nemuna” për Park Nacional

Tabela 1 Zonat e Mbrojtura të Natyrës

Nr	Emërtimi	Nr. i zonave	Sipërfaqja /ha
1	**Rezervate të Natyrës**	**11**	**847**
	Bimore	7	
	Shtazore	2	
	Speciale	2	
2	**Park Kombëtar**	**1**	**39.000**
3	**Monument Natyre**	**59**	**4.874**
	Spelologjike	4	
	Hidrologjike	10	
	Gjeomorfologjike	5	
	Botanike	36	
	Memoriale	3	
	Muzeu i Kristaleve në Stantërg	1	
4	**Park Regjional**	**2**	**1. 681**
5	**Park Pylli**	**2**	**35**
	Totali	**75**	**46.437**



Figura 2. Harta e Zonave të Mbrojtura

Tabela 2. Pasqyra e Zonave të Mbrojtura

Emërtimi i Zonës	Komuna	Sipërfaqja në ha	Viti i mbrojtjes	Kategoria	Përshkrimi i vlerave
REZERVATET E NATYRËS					
1. Maja e Ropsit	Deçan	20	1955	I	Rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut
2. Gubavci	Pejë	38	1959	I	Rezervat bimor i llojit endemo-relikt boshtra (Forsythia europeae)
3. Maja e arnenit	Prizren	30	1960	I	Rezervat bimor me përbërje te pastër të rrobullit (Pinus heldreichii).
4. Gazimestan	Prishtinë	12	1953	I	Rezervat bimor i bozhures (Paenonia decora Anders)
5. Kozhnjeri	Deçan	150	1955	I	Rezervat i llojit shtazor dhia e egër (Rupicapra rupicapra L.)
6. Oshljaku	Prizren	20	1960	I	Rezervat natyror I llojit endemorelikt Rrobulli (Pinus heldreichii).
7. Malet e Prelepit	Deçan	0.92	1963	I	Rezervat bimor me përbërje të pastër të panjës malore (Acer heildreichii)
8. Rusenica	Therandë	300	1955	I	Rezervat natyror i llojit shtazor i rrëqebullit (Lynx lynx L.)
9. Bifurkacioni i lumit Nerodime	Ferizaj	13	1979	I	Rezervat special natyror. Është fenomen unikat në Evropë dhe i dyti në botë me rëndësi të madhe arsimore,shkencore dhe turistike.
10. Pisha e madhe	Prizren	35	1960	I	Rezervat bimori i llojit endemorelikt Rrobulli (Pinus heldreichii).
11. Kamilja	Albanik -Leposaviq	228	1988	I	Bregorja gëlqerore kamilja është rezervat i veçantë natyror me veçori paleontologjie.
PARQET KOMBËTARE					
1. Mali Sharr	Prizren, Suharekë, Kaçanik, Shtërpcë	39. 000	1986	II	Karakterizohen me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Si dhe me rëndësi të madhe turistike.
MONUMENTET E NATYRËS					
1. Shpella e Gadimes	Lypjan	56. 25,02	1969	III	Gjeomonument i natyrës i pasur me stoli natyrore, është ndër shpellat më të bukura në Kosovë, Ballkan dhe më gjerë me rendësi shkencore, edukative, arsimore dhe turistike .

2. Shpella e Baicës	Drenas	00. 11, 55	1987	III	Gjeomonument i natyrës me vlera speleologjike dhe hidrologjike
3. Shpella në Gllanasellë	Drenas	00. 50, 17	1987	III	Gjeomonument me karakter gjeomorfologjik, hidrologjik dhe speleologjik.
4. Gryka e lumit Bistrica	Prizren	200.00,00	1976	III	Monument natyror me karakter hidrologjik dhe peijzazhore
5. Burimi i Drinit të Bardhë me shpellën dhe ujëvarën në Radavc	Pejë	89. 94	1983	III	Monument natyre me rëndësi gjeomorfologjike, hidrologjike dhe turistike.
6. Rrjedha e lumit Mirusha *	Therandë - Klinë	10. 03, 35 1. 93, 94	1983	III	Rëndësi hidrologjike, gjeomorfologjike dhe peijzazhore
7. Burimi i ujit mineral në Dresnik	Klinë	0.0,6.75	1985	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
8. Burimi termomineral në Vuqë	Albanik-Leposaviq	16. 60, 13	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
9. Burimi i ujit në Revuqë	Podujevë	1. 16, 94	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
10. Burimi i ujit mineral në Sallabajë	Podujevë	00. 31. 47	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
11. Burimi i ujit në Shakovicë	Podujevë	1. 40,54	1988	III	Monument natyror me karakter hidrologjik.
12. Gryka e lumit Klina	Klinë	1.204,94,49	1985	III	Monument kompleks i natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike
13. Gryka e Rugovës	Pejë	4. 301,05,49	1985		Rëndësi gjeologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike dhe botanike.
14. Kunjoni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë	Gjakovë, Rahovec	73.86,47 124.6,09	1986	III	Monument natyre me rëndësi hidro-gjeomorfologjike në kanionin e Drinit të Bardhë
15. Rrapi në Marash (Platanus orientalis)	Prizren		1959	III	Monument natyror me karakter botanik, edukativ, shkencor dhe kulturor
16. Mani Sham (Morus sp.)	Pejë	3, ari	1957	III	Monument natyror me karakter botanik
17. Plepi në Bajçinë (Populus tremula)	Podujevë		1959	III	Monument natyror me karakter botanik
18. Arneni në Nerodime (Pinus heldreichi)	Ferizaj		1959	III	Monument natyror me karakter botanik
19. Bliri në Isniq (Tilia argentea)	Deçan	00.02.11	1968	III	Monument natyror me karakter botanike
20. Bliri në Strellc të Epërm (Tilia argentea)	Deçan		1961	III	Monument natyror me karakter botanik
21. Trungjet e blirit në Isniq (Tilia argentea)	Deçan		1968	III	Monumente natyrore me vlera të rralla botanike
22. Vidhi fushor në Lukinaj (Ulmus campestris)	Prizren		1981	III	Monument natyror me karakter botanik

* Malisheva, është formuar komunë më vonë

23. Trungjet e bungut në Lozicë (Quercus sp.)	Malishevë		1985	III	Monument i rëndësishëm natyror për hulumtime shkencore me karakter botanik
24. Trungu i qarrit në Zllakuçan (Quercus cerris)	Klinë		1985	III	Monument natyror me karakter botanik dhe turistik
25. Trungu i qarrit në Potërç të ulët (Quercus sp.)	Klinë		1985	III	Monument natyror me karakter botanik
26. Trungu i vidhit në Çabiq (Ulmus minor Muller)	Klinë		1985	III	Monument natyror me karakter botanik
27. Trungu i qarrit në Bërkovë (Quercus sp)	Klinë		1985	III	Monument natyror me karakter botanik
28. Trungu i qarrit në Dumnicë të Poshtme (Quercus cerris)	Podujevë		1988	III	Monument natyror me karakter botanik
29. Trungu i çarrit në Polatë (Quercus cerris)	Podujevë	00.44,20	1988	III	Monument natyror me karakter botanik
30. Trungu i plepit në Orllan (Populus tremula)	Podujevë	00.26,20	1988	III	Monument natyror me karakter botanik
31. Trungu i qarrit në Dobratin (Quercus cerris)	Podujevë		1988	III	Monument natyror me karakter botanik
32. Maja e zezë	Pejë	112.50.00	1977	III	Monument memorial i natyrës
33. Ramjani	Viti	190.00,00	1982	III	Monument memorial i natyrës
34. Çabrati	Gjakovë	64,00.00	1984	III	Monument memorial i natyrës
35. Mineralet – Kristalet	Stantërg, Mitrovicë		1970	III	Minerale dhe kristale të ruajtura në muzeun e kristaleve në Stan- tërg.
36. Trungjet e rrënjës (Nekovc)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik
37. Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Negroc)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik
38. Trungjet e shpardhit (Negroc)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik
39. Shpella e Kishnarekës	Drenas	2. ha	2006	III	Gjeomonument i natyrës me vlera speleologjike dhe hidrologjike
40. Trungu i qarrit (Krajkovë)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik
41. Guri i Gradinës (Llapushnikë)	Drenas	2. ha	2006	III	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
42. Burimi i ujit mineral (Poklekë)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter hidrologjikë
43. Trungjet e dushkut, gjashtë lisat (Likoshanë)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik

44. Trungjet e dushkut (Terstenikë)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik
45. Trungu i dushkut (Likoshanë)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter botanik
46. Guri i plakës (Dobroshevc)	Drenas	5. ari	2006	III	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
47. Trungu i bungëbutës (Quercus pubercens ëilld.) Aqarevë	Skenderaj	5 ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
48. Trungjet e dushkut (Quercus sp.) Polac	Skenderaj	5. ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
49. Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likovc	Skenderaj	5. ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
50. Burimi termal i ujit në fshatin Bajë	Skenderaj	10. ari	2007	III	Monument natyror me karakter hidrologjik
51. Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Prellovc	Skenderaj	5 ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
52. Kompleksi i trungjeve të dushkut (Quercus sp.) Rrezallë	Skenderaj	2. he.	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
53. Kompleksi i trungjeve të bungëbutës (Quercus pubescens Ëilld.) në Klladernicë	Skenderaj	10, ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
54. Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Kotorr	Skenderaj	5 ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
55. Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Padalishtë	Skenderaj	5, ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
56. Trungu i bungëbutës (Quercus pubescens Ëilld.) në Çitak	Skenderaj	5, ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
57. Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Runik	Skenderaj	5. ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
58. Burimi i ujit të njelmët në Leqinë	Skenderaj	5. ari	2007	III	Monument natyror me karakter hidrologjikë
59. Trungu i bungut në Lubovec	Skenderaj	5. ari	2007	III	Monument natyror me karakter botanik
PARK REGJIONAL (Peizazh i mbrojtur)					
1. Parku regjional i Mirushës**	Klinë, Rahovec	357.01,72 198.77,98	1982, 1983		Kanioni me ujëvarat e njëpasnjëshme dhe peizazhet specifike, paraqet një fenomen të rrallë natyror që ka rëndësi të jashtëzakonshme natyrore, shkencore, kulturore dhe turistike

* Parku shtrihet edhe në territorin e Komunës se Malishevës, por kjo është themeluar si komunë më vonë

2. Parku regjional Gërmia	Prishtinë	1.126, 01, 00	1987		Me rëndësi të madhe shkencore, edukative, kulturore dhe turistike rekreative.
PARK PYLLI					
1. "Pishat e Deçanit"	Deçan	15	1968		Përbërja e pastër e pishës së zezë te Manastiri i Deçanit
2. Rahavane	Therandë	20.25,83	1980		Kompleksi i trungjeve

2.1. Rezervatet e Natyrës

Rezervatet janë pjesë burimore ose shumë pak të ndryshuara të natyrës, me përbërje vetjake të formave bimore dhe shtazore si dhe bashkësive të tyre, si pjesë të ekosistemeve të parapara para se gjithash për ruajtjen e fondit gjenetik. Rezervatet mund të jenë me rëndësi botanike, ku ruhen në formë "in situ" llojet bimore dhe bashkësitë bimore, ose me rëndësi shtazore për shkak të ruajtjes së llojeve shtazore në vendbanimet burimore të natyrës. Gjithashtu, rezervate mund të jenë edhe viset në të cilat janë shfaqur një ose më shumë vlera natyrore, të cilat duhet të mbrohen ose dukuri të cilat duhet përcjellë dhe përkujdesur.

Rezervat strikt i natyrës është territori tokësor ose ujor që disponon me ekosisteme të shquara me veti gjeologjike dhe lloje, i destinuar para së gjithash për kërkime shkencore dhe monitorim mjedisor [8].

Qëllimet e menaxhimit me rezervatet strikte të natyrës janë: ruajtja e habitateve, ekosistemeve dhe llojeve nga shqetësimet, përkujdesja e resurseve gjenetike në gjendje dinamike dhe evolutive, përkujdesja e proceseve ekologjike, ruajtja e vetive strukturore peizazhore apo relieveve shkëmbore, ruajtja e mostrave të mjedisit natyror për studime shkencore, arsimimi dhe monitorimi mjedisor, ulja e shqetësimeve përmes planifikimit me kujdes të zbatimit të hulumtimeve dhe aktiviteteve të tjera, etj

Për rezervatet strikte të natyrës vlen shkalla e I-rë e mbrojtjes dhe ato shpallën nga Qeveria.

Nga sipërfaqja e përgjithshme e zonave te mbrojtura, rezervatet natyrore përfshijnë 847 ha. Në Kosovë deri më tash kemi 3 lloje të rezervateve të mbrojtura: rezervate bimore (7), rezervate shtazore (2) dhe rezervate speciale (2).

8 Neni 18 i ligjit për mbrojtjen e natyrës (rreg. Nr. 2006/22)

Tabela 3. Rezervatet e natyrës

Emërtimi i rezervatit	Komuna	ha	Viti i mbrojtjes	Kat.	Përshkrimi
Maja e Ropsit	**Deçan**	**20**	**1955**	**I**	**Rezervat bimor i përbërjes së përzier të pyllit të molikës (***Pinus peuce***), pishës (***Abies alba***), bredhit (***Piceae excelsa***) dhe ahut (***Fagus moesica***). I rëndësishëm është edhe për botën shtazore. Shtrihet në shpatijet verilindore në lartësi mbidetare prej 1800m.**
Gubavci	**Pejë**	**38,24**	**1959**	**I**	**Rezervat bimor i llojit endemo-relikt boshtra (***Forsythia europeae Deg.et Bald). Rezervati shtrihet në kodrën Gubavc në vendin e quajtur Brezovica.*
Maja e Arnenit	**Prizren**	**30**	**1960**	**I**	**Rezervat bimor me përbërje të pastër të rrobullit (***Pinus heldreichii) dhe me rëndësi ornitofaunistike.*
Pisha e Madhe	**Prizren**	**35**	**1960**	**I**	**Pisha e Madhe është lokalitet ku ndodhen pyje të pastra të rrobullit** *(Pinus heldreichii).* **Rezervati shtrihet në shpatijet juglindore të Koxhaballkanit ku gjenden pyjet e vjetra të rrobullit të cilat formojnë bashkësinë bimor***e Seslerio autumnalis–Pinetum heldreichi***, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të rrobullit në Gadishullin Ballkanik.**
Oshljaku	**Prizren**	**20**	**1960**	**I**	**Oshlaku është rezervat natyror që karakterizohet me pyje të pastra të rrobullit dhe disa lloje të rëndësishme endemike të florës si dhe lloje të rëndësishme të ornitofaunës. Gjendet rrëzë malit Oshlak. Është vënë nën mbrojtje, me qëllim të ruajtjes së pyjeve të pastra natyrore të llojit endemorelikt Rrobulli** *(Pinus heldreichii)***.**
Malet e Prelepit	**Deçan**	**0.92**	**1963**	**I**	**Rezervat bimor me përbërje të pastër të llojit endemorelikt panja malore (***Acer heildreichii Orph). Është me rëndësi për kërkime botanike, biocenologjike dhe pylltarisë.*
Gazimestan	**Prishtinë**	**12**	**1953**	**I**	**Rezervat bimor i bozhures (***Paenonia decora Anders* **)**
Rusenica	**Suharekë**	**300**	**1955**	**I**	**Rezervat i llojit shtazor rrëqebulli (***Lynx lynx L.***)**
Kozhnjeri	**Deçan**	**150**	**1955**	**I**	**Rezervat i llojit shtazor dhia e egër (***Rupicapra rupicapra L.***)**
Bifurkacioni i lumit Nerodime	**Ferizaj**	**13**	**1979**	**I**	**Rezervat special natyror. Është fenomen unikat në Evropë dhe i dyti në botë me rëndësi të madhe arsimore,shkencore dhe turistike.**
Kamilja	**Leposaviq**	**228**	**1988**	**I**	**Bregorja gëlqerore kamilja është rezervat i veçantë natyror me veçori paleontologjie.**



Figura 3. Harta e Rezervateve të Natyrës

Gjendja e rezervatit Maja e Arnenit (Prevallë)

Sipërfaqja e rezervatit është 30 ha. Është vënë nën mbrojtje ligjore si Rezervat Bimor në vitin 1960. Zona është me rëndësi të madhe botanike për shkak të llojit endemorelikt të rrobullit (*Pinus heildreichi*), po ashtu është me rëndësi ornitofaunistike për llojin pula e egër *(Tetrao urogallus*) si dhe ka rëndësi rekreative dhe mjekësore etj.

Gjendja e pyjeve endemorelikte të rrobullit (*Pinetum heldreichii*) të cilat gjenden në ekspozicionin jugor të malit Oshlak është mjaft e përkeqësuar si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga zjarri i vitit 2000 si dhe nga insekti dëmtues nënlëvorësi i pishës (*Blastophagus sp*.). Nga ndikimi negativ i këtyre faktorëve (zjarrit dhe insektet) si dhe faktorëve të tjerë biotik (patogjenët e kalbjes) dhe abiotik (elementet klimatike) janë tharë pjesë të konsiderueshme të pyjeve të rrobullit. Shumica e trungjeve të rrobullit janë prekur nga zjarri dhe nënlëvorësi të cilët e rrezikojnë mbijetesën biologjike të këtyre pyjeve. Në veçanti është rrezikuar gjendja e tyre nga ndërtimi i fshatit turistik sipas Planit Rregullativ Urban ,,Prevalla".

Figura 4. Rezervati i Rrobullit (Pinus heildreichii), Prevallë

Nga aspektet e tjera zhvillimore të këtyre pyjeve që janë verifikuar gjatë hulumtimeve veçohen:

Intensiteti i tharjes së pyjeve të rrobullit, në krahasim me vitet e kaluara, është më i vogël, mirëpo kjo nuk paraqet garanci për rivitalizimin natyror dhe zhvillimin e qëndrueshëm të këtyre pyjeve. Ripërtëritja natyrore (prania e filizërisë), në pjesën më të madhe të pyjeve të rrobullit mungon, si pasojë e zhvillimit të madh të bimëve barishtore, në veçanti të llojit *Ephilobium angustifolium* dhe filizërisë së shelgut të egër (*Salix caprea*). Filizëria e rrobullit është verifikuar në sipërfaqet barishtore që i rrethojnë këto pyje.

Figura 5. Rrobulli (Pinus heildreichii)

Figura 6. Pyjet e rrobullit (Pinetum heldreichii)pas zjarrit të vitit 2000 në Prevallë

Figura 7. Veprimi i insektit Blastophagus sp. pas djegies së pyllit

Gjendja e pyjeve të ahut, të cilët gjenden kryesisht në ekspozicionin verior të malit Sharr, është e mirë dhe e qëndrueshme. Në grumbujt pyjor me kurorë me dendësi të theksuar (0.9-1) mungon ripërtëritja natyrore, ndërsa në pyjet me kurorë të dendur më të vogël (0.6-0.8) është konstatuar zhvillimi i theksuar i filizërisë me vjetërsi të ndryshme. Nga faktorët biotik dhe abiotik në pyjet e ahut janë verifikuar:

- kërpudha e kalbjes *Fomes fomentarius* ,që paraqitet në drurët e vjetruar dhe të dëmtuara të ahut (*Fagus moesiaca*),
- kërpudha *Nectria ditissima,* që shkakton tumorin e lëvores dhe deformime të trungjeve në drurët me imunitet të dobësuar,
- ndikimet e erërave dhe të borës të cilët kanë shkaktuar thyerje të degëve dhe rrëzimin e drurëve në vendet me pjerrësi të theksuar të terrenit,
- ndikimet e faktorit antropogjen përmes prerjes së drurëve dhe ndezjes së zjarreve në pyje.

Në rajonin e Prevallës janë duke u realizuar dy Plane (Projekte) nga KK i Prizrenit: Plani Rregullativ Urban ,,Prevalla” në anën e majtë të rrugës Prizren-Shtërpcë, i cili parasheh ndërtimin e fshatit turistik me mbi 360 objekte në sipërfaqe prej 17 ha, dhe Plani për Rregullimin e Kampingut në zonën ku gjenden bazamentet e vikend shtëpizave të ish ,,Bankosit”.

Në zonën që kufizohet me rezervatin strikt natyror ,,Maja e Arnenit" (ish "Popovo prase"), janë hapur 4 rrugë në bazë të Planit Rregullativ Urban "Prevalla" i përpiluar nga K.K i Prizrenit me ç'rast janë shkaktuar dëme të konsiderueshme në ekosistemet barishtore, shkurrore dhe pyjore të rrobullit dhe të ahut. Gjatë hapjes së rrugëve janë prerë ekzemplarë të rrobullit, me diametër prej 18 deri 66 cm dhe 16 dru të ahut, me diametër prej 14 deri 54 cm. Kjo është realizuar pa procedura ligjore (pa vulosje), të parapara me Ligjin mbi Pyjet e Kosovës nr 2003/6 (neni 20) dhe pa lejen e ekipeve profesionale të Drejtorisë se P.N. "Malet e Sharrit". Në bazë të rrugëve të ndërtuara konstatohet se përveç ekosistemeve barishtore dhe shkurrore, parashihet shkatërrimi i afro 5 ha të ekosistemeve endemorelikte pyjore të rrobullit dhe të ahut, ku është verifikuar biodiverziteti i theksuar i llojeve drunore: endemoreliktet *Pinus heldreichii* dhe *Pinus peuce* si dhe llojet tjera si *Fagus moesaicae*, *Fraxinus ornus*, *Acer pseudoplatanus*, *Pinus nigra*, *Picea excelsa*, *Lonicera xilosteum*, *Juniperus communis*, *J. nana*, *Daphne mezereum*, *Rosa canina*, *Rhamnus cathartica*, *Salix caprea*, *Salix arenaria*, *Sobus aucuparia*, *S. austriaca*, *Betulla pubescens*, *Alnus glutinosa*, si dhe dhjetëra lloje barishtore.

Figura 8. Hapja e rrugës me thellësi rreth 2 m afër ekzemplareve te rrobullit (***Pinus heldreichii***)

- Hulumtimet e rajonit të Prevallës kanë treguar se kjo zonë e Parkut Nacional ka vlera të jashtëzakonshme natyrore dhe shkencore. Në kuadër të biodiverzitetit të pasur veçohen llojet e shumta endemike bimore: stenoendemiti *Vrbascum scardicolum* (gjendet vetëm në rajonin e Prevallës dhe askund tjetër në botë!), *Pinus heldreichii* (lloj endemorelikt), *Pinus peuce* (lloj endemik i Ballkanit), *Gentianella bulgarica var. albanica, Dianthus cartusonarum, Dianthus integer, Lazerpitium siler, Campanula albanica, Thymus albanus, Campanula foliosa, Verbascum nikolai, Stachys scardica, Viola zoisii, Viola grisebachii, Ephilobium*

anagallidifolium, Buplenium subthorpianum, Phytenua pseudoverbiculare, Trifolium velenovskyi (lloj endemik i Ballkanit)*, Carex leavis, Anthemis carpatica, Onobrychis scardica, Anthyllis aurea, Doronicum orphanidis, Campanula spatulata, Campanula epigea, Scabioza dubia, Potentilla speciosa, Cynanchum huteri* etj.

Figura 9, 10. Llojet bimore endemike në Prevallë

Figura 11. Plani Rregullativ Urban në Prevallë



Figura 12. Peizazh nga Prevalla

Bifurkacioni i Lumit Nerodime

Bifurkacioni i lumit Nerodime paraqet një shembull të vetëm në Evropë të derdhjes së një lumi në dy detra. Lumi buron nga Bjeshkët e Jezercit, dhe në fshatin Nerodime ndahet pakthyeshëm në dy degë, të cilat kanë derdhje në dy dete të ndryshme. Dega veriore (dega e majtë) derdhët në lumin Sitnicë dhe vazhdon rrugëtimin në lumin Ibër, Moravë dhe përmes Danubit derdhet në Detin e Zi, ndërsa dega jugore

Figura 13. Harta e vendndodhjes së Bifurkacionit

(dega e djathtë) përmes lumit Lepenc dhe përmes Vardarit derdhet në Detin Egje. Ky kuriozitet natyror është mjaft tërheqës për studiues dhe vizitorë dhe ka rëndësi të madhe edukative, shkencore dhe turistike. Që nga viti 1979 është vënë nën mbrojtje ligjore si rezervat special i natyrës. Sipërfaqja e mbrojtur e rezervatit është 12.78,71 ha.

Gjendja e Bifurkacionit

Gjatë vizitave të shpeshta është vërejtur se Bifurkacioni nuk është funksional, si pasojë e pengesave të shumta në shtratin e lumit sidomos në degën e majtë e cila i shkarkon ujërat në lumin Sitnicë e më tutje për në Detin e Zi. Dega e majtë tërësisht është e zbrazët nga rrjedha ujore, në të nuk qarkullon ujë fare. Edhe dega e djathtë që dërgon ujin në mulli është e dëmtuar, si pasojë e ndryshimit të shpeshtë të kahes së rrjedhës nga vetë banorët.

Figura 14. Bifurkacioni i Nerodimes dikur

Po ashtu te restorant Ujëvara, një ujëvare e krijuar artificialisht për qëllime estetike të restorantit dëmton rrjedhën në drejtim të bifurkacionit.

Në vitin 2005 Kuvendi Komunal i Ferizajt në bashkëpunim me Trupat Mbrojtëse të Kosovës kanë marrë një iniciativë për rihapjen dhe pastrimin e degës së majtë të lumit Nerodime. Ky projekt nuk është përfunduar tërësisht.

Iniciativa të tilla ka pasur edhe më herët, por që nuk e kanë funksionalizuar rrjedhjen normale të bifurkacionit.

Për tu rikthyer funksionimi normal i bifurkacionit, duhet ndërmarrë një varg masash që kanë të bëjnë me eliminimin e problemeve të administrimit dhe problemeve teknike të paraqitura në terren:

- Marrja nën mbrojtje ligjore e rezervatit nga Qeveria e Kosovës konform ligjit për mbrojtjen e natyrës dhe caktimi i një organi menaxhues,
- Hartimi i një projekti afatgjatë nga Kuvendi Komunal i Ferizajt për pastrimin dhe hapjen e shtratit të degës së majtë të lumit Nerodime,
- Rikthimi i rrjedhës normale të lumit, duke larguar të gjitha pengesat e paraqitura gjatë rrjedhës deri të bifurkacioni,
- Hartimi i planit menaxhues ,
- Hartimi i planit urbanistik dhe turistik
- Shenjëzimi dhe vendosja e tabelave informuese

Figura 15. Dega e majtë e cila i shkarkon ujërat në lumin Sitnica e më tutje për në Detin e Zi, është shterur

Figura 16. Pamje e degës së majtë e cila është shterur tërësisht.

Figura 17. Ujëvara te restoranti është një faktor i mosfunksionimit të bifurkacionit, për shkak të ndërprerjes së rrjedhës së ujit në drejtim të bifurkacionit

Rezervati i Rrëqebullit në Rusenicë

Rrëqebulli, i njohur në gjuhën shkencore si *Lynx lynx*, është mishngrënësi i tretë për nga madhësia në Evropë, pas ariut dhe ujkut. Bën pjesë në familjen e maceve (*Felidae*) dhe ka përhapje në Euroazi, nga Alpet e Evropës deri në Siberinë Lindore.

Në Kosovë haset kryesisht në zonat malore. Në Malet e Sharrit prezenca e përhershme e Rrëqebullit është dokumentuar qysh prej vitit 1912. Prezenca e tij pastaj është konstatuar edhe në " Malet e Nerodimes", "Jezercit", "Pashtrikut", "Koritnikut", "Bjeshkët e Nemuna" etj. Parapëlqen pyjet e larta dhe pak të shkelura nga njerëzit. Ka pamje mjaft karakteristike, me trup te mbledhur, këmbë të gjata dhe me shputa të gjera. Ka kokë të rrumbullakët, veshë të mëdhenj me një xhufkë tipike qimesh në maje, bisht të shkurtër dhe me maje të zezë. Gëzofin e ka ngjyrë kafe në të kuqërremtë, që vjen duke u zbardhur në pjesët e poshtme të barkut dhe është i mbuluar me pulla të errëta. Është i gjatë 80-130 cm, i lartë rreth 65 cm dhe peshon 12-35 kilogram. Ushqehet kryesisht me thundrake, si kaprolli dhe dhia e egër, por në dietën e tij nuk mungojnë dhe lepuri i egër, dhelpra dhe shpendë të ndryshëm të pyllit. Është kafshë tipike vetmitare dhe takohet me rrëqebuj të tjerë vetëm në sezonin e çiftimit. Zë territore të mëdha (deri 2000 km^2) dhe është aktiv kryesisht natën. Brenda një nate mund të përshkojë deri 45 km. Rrëqebulli jeton deri 17 vjet.

Areali i përhapjes së Rrëqebullit si **lloj i rrallë dhe i rrezikuar i faunës sonë** është mbrojt në Rusenicë të komunës së Suharekës si Rezervati i Mbrojtur i Natyrës. Rezervati është vënë nën mbrojtje ligjore në vitin 1955 dhe përfshinë sipërfaqen prej 300 ha.

Vlerësimet paraprake për popullatën autoktone të rrëqebullit në pjesën jugperëndimore të Ballkanit tregojnë se popullata e rrëqebullit është më e rrezikuara në të gjithë Botën. Situata bëhet edhe më alarmante po të mendohet se rrëqebulli i Ballkanit konsiderohet si subspecie me vete, *Lynx lynx martinoi*. Gjendja e tij nuk njihet mirë, por numri i gjithë popullatës mendohet të jetë nën 100 individë, e përqendruar kryesisht në Ballkanin jugperëndimor (Shqipëri, Maqedoni dhe një pjesë në Kosovë).[9]

Gjendja e rrëqebullit në Kosovë i referohet të dhënave të viteve 90, të cilat flasin për prezencën e tij në territorin e "Sharrit" dhe të "Bjeshkëve të Nemuna". Në "Malet e Sharrit" janë evidentuar 10 krerë të rrëqebullit edhe atë në Popovo prase, Oshlak, Koxhaballkan dhe Ostrovicë. Ndërsa në "Bjeshkët e Nemuna" 12 krerë të këtij lloji.

Nga të dhënat dhe dëshmitë e fundit për gjendjen momentale të Rrëqebullit në Malet e Sharrit, e konkretisht në gjysëmrezervatin e Grykës së Rusenicës gjendja është alarmante, kur kihet parasysh fakti se në afërsi të grykës veprojnë disa gurëthyes ilegal, të cilët me aktivitetin e tyre jo vetëm që po e dëmtojnë natyrën

9 http://euronatur.org/

në përgjithësi, por edhe arealin edhe ashtu të vogël të këtij lloji të rrallë, i cili është mjaft i ndjeshëm ndaj prezencës së faktorit antropogjen. Po ashtu shkaktar i kësaj gjendje është edhe gjuetia e tepruar jo vetëm e tij, por edhe e llojeve të tjera të gjitarëve (kaprolli, lepuri) si dhe të shpendëve të cilët janë ushqim i preferuar i tij.

Fauna e Kosovës e panjohur dhe e pastudiuar sa duhet ndodhet në një situatë jo të mirë, dhe rrëqebulli është përfaqësuesi me i denjë i kësaj situate.

Figura 18. Rrëqebulli (Lynx lynx)ne Shqipër (. http://euronatur.org)

2.2. Parku Nacional "Mali Sharr"

Malet e Sharrit shtrihen në regjionin e Kosovës dhe Maqedonisë, ku përfshijnë një sipërfaqe prej 1600 km2. Kosovës i takojnë degët veriore të Sharrit duke përfshirë hapësirën prej rreth 1100 km2 që përafërsisht përbën 1\10 e hapësirës së Kosovës. Në vitin 1986 nga Kuvendi i Kosovës një pjesë e Malit Sharr është shpallë "Park Kombëtar". Sipërfaqja e "Parkut Kombëtar" përfshinë 39. 000 ha, dhe shtrihet në kufijtë e katër komunave: Prizren (19.500 ha), Shtërpcë (15.210 ha), Therandë (2730 ha) dhe Kaçanik (1560 ha).

Malet e Sharrit shquhen për vlera botanike, faunistike, ekologjike, turistike, rekreative, sportive edukative dhe kulturore. 25 liqene në lartësi mbidetare mbi 1900 m. përfaqësojnë vlera të veçanta natyrore të masivit të Sharrit. Liqeni më i madh është Liqeni i Livadhit (2173 m.) Nga aspekti floristik hyjnë në radhën e maleve më të pasura të Kosovës dhe Gadishullit Ballkanik dhe paraqesin një thesar të specieve bimore me një numër të madh të llojeve endemike, relikte, të rralla dhe të rrezikuara.

Figura 19. Parku Nacional "Mali Sharr"

Deri tani janë konstatuar afro 2000 lloje bimore dhe 68 bashkësi bimore. Në kuadër të vegjetacionit pyjor hasim lloje të ndryshme të dushkut, ahut, bredhit, hormoqit, pishës së bardhë, pishës endemike dhe relikte të maleve të larta: rrobulli (*Pinus heildreichii*) dhe molika (*Pinus peuce*), lisi i rëndomtë (*Taxus baccata*), çetinaku (*Pinus mugo*), rododendroni (*Rhododendron ferrugineum*) etj.[10] Në mesin e këtyre llojeve 86 sosh, janë të deklaruara me rëndësi ndërkombëtare, 26 lloje janë të përfshira në "Listën e Kuqe" Evropiane të shtazëve dhe bimëve si të kërcënuara dhe 32 janë në "Listën e Kuqe" të bimëve të kërcënuara sipas IUCN.

Figura 20. Peizazh nga Parku Nacional "Mali Sharr"

Territori i Sharrit me biotopet e ndryshme është shumë i pasur në pikëpamje faunistike. Në të janë prezentë lloje të veçanta të shtazëve, të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike, që d.m.th. se përhapja e tyre është e ngushtë dhe i përkasin llojeve endemike. Ndërsa, llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Sharrit dhe në përgjithësi fauna e Kosovës deri sot nuk është hulumtuar sa duhet, mirëpo në bazë të të dhënave të literaturës mund të konstatohet se fauna e Sharrit përbëhet prej: *7 lloje Peshq, 9 lloje amfibe,10 lloje reptilë, 154 lloje shpendë dhe 30 lloje gjitarë.*

10 Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr për Park Nacional,(Prishtinë 1982)



Figura 21. Harta e rezervateve dhe zonave me vlera të veçanta në kuadër të P.N. "Mali Sharr"

Brenda territorit të Parkut Nacional „Mali Sharr" ekzistojnë këto zona me status të rezervatit të mbrojtur : Koxhaballkani (Pisha e madhe), Oshlaku (Arneni), Maja e Arnenit (Prevalla) dhe Rusenica.

1. Maja e Arnenit (Popovo prase)- përbëhet nga pyjet e pastra të Rrobullit (*Pinus heldreichii*). Gjendet në Prevallë (pjesa lindore e Oshlakut), me sipërfaqe prej 30 ha. Është vënë nën mbrojtje në vitin 1960. Në këtë lokalitet gjenden pyjet e llojit endemik dhe relikt terciar të rrobullit (*Pinus heldreichii*).

2. Oshlaku - është i pasur me pyje të pastra të rrobullit (*Pinus heldreichii*). Mali Oshlak është i pasur me bimë të shumta endemike. Simbol i veçantë i Oshlakut është lloji stenoendemik i *Achillea alexandri - regis* që gjendet kryesisht në pjesët e larta malore. Vlen të përmenden me këtë rast bashkësitë bimore: *Achilleo – Pinetum mugo* (Pinetum mugo calcicolum) dhe Achilleo alexandri – regis. Nga fauna e begatshme veçohet dhia e egër (*Rupicapra rupiapra*), e cila gjendet në kullosat më të larta të Oshlakut, ndërsa nga kafshët e egra që kanë përhapje më të madhe janë: ariu i murrmë, ujku, kaprolli, shpendë të ndryshëm grabitqar etj. Ky rezervat ka sipërfaqe prej 20 ha dhe është vënë nën mbrojtje në vitin 1960.



Figura 22. Rezervati i Oshlakut në Koxhaballkan

3. Pisha e Madhe - është rezervat i pyjeve të pastra të rrobullit (*Pinus heildreichii*). Shtrihet në shpatijët juglindore të Koxhaballkanit, ku gjenden pyjet e vjetra të rrobullit të cilat formojnë bashkësinë bimore Seslerio autumnalis– Pinetum heldreichi, të cilat paraqesin kompleksin më të bukur dhe më interesant të pyjeve të arnenit në Gadishullin Ballkanik. Rezervati ka sipërfaqe prej 35 ha, dhe është vënë nën mbrojtje në vitin 1960.

Figura 23. Pisha e madhe, Rezervati i rrobullit (***Pinus heildreichii)***

4. Rusenica- është vendbanim i rrëqebullit ballkanik (*Lynx Lynx balcanicus*) i cili është lloj i rrallë dhe i rrezikuar. Rusenica ka sipërfaqe të mbrojtur rreth 300 ha. Rezervati është shpallë në vitin 1955, me qëllim të mbrojtjes së vendbanimit të rrëqebullit. Deri më sot mungon një studim i mirëfilltë për këtë lloj shtazor të rrallë dhe për rezervatin në përgjithësi. Ky lokalitet është i rëndësishëm edhe nga aspekti peijzazhore dhe floristik, ku veçohet lloji i panjës malore (Acer heldreichii).

Zonat me Vlera të Veçanta

Në kuadër të Parkut Nacional "Mali Sharr" ekzistojnë disa zona me vlera të veçanta natyrore.

1. Pashallarë (Ostrovica) – lokalitet i maleve të larta (1600m-2092m), në serpentinë me pyje të pastra të rrobullit, arnenit dhe pyje të ahut. Ky masiv malor veçohet me fondamentet gjeologjike nga serpentina në të cilën zhvillohen vegjetacionet e rralla dhe specifike të maleve të larta. Në shpatijët veriore dhe veriperëndimore të Pashallarës, duke filluar prej lartësisë mbidetare prej 1600m deri te maja 2092m, gjenden bashkësitë e rralla pyjore, ku në pjesët e ulëta veçohen bashkësitë me rrobull: Junipero – Pinetum heldreichii (Bruckenthalio – Pinetum heldreichii), Pinetum – heldreichii serpentinicolum, Pinetum – heldreichii peucis scardicum, si dhe bashkësitë e ahut në serpentinë. Mbi këtë bashkësi e deri të majat më të larta, gjendet vegjetacioni specifik në serpentinë i hartinës Pinetum mugo serpentinicum. Këtyre bashkësive të lartpërmendura, vlerë të posaçme u jep lloji endemik Bornmuellera–dieckii. Pyjet e rrobullit në serpentinë paraqesin fenomen të veçantë natyror në vegjetacionin e Ballkanit, ndërkaq edhe bashkësitë e hartinës në serpentinë janë shumë të rralla. Ka sipërfaqe afër 45 ha.

2. Koplica- është rajon gëlqeror i maleve të larta, me florë dhe faunë mjaft të rrallë. Masivi gëlqeror me vegjetacion të rrallë kalcifil dhe hezmofitë (bimë të adaptuara për jetë në tokë të varfër dhe të pazhvilluar), ku veçohet lloji Hieraacium kabilicanum. Ka sipërfaqe prej 12 ha.

3. Rajoni i burimit të Lumëbardhit- është cirku silikat akullnajor i maleve të larta dhe me dy liqene të vegjël. Ky regjion karakterizohet me vlera të posaçme ekologjike, gjeologjike, biologjike dhe peijzazhore. Në kuadër të këtij rezervati gjendet rrjedha e epërme e Lumbardhit të Prizrenit, dy liqene (të katundit të Epërm) me gjurmë të qarta glaciale dhe me florë të pasur endemike, ku veçohen llojet: Pinguicla balcanica, Alysum scardicum, Crocus scardicus dhe reliktet glaciale Anemone narcissiflora dhe Draba doerfleri etj. Sipërfaqja është rreth 40 ha.

4. Luboteni- është maja më e lartë në pjesën lindore të Maleve të Sharrit (2.496m). Është karakteristike se përbërja gjeologjike e saj është kryesisht gëlqerore, e që kjo e bën të dallohet nga pjesët tjera zingjirore me përbërje gjeologjike nga silikati. Në

kuadër të florës gjenden edhe lloje të rralla. Deri tani janë konstatuar 649 lloje të bimëve vaskulare të grupuara në 81 familje. Në kuadër të vegjetacionit të Lubotenit deri më tani janë konstatuar 21 asociacione bimore me sipërfaqe prej 50 ha.

Figura 24. Pyjet e rrobullit (***Pinus heldreichi***) në rezervatin Pisha e Madhe, të djegura ne vitin 2007

5. Livadhi i mbretit – **Liqeni i Jazhincës -** shtrihet në pjesën shkëmbore të Maleve të Sharrit nën Majën e Bistrës me sipërfaqe afër 50 ha. Në këtë vend mund të gjenden këto bashkësi bimore: Fagetum Montanum, Seslerio automnalis – Pinetum heldreichii, Ajugo – pinetum peucis etj. Në pjesët më të larta të këtij lokaliteti gjenden këto bashkësi: Rhododendron – Pinetum peucis, një lloj dëllinje (Juniperus sp.) etj. Ndërsa në pjesët e epërme bashkësitë e bimëve barishtore si Ranunculetum crenati scardicum dhe Potentillo doerfleri – Juncetum trifidi. Këto bashkësi kanë vlera shkencore dhe edukative.

Problemet të cilat janë evidentuar në Parkun Nacional “Mali Sharr” janë:

- Mospërputhshmëria në mes të ligjeve ekzistuese (Ligji për Parkun Nacional „Mali Sharr”,1986; Ligji për Pyjet,2004; Ligji për Mbrojtjen e Natyrës,2005);
- Përzierje kompetencash. (Parku Nacional menaxhohet nga tre subjekte Drejtoria e Parkut me seli në Prizren, Drejtoria e Parkut me seli në Shtërpce dhe Agjencia e Pyjeve e Kosovës;
- Mungesa e planit hapësinor dhe planit të menaxhimit;
- Shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve natyrore, prerja dhe dëmtimi i pyjeve,

- Zjarret në rezervatin: Pisha e Madhe, Arnen dhe në disa zona të tjera të Parkut;
- Paraqitja e sëmundjeve nga insektet dëmtuese;
- Veprimtaritë e gurëthyesve në territor të Parkut;
- Ndërtimet brenda Parkut (fshati turistik në Prevallë);
- Mosdefinimi i plotë i kufirit të jashtëm të Parkut (është përcaktuar kufiri i jashtëm vetëm në territorin e Komunës së Prizrenit dhe Suharekës. Zonimi i brendshëm i Parkut (ende nuk ka përfunduar), etj.

Monumentet e Natyrës

Monument Natyror është territori që përmban një ose më shumë veçori specifike natyrore dhe kulturore me vlera të posaçme ose unikate, për shkaqe rariteti, vetish natyrore, reprezentative, rekreative dhe estetike ose vlera të posaçme kulturore.[11]

Monumentet Natyrore mund të jenë me karakter:

a) gjeologjik (paleontologjik, mineralogjik, hidrogjeologjik, gjeologjik, sedimentet)
b) gjeomorfologjik (shpella, humnera, shkëmbinj);
c) hidrologjik (ujërrjedha, ujëvara, liqene);
d) botanik (ekzemplarët e rrallë të botës bimore);

Monumentet e natyrës shpallen nga Komuna, përveç atyre me rëndësi të posaçme për Kosovën të cilat shpallen nga Qeveria, në propozim të AKMM.

Qëllimet e menaxhimit të monumenteve natyrore janë:

- mbrojtja dhe ruajtja e vetive të qëndrueshme natyrore me rëndësi të posaçme, cilësive unikate, dhe vlerave inspiruese;

Figura 25. Ujëvara e Drinit të Bardhë

11 Neni 20 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës (2006/22)

- ofrimin e mundësive për kërkime shkencore, arsimore, interpretuese dhe vlerësuese nga publiku;
- ndalimi dhe pengimi i shfrytëzimeve dhe vizitave të cilat mund të shkaktojnë ndryshime ose dëmtime;
- ofrimi i beneficioneve aq sa është e lejueshme për popullatën e cila jeton në ato territore, në pajtim me qëllimet menaxhuese.

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura, Monumentet e Natyrës marrin pjesë me 4.874 ha, ndërsa për nga numri zënë vend të konsideruar. Numri i Monumenteve Natyrore është 59, prej tyre 35 me karakter botanik, 10 me karakter hidrologjik, 10 me karakter gjeomorfologjik etj

Zonat më të rëndësishme të kësaj kategorie të mbrojtur janë: Shpella e Gadimes, Gryka e Rugovës, Burimi i Drinit të Bardhë me Shpellën dhe Ujëvarën në Radavc, Gryka e lumit Klina, Ura e Fshajtë, Rrapi në Marash dhe shumë Trungje të vjetra, Burime ujore termominerale, Shpella etj.

Gjendja e Monumenteve të Natyrës

"Shpella e Gadimes"

Gjendet në afërsi të Lypjanit (pranë rrugës Prishtinë – Ferizaj), në kodrën Murtur të fshatit Gadime e ulët, me lartësi mbidetare 580 m. Shpella quhet edhe Shpella e Mermertë, ngase është e ndërtuar në shkëmbinj të mermertë dhe është një ndër shpellat më të bukura jo vetëm në Kosovë, por edhe në Ballkan e më gjerë.

Në "Shpellën e Gadimes" paraqiten të gjitha llojet e stolive karakteristike për shpellat. Më së shumti ka stalagmite dhe stalaktite që paraqiten në të gjitha pjesët e shpellës, në forma dhe madhësi të ndryshme. Posaçërisht tërheq vëmendjen stolia aragonite. Nuk ekzistojnë shpella në botë të kenë kaq stoli aragonite dhe në kaq forma të shumëllojshme. Kanali i aragonitit në Galerinë veriore është rast unikat. Plafoni i tij është mbuluar me gërshetim aragonit kristalesh të formave të ndryshme me ngjyrë të bardhë dhe të kaltër të cilët i ngjajnë rrjetës së shpeshtë të merimangës. Disa kristale prej tyre janë të orientuar në të gjitha drejtimet, të lakuar dhe me thyerje brrylore me gjatësi deri 30 cm..

Shpella e vjetër me dhjeta miliona vite, është zbuluar ne vitin 1969. Për herë të parë është vënë nën mbrojtje me 29 korrik 1969. Ndërsa në vitin 1982 është marrë vendimi i ri për vënien në mbrojtje të Shpellës si gjeomonument me vlera të posaçme të natyrës. Sipërfaqja e mbrojtur e shpellës është 56,25,02 ha (në pronësi shtetërore 36,34,88 ha dhe pronësi private 19,91,04 ha).

Figura 26. Shpella e Gadimes

Për vlerësimin më të plotë të gjendjes së “Shpellës së Gadimes”, është marrë parasysh gjendja e saj përreth dhe në brendësi.

Në kodrën e Murturit, në të cilën është krijuar shpella, në pjesën veriperëndimore të saj janë konstatuar dukuritë e gërryerjes së materialit shkëmbor nga rreshpet . Po ashtu, në këtë pjesë është ndërtuar edhe rezervuari i ujit për furnizim me ujë të vendbanimit Gadime e Epërme. Gjithashtu, vërehet dukuria e ndërtimeve private të shtëpive dhe hapjes së puseve në shpatet perëndimore të kodrës së Murturit.

Në pjesën jugore të Kodrës së Murturit, janë instaluar një numër guroresh (8) në të cilat eksploatohet guri gëlqeror në mënyrë intensive. Meqë është fjala për të njëjtën thjerrëz gëlqerore, në një pjesë të secilës është zhvilluar shpella, supozohet se minimi gjatë eksploatimit ka ndikim në destabilizimin e shpellës dhe dëmtimin e stolive speleologjike.

Po ashtu, janë konstatuar edhe veprime të ndryshme në shtratin e lumit Klysyr përballë shpellës, të cilat kanë çrregulluar gjendjen e mëparshme që mund të rezultojnë me efekte direket në Shpellë. Në afërsi të hyrjes në Shpellë janë ndërtuar objekte që nuk janë në funksion të destinimit të shpellës.

Figura 27. Pamje e kodrës Murtur ku gjendet Shpella

Në brendësi të Shpellës janë konstatuar këto ndryshime:

- Në disa vende në shpellë janë aktivizuar disa qarje të mëdha ekzistuese si është rasti me zonën tektonike në hyrje dhe në fillim të kanalit të Galerisë të Lotëve. Ekziston rreziku i shembjes dhe rënies së copave të shkëmbinjve në korridoret që frekuentohen nga vizitorët;
- Nga ndikimet hidrologjike dhe hidrogjeologjike në kanalet karstike në tavan dhe anëve janë riaktivizuar dhe kanë lëvizur masat argjilore;
- Është konstatuar se në shpellë ka ndryshime të dukshme hidrogjeologjike, gjë që është manifestuar dukshëm në zvogëlimin e qarkullimit të ujërave nëntokësore. Supozohet se përveç ndikimeve nga ndryshimet e ciklit hidrologjik, në zvogëlimin e qarkullimit të ujit ka ndikuar edhe shfrytëzimi intensiv i ujit nëntokësore nga pusi i hapur në afërsi të shpellës. Supozojmë

Figura 28. Mihja e dheut në kodrën Murtur

Figura 29. Mbyllja e shtratit të lumit Klysyr në afërsi të Shpellës

se nga këto veprime ka rezultuar tharja dhe ulja e nivelit të ujit në liqenet e shpellës;

- Në shpellë është konstatuar, në përmasa jashtëzakonisht brengosëse, paraqitja e myshqeve dhe zverdhja e stolive speleologjike, gjë që do të ketë ndikime serioze në proceset e zhvillimit të mëtejmë të shpellës. Supozohet se këto ndryshime janë pasojë, përveç tjerash, edhe e ndryshimeve mikroklimatike, të kushtëzuar me mbylljen hermetike të hyrje-daljes si dhe ndriçimi afatgjatë dhe jo adekuat;

Figura 30. Pamje nga punimet e një gurëthyesi në Gadime të Ulët

- Në shpellë janë vërejt dëmtime fizike (thyerje etj.) si dhe larje mekanike të stolive gjë që zvogëlon vlerën e vetë shpellës;

Figura 31

Figura 33

Figura 32. Rrjeti elektrik për ndriçim i shkatërruar, rrezik permanent!

Figura 34. Zhvillimi i myshqeve dhe kërpudhave në Shpellë

Figura 35. Thyerja dhe shkatërrimi i kristaleve të Shpellës

Figura 36. Shembjet e dheut në Shpellë

Figura 37. Grafite dhe mbishkrime në Shpellë

- Është brengosëse edhe dukuria e mbishkrimeve dhe grafikeve të ndryshme që hasen kudo nëpër korridoret e shpellës, dukuri kjo që në masë të madhe e dëmton imazhin dhe origjinalitetin e këtij monumenti natyror;
- Ndriçimi i shpellës është joadekuat dhe rrjeti elektrik në shpellë është shumë i dëmtuar, që paraqet rrezik për vizitorët;
- Në shpellë kryhen punime dhe kërkime ilegale pa konsultime me institucionet përgjegjëse;
- Menaxhimi i shpellës është shumë i dobët dhe pa kritere profesionale dhe shkencore.

Shpella dhe burimi i Drinit të Bardhë në Radavc

Figura 38 Ujëvara e Drinit të Bardhë në Radavc

Figura 39. Hyrja e shpellës së Radavcit

Figura 40. Ndotja e kristaleve nga numri i madhe i lakuriqëve

Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit janë vënë nën mbrojtje në vitin 1983, si monumente natyrore me sipërfaqe prej 89.94 ha.

Shpella dhe Burimi i Drinit të Bardhë gjenden afër fshatit Radavc, rreth 11- km larg qytetit të Pejës, pranë rrugës (Pejë-Rozhajë). Këto dy bukuri të trashëgimisë natyror gjenden në pjesën verilindore te vargmaleve të Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Shqiptare)

Shpella e Radavcit është shpellë tipike e burimeve. Formimi i saj është i lidhur me erozionin dhe punën kimike të ujërave nëntokësor të Drinit të Bardhë.

Gjatësia e përgjithshme e kanaleve të hulumtuara në shpellën e Radavcit është 1420 m, ndërsa kanalet horizontale janë të gjata 680 m. Hyrja e shpellës gjendet në lartësinë mbidetare prej 578 m, me hyrje të hapur që e ka formën e trekëndëshit të parregullt. Galeria kryesore përbëhet prej tri pjesëve: kanalit hyrës, galerisë qendrore dhe kanalit të vaskave.

Në pjesën më të madhe të galerive dhe korridoreve të shpellës vërehen gjurmët e pranisë së lakuriqëve. Dukuri shqetësuese për Shpellën e Radavcit është hyrja e personave të paautorizuar në shpellë, me c'rast janë vërejtur mbishkrime dhe grafite të ndryshme në muret dhe korridoret e shpellës. Ndërsa pranë burimit të Drinit të Bardhë dhe Ujëvarave, vërehen një numër i madh i mbeturinave.

Figura 41. Pamje nga Gryka e Rugovës

Gryka e Rugovës

Gryka e Rugovës, si Monument i Mbrojtur i Natyrës, është një ndër zonat me vlera më të veçanta gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, biodiversitet dhe vlera turistike dhe rekreative.

Në këtë zonë janë identifikuar disa probleme. Rruga e asfaltuar përgjatë Grykës së Rugovës e dëmtuar paraqet rrezik për sigurinë e vizitorëve. Ndërtimi i kompleksëve turistik, restoranteve, fabrikës për përpunimin e ujit të pijes, kanë ndikuar në dëmtimin e peizazhit natyror.

Figura 42. Shembjet e dheut në rrugë, Grykë e Rugovës

Figura 43. Fabrika e përpunimit të ujit të pijes

Figura 45. Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë

Figura 46. Prodhimi i betonit dhe separacioni i rërës në Zonën e Mbrojtur

Figura 47. Objekt hotelier në Zonën e Mbrojtur

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë

Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë është Monument Natyror me karakter hidrogjeologjik dhe si i tillë është vënë nën mbrojtje në vitin 1986. Zona e Mbrojtur ka sipërfaqe prej 199 ha, dhe shtrihet në territorin e Komunave Rahovec[12] dhe Gjakovë[13]. Lumi, Drini i Bardhë gjatë një procesi të gjatë gjeomorfologjik ka hapë një grykë në mes të dy shkëmbinjve gëlqerorë për të formuar një kanion shumë tërheqës dhe interesant për studiues dhe vizitorë.

Në zonën e mbrojtur të kanionit janë evidentuar ndërtime dhe ndërhyrje të cilat e kanë prishë peizazhin e kësaj zonë**.**

12 Vendimit 01 nr. 352-13 të dt. 9.04.1986 i KK Rahovec

13 Vendimit 01 nr. 011-10 të dt. 05 Mars 1986 të KK Gjakovë

GJENDJA E BIOMONUMENTEVE

Trungjet dhe komplekset e trungjeve i përkasin kategorisë së monumenteve të natyrës me karakter botanik [14]. Në kuadër të zonave të mbrojtura të natyrës ekzistojnë 35 monumente natyrore me vlera botanike, shumica prej tyre janë trungje ose komplekse të trungjeve.

Gjatë vitit 2005/2007 janë realizuar dhjetëra vizita në terren për të parë nga afër gjendjen e këtyre monumenteve të mbrojtura të natyrës. Sipas të dhënave të grumbulluara gjatë këtyre vizitave është konstatuar se disa nga trungjet e mbrojtura janë në gjendje jo të mirë natyrore, ndërsa disa trungje që kanë statusin e monumenteve natyrore të mbrojtura tani janë në procedurë për largimin nga lista e zonave të mbrojtura, për shkak se janë dëmtuar nga faktorët e ndryshëm (zjarri, faktori antropogjen) etj.. (Tabela 4 & figura 48).



Figura 48. Gjendja aktuale biomonumenteve

14 LMN 2006/22, neni 24.2 , d) monument natyror me karakter botanik (ekzemplarët e rrallë të botës bimore, kopshti botanike);

Tabela 4. Gjendja aktuale e biomonumenteve

Nr.	Biomonumente në gjendje të mirë natyrore	Nr.	Biomonumente të dëmtuara	Nr.	Biomonumente që kanë humbë vlerat
1	Rrapi i Marashit (Platanus orientalis) në Marash	24	Trungu i Plepit (Populus tremula) në Bajqinë,	27	Trungu i Arnenit në Nerodime të Epërme
2	Trungu i Qarrit (Quercus cerris) në Dobratin	25	Trungu i Qarrit (Quercus sp) në Dumnicë të Ulët	28	Trungu i Vidhit fushor në Lukinaj
3	Trungu i Qarrit (Quercus cerris) në Pollatë	26	Trungu i Qarrit (Quercus cerris) në Zllakuqan	29	Trungu i Vidhit (Ulmus minor Miller) në Qabiç
4	Trungjet e Bungut në Llazicë			30	Trungu i Qarrit në Potërq
5	Trungu i Manit (Morus sp.) në Pejë			31	Trungu i Plepit (Populus tremula) në Orllan
6	Trungu i Blirit (Tilia argentea) në Isniq			32	Trungu i Blirit (Tilia argentea) në Strellc
7	Trungjet e Dushkut, gjashtë lisat (Likoshanë)			33	Trungjet e Qarrit në Bërkovë
8	Trungjet e Dushkut (Terstenikë)			34	Trungu i Bungut në Lubovec
9	Trungu i Dushkut (Likoshanë)			35	Kompleksi i Trungjeve në Ramjanë (kompleks Momerial)
10	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubercens ëilld.) Aqarevë				
11	Trungjet e Dushkut (Quercus sp.) Polac				
12	Trungu i Dushkut (Quercus sp.) në Likovc				
13	Trungu i Dushkut (Quercus sp.) në Prellovc				
14	Kompleksi i Trungjeve të Dushkut (Quercus sp.) Rrezallë				
15	Kompleksi i Trungjeve të Bungbutës (Quercus pubescens Willd.) në Klladernicë				
16	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) në Kotorr				
17	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) në Padalishtë				

18	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens ëilld.) në Çitak				
19	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) në Runik				
20	Trungjete e Blirit (Tilia argentea) në Isniq				
21	Kompleksi i Trungjeve të rrënjës (Negroc)				
22	Trungjet e Shpardhit (Negroc)				
23	Trungu i Qarrit (Krajkovë)				

Figura 49. Rrapi (*Platanus orientalis*) në Marash, monument botanik

Figura 50. Kompleksi i gjashtë lisave në Likoshan, monument i natyrës me rëndësi botanike dhe historike

Figura 51. Trungu i plepit (*Populus tremula*) në Bajqine, biomonument i demtuar

2.4. Parqet regjionale

Në kuadër të Zonave të Mbrojtura, Parqet Regjionale zënë sipërfaqen prej 1. 681 ha. Parqe të tilla në Kosovë janë dy, Parku i Mirushës me 555. 80.70 ha dhe Parku i Gërmisë 1126 ha.



Figura 52. Harta e parqeve regjionale

Mirusha

Kanioni i Mirushës është një ndër zonat më interesante të natyrës së Kosovës. Lumi Mirusha në pjesën e poshtme të rrjedhës së tij kalon nëpër një grykë e cila njihet si Kanioni i lumit Mirushë. Në këtë pjesë të kanionit janë 16 ujëvara me liqene që e përbëjnë pjesën më atraktive të kanionit.

Parku Natyror i Mirushës gjendet në të dy anët e rrjedhës së lumit Mirusha që nga fillimi i kanionit deri në derdhjen e tij në lumin Drini i Bardhë. Sipërfaqja e territorit të mbrojtur të Parkut Regjional të Mirushës është **555. 80.70 ha,** dhe shtrihet në territorin e Komunave: Klinë[15], Malishevë dhe Rahovec[16].

15 GZK Nr. 3/76 dhe 41/81 24 Maj 1982.
16 GZK Nr.21/76 date 15 shkurt 1983

Figura 53. Ujëvarat e Mirushës

Flora, vegjetacioni dhe fauna- është mjaft i pasur me lloje dhe bashkësi bimore e shtazore. Pjesa më e madhe e rajonit i takon bashkësisë së bungut (**Ass. Querrcetum farnetto - cerris scardicum Krasniqi 1968**), që në të vërtetë është një ndër bashkësitë më të përhapura pyjore në Kosovë. Në territorin e Parkut të Mirushës gjenden 330 lloje të bimëve vaskulare, duke mos i llogaritur bimët e ulëta dhe myshqet. Nga bimët e ulëta janë evidentuar 44 specie kërpudhash të larta (makromicetesh), ndërsa në territorin e gjerë të rajonit të Mirushës janë prezentë 838 taksone bimore të përfaqësuara me 590 lloje të bimëve vaskulare.

Veçanti e florës së rajonit të Mirushës është prania e 14 bashkësive (asociacioneve) bimore, 5 prej të cilave kanë karakter endemik, ndërsa numri i llojeve endemike është 21. Prej tyre lloji **Aristolochia merxmuelleri** është lloj stenoendemik dhe deri tani në nivel botëror është konstatuar vetëm në këtë rajon në disa lokalitete relativisht të ngushta.

Fauna – Në rajonin e Mirushës janë vërejtur këto lloje të shtazëve: derri i egër (*Sus scrofa*), vjedulla (*Meles meles*), lepuri (*Lepus europaeus*), ketri (*Scirius vulgaris)*, ujku (*Canis lupus*), maca e egër (*Felis silvestris*), Sqarthi (*Martes Martes*), miu

bizam (*Ondatra zibethica*), miu i verdhë malor (*Apodemus flaviocollis*), iriqi (*Erinaceus concolor L.*), breshka e tokës (*Testudo sp.*). gj*arpëri helmues i gurit (Vipera amodytes)*. etj. Përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha ekzistojnë kushte të volitshme për jetën e ujëtokësorëve dhe peshqve.

Ndërtimet dhe ndërhyrjet në shtratin e lumit si dhe dëmtimi i vegjetacionit janë probleme të evidentuara dhe që dëmtojnë vlerat natyrore dhe biodiversitetin e zonës. Mungesa e një organi menaxhues për parkun regjional Mirusha gjithashtu është një problem i cili kërkon zgjidhje.

Në hyrje të zonës së mbrojtur pranë rrugës për të ujëvarat janë ndërtuar dy objekte. Ndërtimi i këtyre objekteve ka ndikim të drejtpërdrejt edhe në shtratin e lumit Mirushë. Nga ndërhyrja përgjatë rrjedhjes së lumit Mirushë (ana e djathtë e rrjedhjes së lumit) vërehen ndikime në fitocenozën e shelgut (***ass. Salicetum albae***). Në këtë fitocenozë janë prezent llojet drunore: *Salix alba, Fraxinus angustifola, Populus nigra., Cornus mas, Acer campestre* dhe *Carpinus betulus*. Shumica e drurëve të lartpërmendur janë të ngulfatur nga gurët dhe betoni gjatë punimeve. Në sipërfaqen e gërryer të livadhit përgjatë anës së djathtë të bregut të lumit janë mbjellë 7 trupa të llojit të kultivuar *Thuja sp.* Po ashtu nga gërryerja e shtresës sipërfaqësore të livadhit në thellësi 10-40 cm, është shkatërruar tërësisht *ass. Salvio-Scorzoreneretum villosae*.

Fitocenoza e lartpërmendur në Kosovë deri më tani është konsistuar vetëm në rrethinën e Volljakës dhe përgjatë rrjedhjes së lumit Mirushë.

Figura 54. Ndërtimet në Zonën e Mirushës

Figura 55. Ndërhyrja në shtratin e lumit Mirusha

Parku "Gërmia"

Shtrihet në verilindje të kryeqendrës së Kosovës (Prishtinës) dhe përfshinë një sipërfaqe prej 62 km^2. Kufijtë e Gërmisë fillojnë prej kodrës së vreshtave në perëndim, pastaj në lindje të Prishtinës përmes kodrës së Mirditës deri të xeherorja e Ajvalisë dhe deri të rrjedha e lumit të Graqanicës. Kufiri jugor shkon përmes rrjedhës së lumit Graqanicë deri të derdhja e lumit të Busisë në të. Në lindje kufiri shtrihet përmes lumit të Busisë deri të fshatrat Mramor e Butos e pastaj deri të lumi i Prishtinës i cili është kufiri verior i këtij masivi malor. Pika më e lartë e Gërmisë është maja e Butosit me lartësi mbidetare prej 1050 m.

Figura 56. Vegjetacion pyjor nga Gërmia

Relievi i Gërmisë përbëhet prej kodrave me lartësi dhe pjerrësi të ndryshme, të ndara mes tyre me hapësira të luginave, të përroskave dhe lumenjve. Këtu posaçërisht veçohet lugina e lumit Vellusha që buron në pjesën perëndimore të kodrës së Butosit, e cila edhe përfaqëson relievin më karakteristik me lartësi mbidetare 1000 m dhe gjatësi prej afro 8 km. Kjo pjesë shtrihet në mes të lumit të Prishtinës në veri dhe atij të Badocit në jug, e që njëkohësisht paraqet nyjën hidrologjike të lumit të Prishtinës, Vellushës dhe Badocit.. Përndryshe në Gërmi ekzistojnë edhe mjaft burime të cilat gjatë periudhës verore pjesërisht thahen. Sot uji I këtyre burimeve është i lidhur me një rrjetë që derdhet në pishinën e Gërmisë.

Pasuria floristike, vegjetative dhe faunistike e Gërmisë

Në saje të pozitës gjeografike, veçorive gjeologjike, pedologjike, kushteve klimatike, masivi malor i Gërmisë është mjaft i pasur si në pikëpamje floristike, vegjetative dhe faunistike.

Nga hulumtimet e deritashme janë të evidencuara *610 lloje të florës vaskulare* të grumbulluara në 82 familje dhe *83 lloje kërpudhash* duke mos llogaritur taksonet e barërave të këqija, atyre ruderale dhe bimëve tjera të ulëta. Prej tyre 5 lloje janë endemike dhe 12 lloje mjekësore.

Vegjetacionin pyjor të Gërmisë e përbëjnë *4 bashkësi pyjore*: *Bashkësia e shpardhit dhe qarrit (prej 600- 700 m lartësi mbidetare)*, *bashkësia e bungut dhe shkozës (800 m*), *bashkësia e bungut (820- 870 m) dhe bashkësia e ahut (1000 m).*

Kompleksiteti i biotopeve natyrore të Gërmisë siguron kushte për jetesën e një sërë llojesh shtazore. Sipas hulumtimeve të bëra deri më sot dhe sipas shënimeve të literaturës në regjionin e Gërmisë janë regjistruar: 5 lloje ujëtoksorësh, 7 lloje të rrëshqitësve, 19 lloje të gjitarëve dhe 30 lloje të shpendëve. Po ashtu jetojnë edhe një numër i madh i insekteve që përbëjnë grupin më të madh të shtazëve në këtë masiv. Ndërsa të dhënat nga terreni sot janë alarmante, flitet për zhdukjen e shumë llojeve bimore dhe shtazore.

Figura 57. Zona rekreative në Parkun e Gërmisë

Figura 58. Harta e parkut Gërmia

Figura 59. Pishina në Parkun e Gërmisë

Në vitin 1966 [17] vendoset që një pjesë e masivit malorë të Gërmisë të shpallet si "*Pyje për piknik*". Në vitin 1987 [18] Kuvendi Komunal i Prishtinës merr Vendim për vënien nën mbrojtje të Kompleksit të "Gërmia" në kategori të Parkut Regjional të Natyrës . Me këtë është mbrojt sipërfaqja prej *1.126.01.00 ha.* Në bazë të këtij vendimi Parkun e menaxhon *OP. "Hortikultura*", ndërsa mbikëqyrjen profesionale e bën Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës.

Gjendja e përgjithshme:

- Gjatë vitit 2007 në disa lokalitete në Parkut Regjional "Gërmia" (të antena Gërmia II, Restorant Freskia, rajoni Gërmia I), janë shfaqur zjarre, ku kanë përfshirë një sipërfaqe prej 12 ha. Te pishat, Gërmia II, zjarri ka përfshi një sipërfaqe rreth 10 ha. (në pjesën te antena dhe përreth saj).Terreni i prekur nga zjarri është i pyllëzuar nga pisha e bardhë, në sasi të vogla, gjithashtu në këtë terren janë të përhapura edhe lloje tjera të dushkut dhe shkurreve: juniperus comunis dhe juniperus Oxidentalis. E tërë kjo sipërfaqe është e mbuluar edhe me lloje të ndryshme të bimëve barishtore. Sipërfaqja e djegur llogaritet të jetë rreth 10 ha. Në mënyrë indirekte nga zjarri i shkaktuar ka pësuar dëme të konsiderueshme edhe fauna në humbjen e arealit të saj, ku është bërë migrim i dhunshëm nga ky terren;
- Janë të dukshme dëmtime të ekosistemeve të ndryshme përmes eksploatimit të pyjeve dhe si rezultat i kësaj dukurie është paraqitë erozioni dhe rrëshqitja e tokës. Po ashtu kjo ka ndikuar edhe në çrregullimin dhe zvogëlimin e rrjedhave të ujit, e cila ka shkaktuar edhe ndryshueshmëri në strukturën e bashkësive jetësore bimore dhe shtazore. Meqenëse "Gërmia" paraqet një rajon shumë të rëndësishëm dhe interesant në aspektin floristik, vegjetativ, faunistik dhe turistik-rekreativ, është e domosdoshme që të ndërmerren masa adekuate për mbrojtjen e saj nga degradimi i mëtejmë;
- Ndërtimi i qendrës administrative protokollare të Kuvendit të Kosovës nga Kuvendi i Kosovës (2005) dhe ndërtime të tjera;

17 "GZK" nr. 32/66
18 "GZK" nr. 43/87.

- Dëmtimi i masës drunore prej insekteve- nenlevorëseve (Blastofagus sp.);
- Grumbullim dhe hedhje e mbeturinave në vende joadekuate vërehet në pjesët periferike të parkut, ndërsa edhe përkundër numrit të madh të vizitorëve që frekuentojnë zonën rekreative nuk vërehen mbeturina jashtë vendeve të destinuara për to;
- Drurë të thatë dhe të rrëzuar vërehen në zonën e bombarduar nga forcat e NATO-s;
- Zonat e minuara;
- Zonimi dhe shenjëzimi i parkut. etj.

Figura 60. Pyjet e dëmtuara nga zjarri në Gërmi

Figura 61. Ndërtim në Parkun e Germisë

Figura 62. Ndërtimi i qendrës administrativo protokollare në Gërmi

3. ZONAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJE

Gjatë periudhës 2002- 2006 Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë njohjen dhe evidentimin e vlerave të reja të natyrës në 16 Komuna (Gjakovë, Skenderaj, Drenas, Burim, Rahovec, Kastriot, Vushtrri, Gjilan, Malishevë, Mitrovicë, Klinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Therandë, Lipjan dhe Viti). Gjatë këtij procesi janë propozuar për mbrojtje mbi 200 zona të reja të kategorive të ndryshme të mbrojtjes, shumica prej tyre monumente natyre me karakter botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik etj,

Në vitin 2003 ka nisur iniciativa për shpalljen në mbrojtje edhe të një Parku të Dytë Nacional "Bjeshkët e Nemuna". IKMN ka bërë arsyeshmërinë profesionale në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës dhe institucionet e tjera. Shpallja e territorit të "Bjeshkëve të Nemuna" Park Nacional me sipërfaqe rreth 60.000 ha, është në pritje të miratimit të ligjit për parqe nacionale. Me marrjen në mbrojtje të kësaj zone dhe zonave të tjera të propozuara, sipërfaqja e mbrojtur në Kosovë do të arrinte mbi 10 % të territorit.

Prej zonave të propozuara gjatë vitit 2006 -2007 janë marrë nën mbrojtje 24 zona të reja (11 në territorin e Komunës së Drenasit dhe 13 në territorin e Komunës së Skenderajt). Sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura është rritur për 7.25 ha. Në procedim të mëtejmë kanë mbetur edhe 195 zona.



Figura 63. Numri i zonave të propozuara për mbrojtje sipas Komunave

Figura 64. Harta e Zonave të Propozuara

Bjeshkët e Nemuna

"Bjeshkët e Nemuna" për nga përbërja gjeologjike, gjeomorfologjike, floristike dhe faunistike paraqesin masivin më të rëndësishëm dhe më interesant jo vetëm të Kosovës, por edhe të tërë Gadishullit Ballkanik. Bota e gjallë e "Bjeshkëve të Nemuna "(e shprehur përmes florës, vegjetacionit, faunës etj) është e begatshme dhe e llojllojshme.

Flora, vegjetacioni dhe fauna shquhet për shumëllojshmëri biologjike e peijzazhore, falë pozicionit gjeografik, kushteve gjeologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të relievit e të klimës. Relievi i thyer dhe vertikaliteti i theksuar ofrojnë kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh bimore dhe shtazore.

Sipas shumë studimeve, gjenden mbi 1500 lloje bimore, shumë prej tyre janë lloje relikte si: Acer heildreichii, Asyneuma trichocalicinum, Campanula lingulata, Cardamine glauca, Castane sativa, Cotinus coggigria, Edrianthus graminifolius, Edrianthus tenuis etj. 19 lloje kanë statutin e mbrojtjes së plotë si: Pinus peuce, Pinus mugho, Pinus heildreichi, Taxus baccata, Alnus viridis, Quercus trojana, Spirea canea, Acer heildreichii, Acer intermedium, Daphne laureola, Forsythia europea, Gentiana lutea, Wulfenia carinthiaca, Ramonda serbica, Succisa pratensis, Leontopodium alpinum, Lilium martagon, Dactylorhiza cordigera dhe Dactylorhiza majalis. Nga llojet endemike dhe joendemike të florës, në European Red List janë 4 lloje: Viola elegantula, Sempervivum macedonicum, Ramonda serbica, Narthecium scardicum.

Fauna e "Bjeshkëve të Nemuna" në bazë të hulumtimeve të gjertanishme përbëhet prej :8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtokësorësh, 10 lloje zvarranikësh, 148 lloje shpendësh, 36 lloje gjitarësh (*pa llogaritur lakuriqët*), 129 lloje flutura nga rendi Lepidoptera.

Iniciativat për shpalljen e "Bjeshkëve të Nemuna" Park Nacional

Iniciativa për shpalljen e "Bjeshkëve të Nemuna" Park Nacional ka nisur në vitin 1970 nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës dhe ka vazhduar përsëri në vitin 1985 nga Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës. Sipas kësaj iniciative Parku Nacional "Bjeshkët e Nemuna" do të përfshinte pjesë të territorit të Komunës së Pejës dhe Deçanit. Komuna e Deçanit nuk e dha pëlqimin, për këtë u vendos që vetëm pjesa që i takon Komunës së Pejës të shpallet dhe njëherësh u përgatit "Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së Bjeshkëve në Komunën e Pejës për Park Nacional"

Në vitin 2002 Instituti i Kosovës për mbrojtjen e Natyrës përsëri inicioi shpalljen e "Bjeshkëve të Nemuna" Park Nacional. Sipas kësaj iniciative ishte paraparë që në Parkun Nacional të përfshihen pjesë të territorit të Komunës së Pejës, Istogut, Deçanit dhe Gjakovës. Në vitin 2003 është përgatitë "Studimi për arsyeshmërinë e shpalljes së "Bjeshkëve të Nemuna " Park Nacional dhe njëherësh është përgatitë edhe projektligji për të.

Iniciativën e ka përkrahë Qeveria e Kosovës dhe Kuvendi i Kosovës në seancën e mbajtur më 3.4.2003. Po ashtu edhe Kuvendet Komunale përkatëse e kanë dhënë pëlqimin.

Gjendja në territorin e "Bjeshkëve të Nemuna"

Një ndër problemet më të mëdha në territorin e "Bjeshkëve të Nemuna" është prerja e pyjeve. Aktualisht me pyjet e territorit të "Bjeshkëve të Nemuna" menaxhon Autoriteti Pyjor i Kosovës (APK). Prerjet ilegale janë duke u bërë pothuajse në të gjitha Komunat ku shtrihet territori i "Bjeshkëve të Nemuna"(Gjakovë, Deçan, Pejë dhe Istog).

Prerjet e pakontrolluara të pyjeve kanë pasoja të pariparueshme, që përveç humbjes së masës drunore, reflektojnë drejtpërdrejtë edhe në çrregullimin e ekosistemit, shqetësimin e botës shtazore, prishjen e peizazhit, paraqitjen e erozionit etj.

Problem tjetër aktual është edhe ndërtimi i shumë objekteve, kryesisht hoteliere, por edhe të banimit. Në mungesë të planit hapësinor dhe zhvillimor të zonës, ndërtimet bëhen pa kritere mjedisore, hapësinore e urbanistike. Ndërtimi i objekteve shoqërohet më gërryerje të sipërfaqeve të cilat dëmtojnë peizazhin dhe biodiversitetin përreth. Ndërtimet janë më të shprehura në zonat potenciale turistike, si në Grykën e Rugovës, Bogë, Leqinat etj.

Figura 65. Kompleksi i vikendshtëpizave, Leqinat

Figura 66. Prerja e pyjeve ne Bjeshkët e Junikut

Figura 67. Prerja e pyjeve në Grykë të Rugovës

Figura 68. Erozioni si pasojë e prerjes se pyjeve në Bjeshkët e Nemuna

Shpella "Gryka e Madhe" në Grykë të Rugovës

Shpella "Gryka e Madhe" ndodhet në kilometrin e tetë (8) të Grykës së Rugovës, në anën e majtë, 60 m, mbi shtratin e Lumëbardhit të Pejës, në lartësinë mbidetare 637 m.

Hulumtimet në shpellën "Gryka e Madhe" kanë filluar në vitin 1992, nga disa speleolog Sllovak, të cilët ishin në kalim e sipër nëpër Grykën e Rugovës për në Maqedoni, edhe pse kjo shpellë ka qenë e njohur nga banorët lokal që prej kohe. Ekspeditat hulumtuese të tyre vazhduan edhe në vitet 1996 -2007 me një ndërprerje në periudhën 1998-2001.

Korridoret e hulumtuara gjatë ekspeditës së fundit kanë profil oval, janë me homogjen, dhe të dimensioneve më të mëdha se sa ato korridore të pjesës së poshtme të shpellës, të cilat kanë karakter të një kanjonit të vazhdueshëm nëntokësorë, me mure mjaft të larta. Nivelet më të larta të shpellës nuk kanë sedimente, por janë me fundërrina të rërës, ndërsa në nivelet më të ulëta mund të gjejmë gurë të rrumbullakët dhe të mëdhenj, të cilët janë shembur nga muret e shpellës

Në shpellë deri më tani janë hulumtuar pesë nivele. Niveli i parë është niveli i lumit, i cili është mjaft aktiv. Ky nivel arrin lartësinë prej 66 m, prej hyrjes. Ka një shkallëzim dinamik dhe vende-vende shumë i rrezikshëm. Nga ky nivel mund të zbritet në shtratin e lumit përmes disa kanaleve të ngushta në formë të gypave të pjerrtë. Këtu hasim në sedimente apo fundërrina shumë-ngjyrëshe.

Kjo shpellë për shkak të konfiguracionit të terrenit dhe rrezikut që paraqet për tu hyrë në brendësi, gjendja është e mirë. Shpella është në fazën e hulumtimeve. Hulumtimet në këtë shpellë kanë filluar në mënyrë të organizuar në bashkëpunim të shoqata spelologjike "Aragoniti" nga Peja, disa speleologë nga Sllovakia, Bullgaria dhe AKMM.

Figura 69. Pamje e hyrjes në Shpellën "Gryka e Madhe"

Figura 70. Kristalet në shpellën Gryka e Madhe

Figura 71. Galeria në shpellën Gryka e Madhe

Tabela 5. Lista e zonave të propozuara për mbrojtje 2002-2007

Nr.	Emërtimi i zonës	Komuna
1	**Gurbadhë** - Trungu i Qarrit	**Malishevë**
2	**Burim** - Trungu Frashrit	**Malishevë**
3	**Turjak** - Trungu i Qarrit 2	**Malishevë**
4	**Panorc** - Shpella e Flladit	**Malishevë**
5	**Drenovc** -Trungjet në Varrezat e fshatit	**Malishevë**
6	**Drenovc** - Shpella e Bozhurit	**Malishevë**
7	**Bubavec** - Mali i Vakafit	**Malishevë**
8	**Vermicë** - Lagj.e Limanajev	**Malishevë**
9	**Balinc** - Mali i Vakafit	**Malishevë**
10	**Marali** - Guri i Maralis	**Malishevë**
11	**Marali** -Trungi i Qarrit	**Malishevë**
12	**Pagarush** -Trungi i Qarrit	**Malishevë**
13	**Gurisht** - Burimi i Ujitë	**Malishevë**
14	**Pidiq** - Burimi Termomineral	**Gjilan**
15	**Nasalë** - Burim Mineral	**Gjilan**
16	**Gumnishtë** - Burim Mineral	**Gjilan**
17	**Llashticë** -Trungu i Qarrit	**Gjilan**
18	**Lipovicë -** Dy Trungje të Dardhesë	**Gjilan**
19	**Buricë** - Dy Tungje të Bungut	**Gjilan**
20	**Uglarë** - Burim i Ujit Termal	**Gjilan**
21	**Lovcë** -Trungu i Bungut	**Gjilan**
22	**Lugina e lumit Llapushnik**	**Gjilan**
23	**Kmetovc -** Burimi Termomineral	**Gjilan**
24	**Brisallc** - Shpellë	**Gjilan**
25	**Perpleni**c - Liqeni i Perplnicës	**Gjilan**
26	**Parku Regjional "** Pashtriku "	**Gjakovë**
27	**Park Pyjor "** Maja e Gllavës"	**Gjakovë**
28	**Kompleksi i Pishës së Zezë në** Shkukëz	**Gjakovë**
29	**Herreq -** Lisi i Qarrit	**Gjakovë**
30	**Stubullë -** Trungu i Blirit	**Gjakovë**
31	**Berijah** - Trungjet e Blirit	**Gjakovë**
32	**Dobrosh -** Lisi i Bungut	**Gjakovë**
33	**Rracaj -** Trungu i Blirit dhe Qarrit	**Gjakovë**
34	**Vogovë -** Lisi i Qarrit	**Gjakovë**
35	**Mulliq -** Burimi i Ujitë	**Gjakovë**
36	**Burimi i lumit Deshica "** Gurra e Demjanit"	**Gjakovë**
37	**Kusar -** Burimi i Ujit	**Gjakovë**
38	**Potok -** Burimi i Ujit 1	**Gjakovë**
39	**Shpella e Qiriut**	**Gjakovë**
40	**Shpella e Kusarit**	**Gjakovë**
41	**Përbërja e Bashkësisë së Brukës**	**Gjakovë**

42	**Lokaliteti i Bujgerit dhe i Dioskoresë**	**Gjakovë**
43	**Lokaliteti i lule Bozhures në Pashtrik**	**Gjakovë**
44	**Trungu i Tisit**	**Gjakovë**
45	**Bashkësia Boshtrës dhe Gështenjës**	**Gjakovë**
46	**Shqiponjë -** Zabeli i Gojanit	**Gjakovë**
47	**Greqinë -** Trungu i Qarrit	**Gjakovë**
48	**Molliq -** Trungjet e Dushkut	**Gjakovë**
49	**Madanaj -**Trungu i Qarrit	**Gjakovë**
50	**Bec -**Trungu i Bungut	**Gjakovë**
51	**Zhabel -** Trungjet e Dushkut	**Gjakovë**
52	**Gergoc -** Trungjet e Dushkut	**Gjakovë**
53	**Potok (2) –** Birimi i Ujit 2	**Gjakovë**
54	**Ujmirë** - Trungu i Bungut	**Klinë**
55	**Deiq** - Trung i Bungut	**Klinë**
56	**Nagllavk** - Trung i Qarrit	**Klinë**
57	**Gllarevë** - Trungu i Bungut	**Klinë**
58	**Dresnik** - Banja e Dresnikut	**Klinë**
59	**Sibovc** - Trungjet e Bungut	**Kastriot**
60	**Sibovc** - Trungu i Blirit	**Kastriot**
61	**Mazgit -** Trungu i Manit	**Kastriot**
62	**Grabov**c - Burimi i Ujit Mineral	**Kastriot**
63	**Grabovc –** Kompleksi i Drurëve të Qarrit dhe Shkozës	**Kastriot**
64	**Breznicë -** Kompleksi i Burimeve	**Kastriot**
65	**Cerrcë** -Trungjet e Manit	**Istog**
66	**Lubozhdë** -Trungu i Blirit	**Istog**
67	**Vrellë** - Burimi i Ujit	**Istog**
68	**Istog i Poshtëm** -Trungu i Blirit	**Istog**
69	**Shushicë e Epërme** - Trungu i Blirit	**Istog**
70	**Istog** - Burimi i Ujit	**Istog**
71	**Zhakovë** -Trungu i Bungut	**Istog**
72	**Uçë** -Trungu i Bungut	**Istog**
73	**Cërkolez** - Kompleksi i Trungjeve të Dushkut	**Istog**
74	**Kaliqan** -Trungu i Blirit	**Istog**
75	**Baicë** -Trungu i Blirit	**Istog**
76	**Banjë** - Burimi i Ujit Termomineral	**Istog**
77	**Lubovë** -Trungu i Blirit	**Istog**
78	**Zallq** -Trungu i Bungut	**Istog**
79	**Zabllaq** - Trungu i Bungut	**Istog**
80	**Turbuhovc** -Trungu i Bungut	**Istog**
81	**Saradran** - Trungu i Bungut	**Istog**
82	**Gjelbishtë** - Uji Mineral	**Vushtrri**
83	**Bajë** - Trungu i Bungut	**Vushtrri**
84	**Bajë** - Burimi i Ujit Termal 1	**Vushtrri**

85	**Bajë** - Burimi i Ujit Termal (Q. e zotnisë) 2	**Vushtrri**
86	**Karaqë** - Burimi i Ujit Natyral	**Vushtrri**
87	**Skromë** - Burimi i Ujit Natyral	**Vushtrri**
88	**Koderflamur** - Kom.i Trungjeve të Ahut	**Vushtrri**
89	**Shtruerë** -Trungu i Bungut	**Vushtrri**
90	**Ashlan** -Trungu i Bungut	**Vushtrri**
91	**Cecel** - Trungu i Bungut	**Vushtrri**
92	**Lumkuq** - Parku i Ketrit	**Vushtrri**
93	**Krasniqe e mesme** - Trungu i Qarrit	**Vushtrri**
94	**Galic** - Kompleksi i Trungjeve të Bungut	**Vushtrri**
95	**Brusnik** - Trungu i Bungut	**Vushtrri**
96	**Rreznik** - Trungjet e Bungut	**Vushtrri**
97	**Druar** - Trungjet e Bungut	**Vushtrri**
98	**Trimor** - Trungjet e Bungut	**Vushtrri**
99	Lugina dhe qafa e Kaqanollit	**Podujevë**
100	**Popovë** - "Ushton Reka"-	**Podujevë**
101	**Orllan** - Liqenit i Batllavës	**Podujevë**
102	**Dobratin** - Burimi i Ujit dhe Trungjet e Dushkut-	**Podujevë**
103	**Murgullë** - Trungu i Plepit	**Podujevë**
104	**Llapashtic e Epërme** - Trungjet e Dushkut (varreza)	**Podujevë**
105	**Dyzë** - Trungu i Dushkut	**Podujevë**
106	**Orllan** - Trungu I Plepit	**Podujevë**
107	**Gërdoc** -Trungu i Plepit	**Podujevë**
108	**Braboniq** - Burimi i Ujit mineral	**Mitrovicë**
109	**Mazhiq - B**urimi i Ujit Mineral	**Mitrovicë**
110	**Braboniq** - Trungu i Qarrit	**Mitrovicë**
111	**Zasellë** - Trungu i Gështenjës	**Mitrovicë**
112	**Zabergjë** - Trungu i Bungut	**Mitrovicë**
113	**Vllahi** - Trung i Bungut	**Mitrovicë**
114	**Bare** - Trungjet e Ahut	**Mitrovicë**
115	**Rahovë** - Kroni i Akullit	**Mitrovicë**
116	**Vidimiriq** - Trungu i Vojsës	**Mitrovicë**
117	**Rahov**ë -Trungjet e Gishtënjës	**Mitrovicë**
118	**Lugu i Bares** - Burimi i Ujit	**Mitrovicë**
119	**Melinicë** - Ujëvara e Trepqalive	**Mitrovicë**
120	**Vinarc i Epërm** - Trungu i Krekzes	**Mitrovicë**
121	**Ovqar** - Trungu i Ahut dhe Burimi i Ujit	**Mitrovicë**
122	**Bistric e Shalës** - Trungu i Plepit	**Albanik**
123	**Boletin** - Trungu i Gështenjës	**Zveçan**
124	**Kelmend** - Guri i Gjatë dhe Guri i Mprehtë	**Zveçan**
125	**Viti** - Lisi i Dushkut	**Viti**
126	**Kllokot** - Burimi i Ujit Mineral	**Viti**
127	**Zhiti** - Lisi i Dushkut	**Viti**

128	**Ballanc** - Kompleksi i Trungjeve	**Viti**
129	**Zhiti** - Burimi i Ujit Mineral	**Viti**
130	**Binq** - Kompleksi i Lisave të Dushkut	**Viti**
131	**Samakov** - Burimi i Ujit	**Viti**
132	**Samakov** – Monument Hidrologjik	**Viti**
133	**Debeldeh** - Peizazh Natyror	**Viti**
134	**Gërmovë** - Lisi i Qarrit	**Viti**
135	**Sllatin e Epërme** - Peizazh	**Viti**
136	**Sllatin e poshtme** - kompleksi i trungjeve	**Viti**
137	**Vërnekolle** - Reka e Vernezit	**Viti**
138	**Ballanc -** Burimi i Ujit Mineral	**Viti**
139	**Gjylekar** - Guri i Blinave	**Viti**
140	**Breshanc** - Trungjet e Dushkut	**Therandë**
141	**Savrovë** - Kompleksi i Trungjeve të Dushkut	**Therandë**
142	**Delloc** - Trungu i Pishës (Pinus sp.)	**Therandë**
143	**Grikoc** - Trungjet e Dushkut (Quercus sp.)	**Therandë**
144	**Reçan** - Trungu i Plepit (Populus sp.)	**Therandë**
145	**Muhlan** - Kompleksi i Trungjeve të Dushkut	**Therandë**
146	**Biraqë** - Lokaliteti i Bujgerit	**Therandë**
147	**Reçan** - Burimi i Ujit	**Therandë**
148	**Papaz** - Kompleksi i Trungjeve	**Therandë**
149	**Budakovë** - Trungu i Vodhës	**Therandë**
150	**Luzhnicë** - Kompleksi i Trungjeve	**Therandë**
151	**Bllacë** - Trungjet e Bungut	**Therandë**
152	**Bllacë** - Dy Trungjet e Bungut	**Therandë**
153	**Vraniq** -Trungu i Qarrit (Quercus sp.)	**Therandë**
154	**Nagavc** - Trung i Qarrit	**Rahovec**
155	**Drenovc** - Trungjet e Dushkut	**Rahovec**
156	**Vranjak -** Trungjet e Vidhit	**Rahovec**
157	**Koznik** - Trungu i Dushkut	**Rahovec**
158	**Dabidol** - Trungjet e Dushkut	**Rahovec**
159	**Potoqan i ulët** -Trungjet e Dushkut	**Rahovec**
160	**Brestuvc -** Trungu i Dushkut (Lisi i Bajraktarit)	**Rahovec**
161	**Petrovë** - Vrella e Zezë	**Shtime**
162	**Devetak** - Shpella e Devetakut	**Shtime**
163	**Mollopolc -** Trungjet e Dushkut(varrezat e vjetra)	**Shtime**
164	**Godanc i Epërm** - Trungu i Dushkut(varreza)	**Shtime**
165	**Godanc i Poshtëm** - Trungu i Dushkut (Taravillaz)	**Shtime**
166	**Rashinc** - Trungu i Dushkut	**Shtime**
167	**Karaqic** - Kompleksi i Trungjeve	**Shtime**
168	**Karaqic** - Guri i Xhamisë	**Shtime**
169	**Pjetreshticë** - Shpellë	**Shtime**
170	**Shtime** - Kompleksi i Pishave	**Shtime**

171	**Sllovi** - Trungu i Qarrit	**Lipjan**
172	**Sllovi** - Kompleksi i Trungjeve	**Lipjan**
173	**Smallush** - Tre Trungjet e Dushkut te Shkolla	**Lipjan**
174	**Smallush** - Trungjet e Dushkut	**Lipjan**
175	**Bregu I Zi** - Pylli i Dushkut në Varreza e Vjetra	**Lipjan**
176	**Poturovc** - Trungu i Dushkut	**Lipjan**
177	**Dobëraj e Madhe** - Trungu i Dushkut	**Lipjan**
178	**Baicë** - Burimet e Ujit (mbi hurdhën e peshqve)	**Lipjan**
179	**Baicë** - Trungu i Dushkut- të shkolla	**Lipjan**
180	**Baicë** - Trungu Dushkut në Varreza	**Lipjan**
181	**Baicë** - Burimi Termal	**Lipjan**
182	**Krojmi**r - Guri te Kroi	**Lipjan**
183	**Shalë-** Guri i Shpuar	**Lipjan**
184	**Shalë** - Trungu i Dushkut (të bunari i Azizit)	**Lipjan**
185	**Vrellë** - Burimi i Ujit	**Lipjan**
186	**Vershec** - Trungjet e Dushkut	**Lipjan**
187	**Kompleksi i Blinajës**	**Lipjan**
188	**Qylagë** - Trungu u Dushkut (të shkolla)	**Lipjan**
189	**Torinë** - Pylli i Dushkut	**Lipjan**
190	**Bregu i Zi** -Trungu i Dushkut (afër rrugës)	**Lipjan**
191	**Bujanë** - Pylli i Dushkut në Varreza	**Lipjan**
192	**Gadime** -Shpella e Mermertë (te xhamia)	**Lipjan**
193	**Gadime -** Pylli në Kodrën mbi Xhami	**Lipjan**
194	**Gadime e Epërme** - Trungjet e Dushkut në Varreza	**Lipjan**
195	**Golesh - V**endbanim i llojit endemik i Fotsythia europea (boshtra)	**Fushë Kosovë**

Figura 72. Kompleksi i Liqenit të Batllavës i propozuar për mbrojtje

Figura 73. Kompleksi i trungjeve të propozuara për mbrojtje në Sllatinë të Vitisë

Figura 74. Shpella e Ponorcit, monument i propozuar për mbrojtje

Figura 75. Burimi termomineral në Banjë të Istogut, i propozuar për mbrojtje

Figura 76. Lugina e Llapushnikut, Gjilan

Figura 77. Lugina e lumit Selac, Shalë e Bajgorës, e propozuar për mbrojtje

Figura 78. Kroi i akullit , Shalë e Bajgores, i propozuar për mbrojtje

4. Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura

Menaxhimi i zonave të mbrojtura të natyrës bëhet për qëllim të:

- kërkimeve shkencore;
- mbrojtjes së llojeve të egra, habitateve dhe ekosistemeve;
- ruajtjes së diversitetit gjenetik dhe të llojeve;
- përkujdesjes së shërbimeve mjedisore;
- mbrojtjes së veçorive specifike të trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- turizmit dhe rekreacionit;
- arsimimit dhe sigurimit të qasjes së publikut në informata;
- përdorimit të qëndrueshëm të resurseve nga ekosistemet natyrore;
- ruajtjes së veçorive kulturore dhe tradicionale.

Statusi i zonave të mbrojtura të natyrës definohet me aktet nënligjore në pajtim me Ligjet të cilat do të përcaktojnë shkallën e mbrojtjes dhe parimet e menaxhimit sipas secilës kategori. Për çdo zonë të mbrojtura të natyrës përcaktohet shkalla e I,II dhe III e mbrojtjes [19]

Akti për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës do të përcaktoj qëllimet e menaxhimit dhe masat e veçanta për mbrojtjen e natyrës dhe teknikat të cilat do të aplikohen në zonën e mbrojtur të natyrës. Pas nxjerrjes së aktit për shpalljen e zonës së mbrojtur të natyrës nxirret plani i menaxhimit nga organi që e vënë nën mbrojtje[20] dhe i cili aprovohet nga Ministria.

Menaxhimi me Parkun Nacional "Mali Sharr" bëhet nga Drejtoria e Parkut e cila e ka selinë në Prizren. Parku Regjional ''Gërmia'' menaxhohet nga ndërmarrja publike "Hortikultura". "Shpella e Gadimës" menaxhohet nga një organ që nuk është në mbikëqyrje të Qeverisë. Ndërsa, rezervatet "*Maja e Ropsit", "Gubavci", "Gazimestani"," Kozhnjeri","Malet e Prilepit"," Bifurkacioni i lumit Nerodime","Kamilja", si dhe Parku Regjional "Mirusha" nuk kanë organe menaxhuese. Monumentet e tjera të natyrës menaxhohen nga autoritetet komunale përkatëse..*

Ende nuk është kryer procesi i harmonizimit dhe kategorizimit të zonave nga klasifikimi i mëhershëm me ligjin e ri të natyrës, kështu që shpesh hasim në emërtime të ndryshme për një zonë. Është duke u punuar regjistri qendror i zonave të mbrojtura dhe me këtë rast do të largohen nga kjo listë zonat(monumentet) që i kanë humbë vlerat për të cilat janë marrë nën mbrojtje.

Vlerat themelore të zonave të mbrojtura shpesh janë kërcënuar nga faktorë të natyrave të ndryshme. Zhvillimi veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, prerja e pyjeve, gurthyesit, etj, shpeshherë janë bërë pa një kriter të qëndrueshëm për ruajtjen e natyrës. Ky shfrytëzim i natyrës dhe i vlerave të saja ka atakuar ekosistemet dhe

19 Neni 30 LMN
20 Neni 36

diversitetin biologjik në masë të konsiderueshme. Nga kjo nuk janë kursyer edhe zonat e mbrojtura me vlera të veçanta të trashëgimisë natyrore si : Parku Nacional "Malet e Sharrit", Parku Regjional "Mirusha", "Shpella e Gadimës", Parku "Gërmia" etj. Disa nga ndërhyrjet e bëra në këto zona janë të paraqitura në tabelën në vijim.

Tabela 6. Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura

Zona e mbrojtur	Ndërhyrja
Gërmia / Park Regjional i Natyrës / GZK. Nr.43/87	Ndërtimi i qendrës administrative protokollare te Kuvendit te Kosovës
Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë/ Monument i Natyrës/ Nr. 352-13 / 9.04.1986 Rahovec	Ndërtimi i objektit hotelier
Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë/ Monument i Natyrës/ Nr. 011-10 / 5 mars 1986 Gjakovë	Ndërtimi i qendrës rekreative-sportive
Mirusha/ Park Regjional i Natyrës/ 1982, 1983	Ndërtimi i pompës se karburanteve në Volljakë
Mirusha/ Park Regjional i Natyrës/ 1982, 1983	Ndërtimi i një restoranti në Volljakë
Prevalla/ Park Nacional/ GZK Nr.11/86	Ndërtimi i fshatit turistik në Prevallë
Gryka e Rugovës/ Monument i Natyrës/ GZK Nr. 25, 1988. Park nacional i propozuar/	Fabrika e ujit
Kozhnjeri/ Rezervat i Natyrës/ 1955	Hurdha e peshqve

Figura 79. Harta e ndërhyrjeve në zonat e mbrojtura

5. IDENTIFIKIMI I ZONAVE POTENCIALE PËR NATYRA 2000 NË KOSOVË

"Natyra 2000" është një sistem integral i zonave të mbrojtura në kuadër të Bashkimit Evropian. Ajo përfshinë zonat e mbrojtura sipas Direktivës së Habitateve (Direktivës 92/ 43/EEC), si dhe zonat e mbrojtura sipas Direktivës së Shpendëve (**Direktivës 79/409/EEC**). Zonat e "Natyra 2000" janë me rëndësi të përbashkët për Bashkimin Evropian (EU) dhe propozohen nga vendet anëtare të saj. Direktiva e Habitateve dhe ajo e Zogjve për Bashkimin Evropian (EU) dhe vendet anëtare të saj paraqesin një instrument mjaft të rëndësishëm ligjor për ruajtjen e llojeve dhe vendbanimeve të tyre si dhe shërbejnë për realizimin e detyrave të Konventës së Biodiversitetit (CBD Rio 1992) për ruajtën e diversitetit biologjik të llojeve dhe biotopeve të tyre.

Kriteret bazë për identifikimin e zonave për rrjetin "Natyra 2000" dalin nga Neni 3. Paragrafi 1 i Direktivës 92/43 mbi Ruajtjen e Habitateve:

Kjo Direktivë ka themeluar **konceptin e rrjetit "NATYRA 2000", i cili duhet të përbëhet nga Zonat Speciale të Mbrojtura - SPA (**që rrjedhin nga Direktiva e Habitateve) dhe **Zonat Speciale të Konservuara-SAC** (që rrjedhe nga Direktiva e Zogjve).

Po ashtu në rrjetin "Natyra 2000", duhet të përfshihen edhe: Zonat Aktuale të Mbrojtura që i plotësojnë kriteret, Lokacionet KORINE, Zonat e Rëndësishme të Zogjve (IBA).

Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian (BE) dhe nuk është e obliguar të bëjë paraqitjen e zonave për rrjetin ekologjik "Natyra 2000". Mirëpo p**ërgatitja për hyrje në BE kërkon kohë dhe krahas përmbushjes së standardeve të tjera, mbrojtja e mjedisit dhe natyrës zënë një vend të rëndësishëm. Prandaj, duke e ditur se përmbushja e këtyre kritereve kërkon një kohë të gjatë, fillimi i identifikimit të këtyre zonave duhet të jetë me prioritet.**

Projekti për identifikimin e zonave potenciale që i plotësojnë kriteret për të hyrë në rrjetin ekologjik "Natyra 2000" ka filluar në kuadër të "Projekti i Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve" (PMQP/SFMP) i cili projekt implementohet nga "Project Management Group në konsorcium me Green Belt dhe Project Management International Services Grup SRL"dhe në financim të Bashkimit Evropian. Për këtë arsye janë formuar grupe punuese nga një spektër i gjerë i ekspertëve nga Universiteti i Prishtinës, Institucionet Qeveritare dhe Joqeveritare**.**

Projekti është në fazën e identifikimit të: Nevojave legjislative dhe institucionale për "Natyra 2000"; Te zonave të rëndësishme të florës dhe faunës; Rrjetit kombëtar të zonave të mbrojtura; Rezervatet e mundshme të biosferës (MAB); Zonat e trashëgimisë botërore UNSECO; Iniciativat Green Belt; Zona të rëndësishme të fluturave; Rrjeti Emerald; Zonat e ligatinave (Ramsar); Zonat e shpendëve të rëndësishme (IBA); Lista e kuqe e IUCN; Llojet endemike dhe llojet relikte etj.

Po ashtu në kuadër të këtij projekti janë realizuar edhe vizita studimore në Bullgari, me qëllim të njohjes së këtij procesi dhe përfitimin nga përvojat e tyre.



Figura 80. Zonat potenciale për Natura 2000

6. Iniciativa "Bjeshkët e Nemuna" Park Ndërkufitar, Kosovë-Shqipëri-Mali i Zi

Parqet Ndërkufitare të paqes janë hapësira natyrale të mbrojtura njëtrajtësisht, të shtrira përgjatë kufirit të dy a më shumë vendeve, ku secila nga palët përfiton pa cenuar kufijtë, interesat apo hapësirën territoriale të njëri- tjetrit. Sipas definicionit të Unionit Ndërkombëtar për Mbrojtjen e Natyrës (IUCN- International Union for the Conservation of Nature), Parqet Ndërkufitare definohet si; *"zona të mbrojtura ndërkufitare të cilat formalisht janë të dedikuara për mbrojtjen dhe kujdesin për shumëllojshmërinë biologjike, vlerat e trashëgimisë natyrore e kulturore si dhe promovimin e paqes dhe bashkëpunimit".*

Kufijtë politik në mes vendeve shpesh janë të padrejtë jo vetëm ndaj popujve, por edhe ekosistemeve, florës dhe faunës. Duke marrë për bazë këtë, në shumë vende të botës ka lindur nevoja e krijimit të zonave të mbrojtura ndërkufitare. Sot në botë ekzistojnë mbi 600 "zona të mbrojtura" që ndahen me kufij ndërshtetëror. Parku i parë ndërkombëtar me karakter ndërkufitarë është Morokulia në Skandinavi që ndodhet në zonën kufitare ndërmjet Suedisë dhe Norvegjisë. Parqet tjera ndërkombëtare me karakter ndërkufitarë të njohura në botë janë: Waterton Glacier (SHBA/Kanadë), Parque La Amistad (Kosta Rikë/Panama), Cordillera del Kondor (Peru/Ekuador), Limpopo (Afrika e jugut/Mozambik) etj.

Nisma për krijimin e Parkut Ndërkufitar në trekëndëshin e kufirit Shqipëri-Mali i Zi – Kosovë, ka rrjedhë nga shoqëria civile dhe organizatat joqeveritare. **OJF "Aquila"Pejë –Kosovë, OJF "Intelektualët e Rinj Shpresë", Shkodër-Shqipëri, OJF "Hali" Rozhajë - Mali i Zi** kanë bërë hapat e parë në këtë drejtim, ku më pas kanë gjetur mbështetjen e një numri aktivistësh nga Universitetet Colgate në SHBA dhe Bradford të Mbretërisë së Bashkuar.

Në kuadër të aktiviteteve dhe angazhimeve për themelimin e këtij parku duhet veçuar fuqizimin e shoqatave mjedisore të zonës tre-kufitare, i njohur si **"Koalicioni i Parkut Ndërkufitar në Ballkan"**, i themeluar si rezultat i takimit rajonal të mbajtur në Rugovë, në gusht 2006, mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Kosovës dhe Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur. Koalicionin e përbëjnë gjashtë shoqata nga Kosova, Mali i Zi dhe Shqipëria, me karakter të hapur për bashkëpunim të gjerë me të gjithë sektorët e shoqërisë në zonën ndërkufitare, duke synuar transformimin në një lëvizje të mirëfilltë gjithëpërfshirëse mjedisore- sociale.

Për jetësimin e këtij projekti deri me tani janë zhvilluar një sërë aktivitetesh me karakter rajonal dhe ndërkombëtar, si takime prezantuese dhe punuese, disa konferenca, disa udhëtime përshkuese në zonën malore tre-kufitare, një numër takimesh konsultuese, një numër vizitash individuale, bilaterale dhe multilaterale me karakter njohës, rekreativ dhe studiues, shkëmbime të përfaqësuesve rajonal dhe ndërkombëtar, pritje të disa grupeve studentësh të huaj, vizitorë dhe praktikantë me shoqatat e rajonit; një seri takimesh me autoritetet lokale të përfshira në zonën e Parkut Ndërkufitar, si dhe një numër prezantimesh, konferencash për shtyp, artikujsh, studimesh dhe botimesh, dokumentarësh dhe ekspozitash me motive nga zona tre-kufitare të realizuara në Ballkan, në Amerikë, Kanada, Angli etj.

Në këtë drejtim, janë zhvilluar edhe takime të niveleve të ndryshme në të tri vendet

dhe është arritur përkrahje dhe pajtueshmëri nga secila prej tri qeverive lokale, të Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë, por dhe mbështetje praktike nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, dhe një numër donatorësh si KFOS, GTZ, që tregon nivelin e lartë, të interesimit dhe mbështetjes, institucionale, financiare e teknike për projektin. Duhet përmendur edhe ndihmën dhe interesimin për mbështetjen e projektit edhe nga organizatat ndërkombëtare që kanë në fokus mjedisin, kulturën, bashkëpunimin, paqen, si REC, UNEP, IUCN, Agjencinë Austriake për Zhvillim etj.

Për të shpalosur vizionin e këtij projekti, në nëntor të vitit 2006, është organizuar konferenca **"Parku Ndërkufitar në Ballkan: Bashkëpunimi strategjik ndërmjet shoqërisë civile, autoriteteve lokale dhe institucioneve ndërkombëtare**". Konferenca kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe dokumentimin sa më të gjerë për kronologjinë, të tashmen dhe vizionin për lëvizjen gjithëpërfshirëse sociale të projektit, si dhe për të tërhequr vëmendjen e komunitetit të qeverisjes lokale dhe qendrore të secilit prej tri vendeve të përfshira në hapësirën e Parkut Ndërkufitar, si dhe të komunitetit të donatorëve dhe aktorëve të tjerë të interesuar në rajon e më gjerë për të mbështetur dhe lehtësuar shpalljen e Zonës së Mbrojtur Ndërkufitare në Ballkan.

Aktivitetet drejt jetësimit të projektit kanë vazhduar në mars të vitit 2008, me një seminar (punëtori) të mbajtur në Shkodër , me të gjithë aktorët e involvuar në projekt. Takimi kishte për qëllim **"Propozimin e një programi të zhvillimit të integruar për rajonin e propozuar për mbrojtje".**

Hapësira në të cilën parashihet të shtrihet Parku Ndërkufitar karakterizohet me biodiverzitet të lartë, por edhe me gjeodiverzitet, objekte të trashëgimisë kulturore etj. që janë shumë intriguese për vizitorë nga dashamirës të natyrës dhe ecjes në natyrë.

Këto hapësira janë të kërcënuara nga depopullimi, andaj shpallja e tyre zonë e mbrojtur ndërkufitare do të ishte e mirëseardhur për popullatën lokale që përmes eko-turizmit dhe përfitimeve tjera të mbetet në këto hapësira që është edhe njëra nga qëllimet e krijimit të këtij Parku Ndërkufitar.

Përveç kësaj Parku do të inkurajoj investitorët e huaj dhe njëkohësisht do të siguroj mbrojtje më të mirë të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.

Objektiva strategjike të këtij projekti janë:

- Të ruajë shumëllojshmërinë e pasurisë natyrore, kulturore e shpirtërore në zonën tre-kufitare ndërmjet Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë;
- Të promovojë paqen dhe harmoninë në mes njerëzve dhe natyrës, dhe të mundësojë lëvizjen e lirë përtej kufijve natyrorë e politikë në këtë zonë tre-kufitare;
- Të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm lokal bazuar në eko-turizmin e organizuar familjar, bujqësinë e blegtorinë biologjikisht të pastër, artizanatet e punuara me dorë e mjete të thjeshta, përdorim të drejtë dhe menaxhim të mirë të burimeve natyrore, zhvillim të potencialit njerëzor dhe krijimin e vizioneve të komuniteteve lokale ndërkufitare, shkëmbime kulturore, dhe bashkëpunime në lëmin sociale- ekonomike, politike dhe të sigurisë në bjeshkët dhe luginat e zonës ndërkufitare.

7. Turizmi

Turizmi paraqet njërën ndër fushat kryesore të zhvillimit të një vendi. Zhvillimi i tij ka ndikim në natyrë, sidomos nëse nuk merren parasysh parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Vlerat e paprekura të natyrës së Kosovës si dhe diversiteti i monumenteve kulturore-historike krijojnë mundësi të mira të zhvillimit të turizmit. Resurse turistike kanë pothuaj të gjitha trevat e Kosovës." Malet e Sharri" dhe "Bjeshkët e Nemuna" janë zonat më të rëndësishme turistike.

Sipas të dhënave Industria Turistike e Kosovës realizon 8-10 % të produktit shoqëror vendor [21].

Pas vitit 2000 sektori i turizmit në Kosovë karakterizohet me një zhvillim intensiv dhe në një masë të madhe spontan dhe të pa kontrolluar, i cili shoqërohet me pasoja të humbjes së ekuilibrit për mjedisin. Shikuar nga aspekti turistik, Kosova është vend në zhvillim.

Sektori i turizmit në Kosovë aktualisht ballafaqohet me problemin e ofertës turistike i cili ka ngecur prapa nga zhvillmi ndërkombëtar në këtë lëmi. Këtij sektori i duhet ende të definojë pozitën e tij, t'i rrisë të hyrat dhe të ruajë potencialin dhe resurset natyrore. Kërkesat turistike në Kosovë janë të lidhura me mysafirë të huaj dhe vendorë. Nuk kemi të dhëna të sakta për strukturën dhe vendet prej nga vijnë turistët në Kosovë.

Turizmi në Kosovë rregullohet sipas Ligjit për Turizëm i cili është miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Është në procedim hartimi i Strategjisë për Zhvillimin e Turizmit.

Turizmi në Zonat e Mbrojtura

Sipas të dhënave, turistët nga Kosova më shumë preferojnë turizmin malorë që përfaqësohet nga rajoni turistik i "Bjeshkëve të Nemuna" dhe rajoni turistik i Sharrit, ndërsa produkte tjera turistike që ofron Kosova dhe që janë më pak të preferuara janë: turizmi dimëror-rekreativ, turizmi kulturor, turizmi afarist, turizmi transit, turizmi shëndetësor dhe speleoturizmi. [22]

Përveç "Maleve të Sharrit" dhe "Bjeshkëve të Nemuna", në Kosovë vizitohen edhe zonat tjera të mbrojtura të natyrës si: "Kanioni" dhe "Ujëvarat e Mirushës";"Kanioni i Rugovës"; "Burimi i Drinit të Bardhë"; "Bifurkacioni i lumit Nerodime"; "Shpella e Mermerit" etj. Zonat e mbrojtura në Kosovë nuk kanë zyra të informimit përmes të cilave do të merreshin informata për numrin dhe strukturën e turistëve që vizitojnë këto zona.

Turizmi në Malet e Sharrit

Masivi i Sharrit ofron kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit. Llojet e turizmit të cilat zhvillohen në masivin e Sharrit janë: turizmi malor, dimëror, turizmi veror,

21 IPH 2004 –Raporti sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit

22 IPH 2004 - Raporti sektorial i zhvillimit hapësinor për sektorin e turizmit

rural, gjuetia, peshkimi, aktivitetet në natyrë, turizmi shëndetësor, turizmi alpinist, ekskursionet turistike.

Regjioni turistik i Sharrit përfshinë tërësinë më atraktive turistike të Kosovës, denivelacioni i shtigjeve për skijim, numri i tyre, gjatësia dhe forma e rënieve të terrenit përfaqësojnë elemente hapësinore të vlerave të larta turistike.

Nga gjithë këto lokalitete të Masivit të Sharrit, vetëm në Brezovicë është krijuar baza materiale turistike, përkundër faktit se ekspertët e OSCE-së, lokalitetin e Prevallës e kanë rangu më lartë si qendër të turizmit dimëror-sportiv. Brezovica disponon me 1112 shtretër, prej të cilëve 690 në hotele të kategorisë 'A' dhe 'B', me teleferik, ski, ashensor dhe përmbajtje të tjera përcjellëse. [23]

Dikur këtë qendër e kanë vizituar me mijëra turistë vendas dhe të huaj, ndërsa tani më shumë preferohet për turizëm njëditor apo edhe për fundjavë.

Figura 81. Shtigjet e skijimit në Brezovicë

Si lokalitet tjetër që ka vlera të larta për zhvillimin e turizmit është Prevalla, një pjesë e së cilës i takon komunës së Prizrenit e që hyn në kufirin e Parkut Nacional të „Malit Sharr". Llojet e turizmit të cilat zhvillohen në masivin e Prevallës janë: turizmi malor, dimëror, veror, aktivitetet në natyrë, turizmi shëndetësor, ekskursionet turistike.

Prevalla është një lokalitet shumë i frekuentuar nga turistët vendorë, grupet e organizuara (ekskursionet), të cilët e vizitojnë këtë qendër pothuajse gjatë gjithë vitit. Në Prevallë nuk ekziston infrastruktura adekuate turistike, dhe se çdo gjë është e improvizuar dhe e krijuar për t'u shfrytëzuar përkohësisht, (ndërtimi i vikend shtëpive, restoranteve, moteleve, tendat). Ofrimi i shërbimeve për vizitorët bazohet në disa shërbime hoteliere të nivelit të ulët, të paplanifikuar dhe jo sipas kritereve të turizmit të qëndrueshëm.

23 MTI (2001)Informatë e shkurtër mbi resurset turistike të Kosovës, gjendja aktuale të ekonomis turistike të Kosovës, Prishtinë,

Figura 82. Prevalla gjatë dimrit

Për këto dukuri jo të mira të zhvillimit stihik, ndihet nevojë urgjente për kontroll të zhvillimeve deri në hartimin e Planit Hapësinor të Parkut Nacional të Malit të Sharrit.

Figura 83. Harta turistike Kosovës

Rajoni Turistik i Bjeshkëve të Nemuna

Rajoni turistik i "Bjeshkëve të Nemuna" përfshinë rreth 2340 km^2, me 515000 banorë ku hyjnë Komunat: Peja, Gjakova, Deçani, Burimi, Klina, Rahoveci dhe pilot komuna e Junikut. Ka mundësi të mira për lidhje me qendrat e Kosovës, po ashtu ka kushte të volitshme për zhvillimin e turizmit ndërkufitar me Shqipërinë dhe me Malin e Zi.

Klima është tipike, me reshje të mëdha bore, me shpati të përshtatshme për zhvillimin e sporteve dimërore. Përplot me maje të larta (Gjeravica 2.656m), burime e rrjedha lumenjsh me gryka e kantone, pyje të larta dhe me një faunë të shumëllojshme që krijojnë një peizazh mjaft të bukur dhe atraktiv për zhvillimin e një turizmi të qëndrueshëm gjatë gjithë vitit.

Rajoni turistik i "Bjeshkëve të Nemuna "është hapësirë kapitale e trashëgimisë natyrore për zhvillimin e turizmit. Sipas specifikave dhe karakteristikave natyrore, sidomos sipas veçorive të relievit, të shumëllojshmërisë biogjeografike të resurseve jashtëzakonisht të pasura ujore, të pasurisë së peizazheve dhe të motiveve të mjedisit, Alpet Shqiptare janë masivet me unike malore në rajon.

Studimet e bëra nga OECD tregojnë se në këtë rajon turistik, mund të ndërtohen: 10 qendrat më rëndësi për zhvillimin e turizmit dimëror-sportiv.

Tabela 7. Qendrat më të rëndësishme, për zhvillimin e turizmit dimëror- sportiv në Bjeshkët e Nemuna 24

Qendrat kryesore të maleve	Nr. Skiatorëve	Kap. tërësishëm i qendrave
Maja e Rusolisë	19.250	40.000
Maja e Kurvalës	11.250	22.000
Bjeshkët e Belegut	7.550	15.000
Koprivniku	6.620	11.000
Rrasa Zogut	5.150	10.000
Starzc	4.150	8.000
Maja e Strellcit	3.855	7.000
Hala	3.780	7.000
Maja e Leqinatit	2.760	5.000
Maja e Moknës	2.030	4.000
Gjithsej	**65.393**	**129.000**

Ky rajon është mjaft i pasur me monumente të trashëgimisë kulturore dhe paraqet një thesar të pasur të trashëgimisë etnokulturore, materiale e shpirtërore të periudhave të ndryshme historike, të cilat pos tjerash, me karakteristikat dhe veçoritë e tyre dallohen për nga shumëllojshmëria e cilësive, vlerave dhe rëndësisë historike.

24 MTI, Departamenti i Turizmit, Rajoni turistik i Bjeshkëve të Nemuna, 2007

Rajoni turistik i “Bjeshkëve të Nemuna” është i pasur edhe me liqene që mund të jenë pjesë përbërëse e ofertës turistike. Më të njohurit janë: Liqeni i Radoniqit, Liqeni i Moknës, në Rugovë liqeni i Leqinatit, Liqeni i madh, Liqeni i vogël në Malet e Gjeravicës etj.

Shpellat janë ndër kuriozitetet më të mëdha natyrore turistike në këtë rajon. Janë të njohura Shpella e Radavcit, e Grykës së Rugovës, Shpellat në Zatriq etj. Burime termale në këtë rajon janë: Banja e Burimit (Istogut) Burimi i Ujit Termomineral në Studenicë të Burimi, Burim i Ujit Mineral në Deçan etj.

Pozita gjeografike, kushtet klimatike, hidrografia, flora dhe fauna mjaft e pasur janë elemente mjaft të rëndësishme, që këtij rajoni turistik i krijojnë mundësi për zhvillimin e turizmit, rekreativ, rural, eko-turizmit, turizmit të gjuetisë etj.

Si dukuri sidomos impresive gjeomorfologjike me atribute shumë të dukshme estetike dhe që ngjallin kuriozitet dallohen: “Gryka e Rugovës”, “Burimi i Drinit të Bardhë”, “Shpella e Radavcit”, “Shpella në Grykë të Rugovës”, “Shpella e Zatriqit”, “Banja e Burimit” (Istogut), “Kreshtat shkëmbore”etj.

II.
Biodiversiteti

BIODIVERSITETI

“Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike në të cilat ato bëjnë pjesë; kjo përfshinë diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve”[25].

Biodiversiteti është një nocion shumë kompleks që nënkupton tërësinë e llojeve dhe ekosistemeve, ose shprehur ndryshe biodiverziteti paraqet llojllojshmërinë jetësore në tokë.

Biodiversiteti po ashtu mbartë vlera rekreative, kulturore, shpirtërore dhe estetike.

Rritja e shpejtë e shkallës së konsumit nga ana e shoqërisë nga njëra anë, dhe rritja e popullsisë nga ana tjetër kanë çuar në një humbje mjaft të shpejtë të larmisë biologjike, humbjen e aftësisë së sistemit natyrorë të tokës për të ofruar burime thelbësore dhe shërbime nga të cilat varen shoqëritë njerëzore.

Aktivitetet humane e kanë rritur në 1.000 shkallën e humbjeve në këtë drejtim duke e krahasuar me një shkallë normale. Për fat të keq ky proces është në vazhdim, Toka po ndeshet me shkallë të lartë destruksioni në historinë disa miliardëshe . Duke u bazuar në disa përllogaritje të thjeshta, pothuajse dy në çdo tre lloje shpendësh në botë kërcënohen me uljen e popullatave të tyre, një në çdo tetë lloje bimësh është e rrezikuar ose kërcënuar për tu zhdukur, një e katërta e gjitarëve, një e katërta e amfibëve dhe një e pesta e reptilëve janë të rrezikuar.

Po kështu në një kohë krize janë pyjet, të cilët përbëjnë burime esenciale biologjike dhe janë pjesë integrale e ekosistemeve të gjalla tokësore. Sipas llogaritjeve të Institutit Botëror të Burimeve vetëm një e pesta e mbulesës bimore origjinale ka mundur të mbijetojë si e pafragmentarizuar, ndërkohë që edhe në ditët tona shpyllëzimet vazhdojnë me të madhe.

Ndonëse Kosova është një vend i vogël, shquhet për një biodiversitet të pasur. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor me një llojllojshmëri të mirë floristike, vegjetative dhe faunistike, ku vlen te theksohet prania e llojeve relikte, endemike si dhe të llojeve me rëndësi të veçantë.

Flora dhe Vegjetacioni

Bazuar në hulumtimet e deritanishme në Kosovë janë inventarizuar rreth 1800 lloje të florës vaskulare, mirëpo supozohet që ky numër është më i madh dhe arrin deri në rreth 2500 lloje.

Pra edhe më tutje nuk kemi një inventar të plotë të florës dhe vegjetacionit. Vegjetacioni i Kosovës është i përfaqësuar më 139 asociacione bimore të grupuara

25 Konventa e biodiversitetit 1992 Rio de Janeiro

në 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasë. Qendrat e biodiversitetit floristik në Kosovë konsiderohen “Malet e Sharrit” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Deri me tani në Parkun Kombëtarë “Mali i Sharrit” janë evidentuar më shumë se 2000 lloje të bimëve vaskulare, që paraqet rreth 25 % të florës së Ballkanit dhe rreth 18 % të florës së Evropës. Në bazë të të dhënave ekzistuese rreth 29 % e këtyre llojeve janë me karakter endemik. Prej numrit të përgjithshëm të llojeve të evidentuara në “Malet e Sharrit”, 86 lloje janë shpallur ndërkombëtarisht të rëndësishme, 26 lloje janë të përfshira në Listën e Kuqe të Evropës ndërsa sipas IUCN-së 32 lloje që gjinden në “Malet e Sharrit” janë në Listën e Kuqe të Bimëve të Kërcënuara . Vetëm në zonën subalpike dhe alpike të “Bjeshkët e Nemuna” janë evidentuar 797 lloje të bimëve vaskulare, ku 128 prej tyre konsiderohen me karakter endemik.



Figura 84. Spektri florisitik i llojeve bimore te Maleve te Sharrit me status ndërkombëtar të mbrojtur

Flora e Kosovës është e rëndësishme edhe për faktin se një numër i konsideruar i llojeve janë endemike, endemorelikte dhe subendemike.

Gjatë periudhës 2005-2007, ekipet e Institutit të Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, kanë vizituar shumicën e lokaliteteve të llojeve me karakter endemik dhe kanë bërë një vlerësim të gjendjes së tyre.

Tabela 8. Disa lloje bimore me karakter endemik

Nr.	FAMILJA / Lloji	Lulëzimi / Frytet	Biotopi	Përhapja në Kosovë	Përhapja e përgjithshme	Bimë endemike	Gjendja
	TOLOCHIACEAE						
1	**Aristolochia merxmuelleri Greuter et Mayer 1985.** *(Petriku i Grojterit)*	IV/ V-VI	Në terrene ranore – gurore pranë shkurreve, në substrate serpentinore të zonës kodrinore - malore	Rajoni i irushës	Kosovë	e Kosovës	Populacione të zhvilluara mirë por me areal të kufizuar
	ASTERACEAE						
2	**Achillea alexandri – Regis Bornm. et Rud. 1934.** *(Barpezmi i mbretit Aleksandër)*	VII/ VIII	Në vende barishtore dhe në pyllin e çetinakut (Achilleo – Pinetum mugi) të zonës alpike në shkëmbinj gëlqeror.	Malet e Sharrit Oshlak).	Kosovë	e Kosovës ndemike)	Populacione të zhvilluara mirë por me areal të kufizuar
3	**Centaurea albertii Rexhepi 1980.** *(Kokoçeli i Albertit)*	VI–VII / VIII-IX	Në vende shkëmbore dhe me bar të zonës kodrinore deri në 1000 metra lartësi mbidetare, vetëm në substrate serpentine.	Devë Golesh.	Kosovë	e Kosovës demike)	Populacione të rrezikuara
	ORAGINACEAE						
4	**Cynoglossum krasniqii 1986.** *(Gjuhëqeni i Krasniqit)*	IV-VI/ VI	Në vende shkëmbore – gëlqerore	Pashtrik rozhup).	Kosovë	e Kosovës	!
	BRASSICACEAE						
5	**Bornmuellera dieckii Deg. 1900.** *(Bornmulera e Degenit)*	VI–VII/ VIII	Në vende shkëmbore – serpentinore të zones malore dhe subalpike	Ostrovicë (1500 – 1900 m. lmb.	Kosovë	e Kosovës	E rrallë
	OPHYLLACEAE						
6	**Dianthus scardicus Ëettst. 1892.** *(Karafili i Sharrit)*	VI–VII/ VIII	Në vende shkëmbore dhe me bar të zonës subalpike dhe alpike	Malet e Sharrit Luboten, revallc).	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara
	VOLVULACEAE						
7	**Convolvulus cochlearis Griseb. 1844.** *(Dredhja e Kosovës)*	VI–VII/ VIII	Në vende me bar dhe gurishtore të zonës kodrinore me natyrë serpentine.	Gorancë (territori i Hanit të Elezit).	Kosovë	e Kosovës	E rrallë (bimë stenoendemike e Kosovës ende duhet domosdo të mbrohet me ligj)
	RASSULACEAE						
8	**Sedum flexuosum Ëettst. 1892.** *(Rrushqyqja e epshme)*	VI–VII/ VIII	Në vende shkëmbore, sidomos gëlqerore, të zonës subalpike	Malet e Sharrit Luboten, Oshlak).	Kosovë	e Kosovës	E rrallë

9	**Sempervivum kosaninii Praeger 1930.** *(Burgulli i Koshaninit)*	VII–VIII / IX	Në shkëmbinj gëlqeror ose serpentinor të zonës subalpike dhe alpike	Alpet Shqiptare.	Kosovë	e Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
	DIPSACACEAE						
10	**Cephalaria pastricensis Dorfl. et Hayek. 1921.** *(Cefalaria e Pashtrikut)*	VI–VII/ VIII	Në vende me bar, shkurre, pyje të zonës malore dhe subalpike.	Pashtrik, Alpet hqiptare Bjeshkët e bardhit, Zhleb).	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (Duhet të jenë nën mbrojtje të ligjit)
	FABACEAE						
11	**Astragalus fialae Degen 1900.** *(Arithja e Fialit)*	VII/ VIII	Në shkëmbinj të zonës alpike	Alpet hqiptare Bjeshkët e bardhit).	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj).
12	**Trifolium ëettsteinii Dorf. et Hayek 1921.** ***(Tërfili i Vetshtajnit)***	VII–VIII/ VIII-IX	Në kullosa subalpike dhe alpike	Pashtrik.	Kosovë	e Ballkanit	e rrallë (duhet të mbrohet me ligj)
	LAMIACEAE						
13	**Micromeria albanica (Griseb. ex K. Maly) Silic. 1979.** *(Bishtmiu shqiptar)*	VII–VIII/ III–IX	Në vende shkëmbore – gëlqerore të zonës kodrinore – malore	Gryka e ëbardhit të Prizrenit.	Kosovë	e Kosovës	e rrallë (duhet të mbrohet me ligj)
14	**Thymus albanus H. Braun 1892.** ***(Listra shqiptare)***	V–VI/ III–IX	Në vende të thata, shkurre, kullosa, pyje të zonës subalpike dhe alpike, posaçërisht në substrate gëlqerore	Oshlak, Koritnik, Alpet hqiptare.	!	e Ballkanit	Duhet të mbrohet me lig
15	**Thymus doerfleri Ronn. 1924.** *(Listra e Dorflerit)*	VI–VII/ III–IX	Në vende të thata, pyje të rralla të zonës malore subalpike	Koritnik.	Kosovë	e Kosovës	Populacione të pakta (duhet të mbrohen me ligj)
16	**Thymus rochlenae Vel. 1903.** *(Listra e Rohlenes)*	VI/ VII	Në kullosa, livadhe të zonës malor dhe subalpike.	Oshlak, rethinat e Deçanit.	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj)
	LILIACEAE						
17	**Lilium albanicum Griseb. 1845.** *(Zambaku shqiptar)*	VI–VII/ VII	Në vende të freskëta shkëmbore të zonës malore - subalpike	Malet e Sharrit, Alpet hqiptare.	Kosovë	e Kosovës	Duhet të jetë e mbrojtur meligj
	POACEAE						
18	**Stipa mayer Mart. 1971.** *(Pendëkaposhi i Mayerit)*	V–VI/ VII	Në kullosa me natyrë serpentinore	Koznik, Rajoni i irushës, Godanc, lanasellë etj.	Kosovë	e Kosovës	Duhet të mbrohet me ligj
	NUNCULACEAE						
19	**Aconitum pentheri Hauek 1916.** *(Akoniti i Rusolisë)*	VII / VIII	Në vende me shkurre dhe me bar të zonës malore dhe subalpike	Alpet hqiptare (Zhleb, Rusoli).	Kosovë	e Kosovës	Populacionet e saj janë të pakëta (duhet të jetë nën mbrojtje të ligjit)

	ROSACEAE						
20	**Potentilla calabra ten. 1811.** ***(Zorrëca e Kalabrisë)*** (bënë pjesë në grupin Potentilla argentea P. Ë. Ball.. Është lloj i ri për florën e Ballkanit (lloj endemik apenino – ballkanik) i konstatuar vetëm në lokalitetin Guri i Zi (Restelicë – Kosovë).	VII–VIII / VIII	Në shkëmbinjë acidicë me prejardhje vullkanike në lartësi mbidetare rreth 2000 m.	Malet e Sharrit (Guri i Zi estelicë – Kosovë).	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (me që është specie me vetëm një loklitet në Siujdhesën Ballkanike, meriton kujdes dhe mbrojtje të posaqme, ngase populacionet e saj janë të rrezikuara dhe u kanoset rreziku i zhdukjes në gadishullin Ballkanik)
	Potentilla doerfleri Ëettst. 1892. *(Zorrëca e Dorflerit)*	VII–VIII/ IX	Në vende me bar dhe shkëmbore të zonës alpike.	Malet e Sharrit (Bistra, Maja e Zezë).	Kosovë	e Kosovës	e rrallë (rritet në gr4upe pak a shumë të mëdha, por është e rrallë dhe populacionet e saj janë të rrezikuara, andaj duhet të mbrohen me ligj)
	Rubus ipecensis rech. 1935. *(Manaferra e Pejës)*	!	Në vende shkurrore serpentinore	Gubavc (Pejë)..	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj)
	AXIFRAGACEAE						
	Saxifrage scardica Griseb. 1843. *(Iriqëza e Sharrit)*	VI–VIII/ III– X	Në shkëmbinjë të zonës alpike	Koritnik, Alpet hqiptare Leqinak, oprivnik etj).	Kosovë	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj)
	Verbascum scardicolum Bornm. 1922. *(Barpeshku i Sharrit)*	VII–VIII/ VIII	Në kullosa e shkurre të zonës subalpike	Malet e Sharrit Oshlak).	Kosovë (vetëm në Kosovë)	e Kosovës	Populacione të rrezikuara (duhet të mbrohen me ligj)
	Ëulfenia blecicii Lak. 1971. *(Vulfenia e Bleçiqit)* (Në Kosovë janë të përhapura dy nënlloje të këtij lloji: Ë. blecicii subsp. blecicii dhe Ë. blecicii subsp. rohlenae, të cilat janë të përhapura në Alpet Shqiptare)	VI–VIII/ VIII	Në vende me bar, pyje e shkurre të zonës subalpike	Alpet hqiptare.	Kosovë	e Kosovës	!
	VIOLACEAE						
	Viola gracilis Sib. Et Smith. 1806. *(Vjollca barishtore)*	VI – VII / VII	Në kullosa të zonës alpike	Malet e Sharrit.	Kosovë	e Kosovës	Lajmërohet në grupe të vogla ose të mëdha

Figura 85. Achilleo Aleksandri Regis

Fig. 86. Aconitum pentheri

Figura 87. Stipas mayer

Figura 88. Potentilla dorfleri

Figura 89. Micromeria albanica

Figura 90. ***Convolvulus cochlearis***



Figura 91. Harta e lokaliteteve te llojeve të rëndësishme endemike

Flora e Kosovës është e përfaqësuar edhe me lloje me areal të ngushtë, që konsiderohen si lloje bimore të rralla dhe të rrezikuara. Ekziston një listë e ngushtë e llojeve bimore të rralla dhe të rrezikuara, Kosova ende nuk e ka të përgatitur Listën e Kuqe të llojeve.

Tabela 9. Disa lloje bimore që konsiderohen të rralla dhe të rrezikuara në Kosovë	
1.	Bershei i rëndomtë / ***Taxus baccata L.***
2.	**Bujgeri** / *Quercus trojana Ëebb.*
3.	**Vidhi i rëndomtë** / *Ulmus campestris L.*
4.	**Panja malore** / *Acer heldreichii Orph.*
5.	**Boshtra** / *Forsythia europea Deg. Et Bald.*
6.	**Vulfonia** / *Ëulfenia carinthiaca Jack.*
7.	**Tulipani i Sharrit** / *Tulipa scardica Bornm.*
8.	**Troliusi** / *Trollius europeus L.*
9.	**Zambaku** / *Lilium albanicum Gris.*
10.	**Karafili i Sharrit** / *Dianthus scardicus Ëetst.*
11.	**Kurorezë** / *Fritillaria graeca Boiss. Et Sprun.*
12.	**Bathra** / *Narcissus poeticus L.*
13.	**Lepjeta** / *Rumex balcanicus Roth.*
14.	**Asheja** / *Ilex aquilifolium L.*
15.	**Xerxelja** / *Dphne blagayana Freyer.*
16.	**Ramonda** / *Ramonda serbica Panč.*
17.	**Bozhuri dekorativ** / *Paeonia decera Anders.*
18.	**Bozhurea koraline** / *Paeonia corallina Retz.*
19.	**Valdestenia** / *Ëaldesteinia geoides Ëilld.*
20.	**Poligala** / *Polugala dorfleri Hayek.*
21.	**Moltkea** / *Moltkea doerfleri Ëettst.*
22.	**Dioskora** / *Dioscorea balcanica Koshan.*
23.	**Rododendroni** / *Rhododendron ferrugineum L.*
24.	**Sanëza e verdhë** / *Gentiana lutea L.*

Figura 92 ***Forsythia europea***

Figura 93. Quercus trojana

Figura 94. *Moltkea doerfleri*

Figura 95. *Paeonia decora*

Bimët mjekësore

Rëndësi të veçantë për Florën e Kosovës paraqesin edhe llojet mjekësore dhe aromatike. Me këtë rast duhet theksuar se disa nga këto lloje janë të kërcënuara për zhdukje nga mbledhja e pakontrolluar e tyre. Sidomos është shqetësuese mbledhja e tyre në fazën e lulëzimit dhe mbledhja e rizomave, zhardhokëve dhe organeve tjera reproduktive të këtyre bimëve.

Tab. 10. Lista e Bimëve Mjekësore në Kosovë me Potencial Ekonomik				
Familja	Emri shkencor	Emri ne Shqip	Emri ne Anglisht	Lloji i bimës
	Bimët jo të lulëzuara			
Cupressaceae	**Juniperus communis**	Dellinja e zeze	common juniper	Drunore
	Juniperus oxycedrus	Dellinja e kuqe	juniper	Drunore
Equisetaceae	**Equisetum arvense**	Keputja e ares	horsetail	Barishtore
Pinaceae	**Pinus nigra**	Pisha e zeze	Austrian pine	Drunore
	Pinus sylvestris	Pisha e bardhe	scotch pine	Drunore
	Thuja occidentalis	Tuja perendimore	cedar	Drunore
	Bimët e lulëzuara			
Acoraceae	**Acorus calamus**	Kashtefryza	calamus	Barishtore
Asteraceae	**Achillea millefolium**	Barpezmi	common yarroë	Barishtore
	Cichorium intybus	Bresa	chicory	Barishtore
	Matricaria chamomilla	Kamomili	German chamomile	Barishtore
	Taraxacum officinale	Lule shrudha mjekesore	common dandelion	Barishtore
	Tussilago farfara	Thunder mushke	coltsfoot	Barishtore
	Urtica dioica	Hithra	stinging nettle	Barishtore
	Arctium lappa	Rrodhja	greater burrdock	Barishtore
	Artemisia absinthium	Pelini	absinthium	Barishtore
	Arnica montana	Arnika	mountain arnica	Barishtore
	Calendula officinalis	Kalendula mjekesore	pot marigold	Herb
Betulaceae	**Betula pendula**	Meshtekna	European ëhite birch	Tree
Boraginaceae	**Symphytum officinale**	Kufelma mjekesore	common comfrey	Herb
Caprifoliaceae	**Sambucus nigra**	Shtogu	Eu. black elderberry	Tree
Caryophyllaceae	**Saponaria officinalis**	Saponika	bouncingbet	Herb
Cornaceae	**Cornus mas**	Thana	Cornelian cherry	Tree
Cruciferae=**Brassicaceae**	**Capsella bursa-pastoris**	Mediculs-shtraper	shepherd's purse	Herb
Fagaceae	**Castanea sativa**	Geshtenja	European chestnut	Tree
Ericaceae	Arctostaphylos uva-ursi	Rrush arusha		Herb
	Vaccinium myrtillus	Boronica	Bilberry	Herb
Gentianaceae	**Centaurium erythraea**	Bar ethesh		herb
	Gentiana lutea	Sanza	yelloë gentian	herb
Hypericaceae	**Hypericum perforatum**	Lulja e ballsamit te shpuar	St. Johnsëort	herb
Lamiaceae	**Melissa officinalis**	Melissa	common balm	herb
	Origanum vulgare	Rigoni i zakonshem	oregano	herb
	Prunella vulgaris	Prunella	common selfheal	herb
	Salvia officinalis	Sherbela	kitchen sage	herb
	Teucrium chamaedrys	Arresi dushkvogel		
	Thymus serphyllum = **Thymus pulegioides**	Krasta	lemon thyme	herb
	Satureja hortensis	Thrumbisht	summer savory	herb
	Stachys officinalis	Sarusha mjekesore	common hedgenettle	herb
Leguminosae = **Fabaceae**	**Medicago sativa**	Tërfoja	alfalfa	herb
	Ononidis spinosa	Therra e lepurit		

	Phaseolus vulgaris	Fasulja	kidney bean	herb
	Galega officinalis	Qerbashi	professor-ëeed	herb
Liliaceae	Colchicum autumnale	Xherrokulli	autumn crocus	herb
Malvaceae	**Malva sylvestris**	Mellaga pyjore	high malloë	herb
	Althaea officinalis	Mullanjadhja	common marshmalloë	herb
Papaveraceae	**Chelidonium majus**	Latrapeci	celandine	herb
	Papaver rhoeas	Lulkuqu	corn poppy	herb
Plantaginaceae	**Plantago lanceolata**	Gjethdelli heshtor	narroëleaf plantain	herb
Primulaceae	**Primula veris**	Agulicja	coëslip primrose	herb
Ranunculaceae	**Paeonia officinalis** Paeonia decorah Paeonia carolina	Bozhure mjekesore	common peony	herb
Rosaceae	Crateagus monogyna	Murrizi njeberthamor		
	Rosa canina	Trendafili I eger	dog rose	herb
	Agrimonia eupatoria	Agrimoni	churchsteeples	herb
	Alchemilla vulgaris	Virak		
Rubiaceae	**Galium verum**	Ngjitesja e vertete	Yelloë Spring bedstraë	herb
Rutaceae	**Dictamnus albus**	Bari I uzos	gasplant	herb
Salicaceae = **Celastraceae**	**Salix alba**	Shelgu	ëhite ëilloë	tree
Sapindaceae	**Aesculus hippocastanum**	Gështenja e egër	horse chestnut	tree
Scrophulariaceae	Verbascum sp.	?		
	Digitalis lanata	Luletogeza leshtake	Grecian foxglove	Herb
	Digitalis purpurea	Luletogezi I purepurte	purple foxglove	Herb
Solanaceae	**Atropa bella-donna**	Helmarina	belladonna	Herb
	Capsicum annuum	Speci	cayenne pepper	Herb
Tiliaceae = **Malvaceae**	**Tilia cordata**	Bliri gjethvogel	littleleaf linden	Tree
Umbelliferae = **Apiaceae**	**Daucus carota**	Karota	Queen Anne's lace	Herb
	Pimpinella anisum	Anason	anise burnet saxifrage	Herb
	Angelica archangelica	Angjelika	angelica	Herb
	Foeniculum vulgare	Marac	sëeet fennel	Herb
Valerianacae	**Valeriana officinalis**	Haraqina mjekësore	garden valerian	Herb
Verbenaceae	**Verbena officinalis**	Sporisi mjekësorë	herb of the cross	Herb

Figura 96. Cornus mas

Figura 97. Crataegus monogyna

Pyjet

Janë ekosisteme me të përparuara natyrore dhe kanë rëndësi shumë të madhe sepse ato janë ekosisteme me biodiversitet shumë të pasur. Pyjet janë rregullatorë natyrorë të klimës, ruajnë kualitetin e ujit, ajrit, ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe nga shpëlarja e shtresës produktive të tokës. Pyjet po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO_2 në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me Oksigjen. Janë resurse natyrore të ripërtritshme, produktet e te cilit mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rendësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Pyjet përveç se pengojnë erërat e fuqishme janë edhe ambient relaksimi dhe çlodhës për njeriun.

Megjithëkëtë, ndikimi i njeriut në pyje është shumë i theksuar. Pyjet janë të ndjeshme sidomos në ndotje të ajrit. Prerja e pakontrolluar e pyjeve ndikon në shfaqjen e shumë ndryshimeve mjedisore si ndryshime klimatike, vërshime etj.

Sipas inventarizimit kombëtar të pyjeve që është realizuar në vitin 2003, është vlerësuar se sipërfaqja totale pyjore është 464,800 ha, apo 42% e sipërfaqes së përgjithshme të Kosovës. Rreth 278,880 ha, janë toka pyjore në pronësi publike, që menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës (APK), dhe që është e organizuar në gjashtë rajone gjeografike. Pyjet gjetherënëse përfaqësojnë 90 % të pyjeve të Kosovës dhe janë të dominuar nga dushqet dhe ahu, kurse pyjet halore mbulojnë rreth 7 % të pyjeve dhe janë të dominuar nga pisha, bredhi dhe hormoqi. [26]

Figura 98. Harta e shpërndarjes së pyjeve në Kosovë

Vëllimi total i drurit në këmbë, në tokat pyjore publike është vlerësuar të jetë 33.5 milion m^3 dhe në pyjet private rreth 19.5 milion m^3. Ritja vjetore bruto është përafërsisht 1.3 milion m^3. Inventarizimi ka vlerësuar se prerja e lejueshme vjetore prej 900.000 m^3, bruto korrespondon me 77% të rritjes vjetore në zonat e shqyrtuara. Rreth 700,000 m^3 do të

26 APK , 2007

prehen në pyjet e larta dhe rreth 200.000 m^3 në pyjet e ulëta. Operacionet kryesore në shfrytëzim të pyjeve në Kosovë janë pastrimet dhe rrallimet. Infrastruktura rrugore është relativisht e dobët me një densitet të ultë të rrugëve dhe mosmirëmbajtje gjatë viteve të shkuara. Kjo ka rezultuar me prerje që përqendrohen në zonat me qasje të lehtë dhe pjesa më e madhe e pyjeve në lidhje me vëllimin e lejueshëm shtrihen në zona të largëta, ku qasja është e vështirë. Momentalisht, prerjet zyrtare tani janë diku rreth 200,000 m^3 në vit. Që nga mbarimi i luftës shumica e masës drunore është shfrytëzuar për dru zjarri dhe ky është burimi kryesor për nxehje, bile edhe në disa zona urbane. Kërkesa për dru zjarri është e madhe, kështu që sipas disa vlerësimeve supozohet se kërkesa kombëtare sillet afër 1 milion m^3 në vit.

Pjesa me e madhe e pyjeve te Kosovës rreth 50 % i takon vjetërsisë prej 0-20 vjet, ndërsa pjesa me e vogël e pyjeve rreth 17 % i takon vjetërsisë 60-80 vjet.

Tabela 11. Klasa e vjetërisë së pyjeve sipas pronësisë në % ***(APK 2006)***

Klasa e vjetërsisë	Pyje publike	Pyje private
0-20	29 %	**23 %**
20-40	18 %	**32 %**
40-60	11 %	**23 %**
60-80	**9 %**	**8 %**

Pyllëzimet në Kosovë mesatarisht janë rreth 240 ha për vit. Ekziston një fidanishte në Pejë, nën kontroll të Institutit Hulumtues Pyjor, i cili prodhon rreth 700,000 fidanë në vit. Speciet kryesore janë pishë (*Pinus Nigra dhe Pinus sylvestris,), hormoq (Picea abies) dhe Dugllazi* (*Pseudotsuga taxifolia*). Për çdo vit APK alokon rreth 10% të fidanëve të prodhuara për sektorin privat. Deri më tani suksesi më i mirë në pyllëzime është konsideruar pyllëzimi i përzier dhe kjo kur është ndërmarr edhe nga Agjencia Pyjore e Kosovës (APK) apo sektori privat. Një studim i vitit 2001 për Sektorin e Pylltarisë ka konkluduar se vlera vjetore e produkteve dhe përfitimeve tjera të pyjeve dhe tokave pyjore është prej 50 – 70 milion €. Aktualisht, kontributi i sektorit të pylltarisë në GDP është vlerësuar të jetë në mes të 1.8 % deri në 2.6%.

Tabela 12. Pyllëzimi i pyjeve sipas llojit dhe pronësisë*(MBPZHR,2003)*

Lloji i pyllëzimit	Pyje publike	Private	E panjohur	Gjithsejtë
Përkohësisht pa trungje	21.200	7.600	3.400	**32.200**
Pyllëzim natyror	82.000	74.000	15.200	**171.200**
Pyllëzim artificial	1.800	400	---	**36.600**
Pyllëzim i përzier	**64.000**	**54.000**	**19.000**	**137.000**

Inventarizimi ka vlerësuar se rreth 40% të pyjeve publike dhe 29% të pyjeve private kanë qenë subjekt i aktiviteteve të prerjeve të pakontrolluara apo ilegale. Gjithashtu rezultatet e inventarizimit konfirmojnë opinionet e ekspertëve se pyjet e ulëta, veçanërisht ato në pronësi publike janë të ekspozuara shumë me prerje për dru zjarri. Rezultatet po ashtu tregojnë se shumë pyje të reja dhe të moshës mesatare kanë nevojë urgjente për intervenime menaxhuese, duke filluar me pastrime/ rrallime para-komerciale e deri të rrallimet komerciale. Pyjet gjithashtu janë burim

i produkteve jo-drunore. Këtu përfshihen, kërpudhat e egra, manaferrat, pemët, lajthia, gështenja dhe produkte që rrjedhin prej tyre (marmelata, lëngje, xhelatina, etj.), mjaltë, rërë, zhavorr dhe gurë/minerale. Gjithashtu ekzistojnë mundësi për të zhvilluar gjuetinë dhe agro/eko-turizmin.

Pyjet e Kosovës janë të ndara në pyje të larta, pyje të ulëta, shkurre dhe pyje të degraduara. Pjesën më të madhe të pyjeve të Kosovës e përbejnë pyjet e ulëta (42 %), ndërsa pjesën më të vogël pyjet e larta (15 %).

Tabela 13. Pyjet e Kosovës sipas llojit dhe pronësisë ne ha dhe % *(APK)*

Lloji i pyjeve	Pronësia			%
	Shtetërore	**Private**	**Gjithsej**	
Pyje te larta	51000	15000	66000	15
Pyje te ulëta	116000	63000	179000	42
Pyje te degraduara	34000	48000	82000	20
Shkurre/kaçuba	67000	36000	103000	23
Gjithsej	268000	162000	430000	100

Mbi 50.000 ha të pyjeve janë të shtrira në Zona të Mbrojtura. Pjesa me e madhe e tyre i takon Parkut Nacional “Mali Sharr” (18.884 ha) dhe “Gërmisë” (885 ha) .

Sipërfaqja e pyjeve të mbrojtura ka tendencë rritjeje. Që në vitin 2003 është propozuar për mbrojtje edhe territori i ”Bjeshkëve të Nemuna” me një sipërfaqe mbi 20.000 ha pyje.

Sipas të dhënave të prezantuara në Raportin e publikuar nga Komisioni për vlerësimin e gjendjes së pyjeve të dëmtuara nga zjarri, rreth 6.682 ha e pyjeve të Kosovës gjatë vitit 2007 është përfshirë nga zjarri. Nga kjo sipërfaqe 4.142 ha janë pronë publike, ndërsa 2.548 ha janë pronë private. Rreth 1.439 ha e sipërfaqes së dëmtuar nga zjarri është kullota. Vëllimi i humbur në m^3 dru zjarri shprehur në Euro llogaritet të jetë rreth 29.645, ndërsa vëllimi i humbur në m^3 dru teknik është 17.170. Vlera e humbur e masës drunore në këmbë është 2.942.338.

Pyjet janë resurse kryesore për mirëqenien ekonomike, sociale dhe mjedisore të popullit të Kosovës. Një përqindje e madhe e biodiversitetit shtrihet në pyje dhe menaxhimi i pyllit do të ketë rol kyç në të ardhmen, për të përmbushur kërkesat për kriteret e rrjetit të “Natyra 2000”, sipas Direktivave të BE-së për Zogjtë dhe Habitatet. Përfitimet e shumëfishta të pyjeve mund të sigurohen vetëm nëse pyjet menaxhohen në mënyrë të duhur dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve (MQP).

Fig. 99. Pyjet e hormoqit në Malet e Sharrit

Figura 100. Pyjet e Ahut në Malet e Sharrit

Figura 101. Prerja e pyjeve në Bjeshkët e Nemuna

FAUNA

Duke marrë parasysh pozicionin gjeografik, relievin, kompleksin e faktorëve ekologjik, historik dhe faktorëve të tjerë, Kosova hynë në radhën e vendeve me faunë më të pasur të Gadishullit Ballkanik.

Territoret më të pasura me faunë janë: “Malet e Sharrit”, “Bjeshkët e Nemuna”, “Kopaoniku”, “Mokna”,dhe masivet tjera malore ,lumenjtë dhe liqenet.

Sipas hulumtimeve të deritanishme në Kosovë jetojnë mbi 250 lloje të egra të kurrizorëve si dhe numër i madh i pakurrizorëve (deri tani janë të njohura 200 lloje të fluturave, mbi 500 taksone të makrozoobentosit të ujërave).

Në kuadër të zonave të mbrojtura ekzistojnë dy rezervate strikte në të cilat janë të mbrojtur dy lloje shtazore. Rezervati i **Rusenicës** në komunën e Suharekës, ***vendbanim i rrëqebullit (Lynx lynx)*** dhe **Kozhnjari** në komunën e Deçanit, ***vendbanim i dhisë së egër (Rupicapra rupicapra)***.

Në kuadër të faunës vend me rëndësi zënë edhe shpezët me rreth 180 lloje. Zonat më të pasura me shpendë janë “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Malet e Sharrit”.

Figura 102. Flutura fushore

Figura103 Çerdhe e mëllenjës (*Turdus merulla*)

Pyjet e larta dhe ekosistemet malore të Kosovës ofrojnë kushte të volitshme për jetesën e popullatave të rëndësishme të gjitarëve të mëdhenj si: ariu i murrmë (*Ursus arctos*), rrëqebulli (*Lynx lynx*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), pastaj të shumë llojeve të shpendëve grabitqare dhe këngëtare mjaftë të rëndësishme për ornitofaunën e Kosovës, Ballkanit dhe Evropës. Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonj bardhë (*Falco naummani*), pulegra (*Tetrao urogallus*) janë disa nga llojet më reprezentative të vendit të cilat kanë edhe status ndërkombëtar të mbrojtur.

Fauna e Bjeshkëve të Nemuna

Territori i "Bjeshkëve të Nemuna" shquhet për shumëllojshmëri biologjike e peijzazhore të pasur falë pozicionit gjeografik, kushteve gjeologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të relievit e të klimës. Relievi i thyer dhe vertikaliteti i theksuar ofrojnë kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh bimore dhe shtazore**.**

"Bjeshkët e Nemuna" nga aspekti faunistik karakterizohen me një faunë mjaft të pasur, heterogjene, endemike dhe shumë interesante. Kjo pasuri faunistike e Kosovës e me të edhe e "Bjeshkëve të Nemuna" si masivit më të madh në Ballkan, është rezultat i ndikimeve të shumta të regjionit mesdhetar, euro-siberian dhe atij nordiko-alpin, si dhe i ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike në të kaluarën. Në territorin e "Bjeshkëve të Nemuna" mund të gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve e që janë mjaftë të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjerë. Shumë prej tyre janë relikte, endemike, të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat dhe konventat ndërkombëtare .

Fauna e "Bjeshkëve të Nemuna" në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës prej 8 lloje të peshqve, 13 lloje ujëtokësorë, 10 lloje rrëshqitës, 148 lloje shpendë(sipas disa të dhënave më të reja 175 lloje, ndërsa mendohet të ketë mbi 200 lloje), 37 lloje gjitarë dhe 129 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera.

Llojet më reprezentative të faunës së Kosovës që jetojnë në territorin e "Bjeshkëve të Nemuna" janë: rrëqebulli (*Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), kaprolli(*Capreolus capreolus*), dhia e egër(*Rupicapra rupicapra*), shqiponja e maleve(*Aquila chrysaetos*), fajkoi thonjëbardhë(*Falco naummani*), pulegra(*Tetrao urogallus*) etj.



Figura104. Përbërja e faunës së Bjeshkëve të Nemuna

Ihtiofauna

Territori i "Bjeshkëve të Nemuna" përshkohet nga përrenj të shumtë, kurse rrjedhje kryesore paraqet Lumëbardhi i cili i përket rrjedhës së Adriatikut. Sipas karakteristikës ihtiologjike këto rrjedha i takojnë tipit të ujërave Salmonide, vendbanimi i të cilave përbëhet kryesisht nga popullata e dy llojeve të troftës: troftës së përroit (*Salmo trutta m. fario L.* dhe *Salmo marmoratus C.*). Këto rrjedha të ujit asnjëherë nuk shterin, as në kohë thatësie të mëdha. Këto i karakterizon rrjedha e shpejtë e kushtëzuar nga pjerrësia e terrenit. Kur kemi reshje të mëdha, shkrirje të borës, këta turbullohen dhe bëhen të patejdukshëm. Regjimi i temperaturës është relativisht stabil, dhe këto nuk janë të ndotura me ujëra industriale dhe të xeheroreve. Në pjesët burimore, trofta e përroit paraqet llojin dominant të peshkut, në vazhdim kah grykat pjesëmarrja në përqindje e peshqve ndërrohet në dobi të llojeve Ciprinide.

Herpetofauna

"Bjeshkët e Nemuna" për nga përbërja e faunës së ujëtokësorëve dhe rrëshqitësve paraqesin vendin më të rëndësishëm të Gadishullit Ballkanik. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme herpetofauna përbëhet prej 23 llojeve edhe atë 13 ujëtokësorë dhe 10 rrëshqitës.

***Ujëtokësorët (Amphibia)**:* Numri më i madh i ujëtokësorëve është i lidhur për ambientin ujorë vetëm në periodën e shumimit dhe të lëshimit të veve, ndërsa periudhën tjetër e kalojnë në vende të lagshta si : nën rrënjë, gjethe të rëna, gropa dhe në vende të tjera ku ka mjaft lagështi. Në kuadër të ujëtokësorëve në "Bjeshkët e Nemuna "prezentë janë dy rende: *Ujëtokësorët me bisht (Urodela)* të përfaqësuara me një familje, 2 gjini dhe 6 lloje. Llojet më karakteristike të familjes Salamandridae janë: picrraku dhe tritoni.

*Ujëtokësorët pa bisht (Anura)**,*** hasen pranë vendeve të lagështa në pyje ose pranë sipërfaqeve të ujit, ndërsa disa lloje të bretkosave siç janë bishtëfultërzat dhe disa tjerë zhvillohen ekskluzivisht në ambient ujor. Në këtë rend bëjnë pjesë 5 familje me afërsisht 7 lloje. Llojet më përfaqësuese të bretkosave janë: gargaliqi, bretkosa e malit, bretkosa e përrenjve, bretkosa e madhe e kënetave etj.

Figura 105. Breshka (*Testudo sp*.)

Rrëshqitësit (Reptilia): Nga grupi i Rrëshqitësve që jetojnë në territorin e "Bjeshkëve të Nemuna" përmendim 5 familje me 10 lloje. Dallohen breshka e pyllit dhe e kënetave, hardhucat dhe gjarpërinjtë.

Ornitofauna

Habitatet natyrore të "Bjeshkëve të Nemuna" ofrojnë vendstrehim për shumë lloje të shpendëve. Shumë prej tyre janë endemike dhe me status të pafavorshëm ruajtjeje në Ballkan dhe Evropë. Deri më sot janë vrojtuar 148 lloje, por mendohet të ketë mbi 200 lloje. Mbrojtja e tyre ka karakter internacional, për këtë arsye "Bjeshkët e Nemuna" janë të evidencuara në listat ndërkombëtare si IBA rajon (Important Bird Area). Numri më i madh i llojeve të shpendëve kanë shtrirje jashtëzakonisht të gjerë, prandaj mund të hasen në të gjitha pjesët e "Bjeshkëve të Nemuna" dhe më gjerë në vendet fqinje. Ndërsa, një numër i vogël i shpendëve është i lidhur për lokalitete të ngushta, përkatësisht vendqëndrime specifike siç është rasti me gjelin e egër të madh(*Tetrao urogallus*). Lloje tjera të rëndësishme të shpendëve janë: shqiponja e maleve(*Aquila chrysaetos*), shqiponja perandorake(*Aquila heliaca*), fajkoi(*Falco naumanni*), mbreti i shkurtes(*Crex crex*), drobeja e madhe(*Otis tarda*), thëllëza gurore(*Alectoris graeca*), etj. Në mes tyre kemi 4 lloje të rrezikuara globalisht.

Mammalofauna

Fauna e gjitarëve të "Bjeshkëve të Nemuna" dallohet me përfaqësimin e të gjitha llojeve të gjitarëve të cilët jetojnë në tërë Kosovën dhe Gadishullin Ballkanik, si dhe disa lloje që nuk gjenden në pjesët e rrafshëta. Këto lloje janë të lidhura ekskluzivisht për vendbanimet e larta bjeshkatare siç janë: dhia e egër, rrëqebulli, ariu i murrmë. Grupi më i përfaqësuar i gjitarëve për nga numri i llojeve përkatësisht popullatave të tyre janë brejtësit. Klasën e gjitarëve e përbëjnë 3 lloje insektengrënës, 19 lloje brejtës, 11 lloje mishngrënës, 1 lloj jopërtypës, 3 lloje ripërtypës. Me gjithë territorin e vogël të "Bjeshkëve të Nemuna "në të jetojnë edhe gjitarë që i përkasin listës së llojeve të rrezikuara në shkallë botërore. Aty jetojnë popullata të rëndësishme gjitarësh të mëdhenj si ariu i murrmë(*Ursus arctos*), rrëqebulli(*Lynx lynx*), dhia e egër(*Rupicapra rupicapra*), kaprolli(*Capreolus capreolus*), ujku(canis lupus), çakalli(*Canis aureus*), etj.

Figura 106. Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*)

Rende	Familje	Lloje
PODICIPEDIFORMES	1	2
CICONIIFORMES	2	2
ANSERIFORMES	1	3
FALCONIFORMES	2	17
GALLIFORMES	4	9
CHARADRIFORMES	1	2
COLUMBIFORMES	1	5
CUCULIFORMES	1	1
STRIGIFORMES	1	6
CAPRIMULGIFORMES	1	1
APODIFORMES	1	2
CORACIFORMES	3	3
PICIFORMES	1	10
PASSERIFORMES	21	85
Gjithsej : 14	41	148

Tabela 14. Ornitofauna e Bjeshkëve të Nemuna në taksone



Figura 107. Mammalofauna e Bjeshkëve të Nemuna sipas rendeve

Fauna e Sharrit

Territori i "Sharrit" me biotopet e ndryshme është shumë i pasur me faunë. Në të janë prezentë lloje të veçanta të shtazëve të cilat ekskluzivisht janë të lidhura për biotope specifike,që dmth. se përhapja e tyre është e ngushtë dhe i përkasin llojeve endemike. Ndërsa llojet e tjera që hasen në biotope të ndryshme janë të përhapjes së gjerë. Fauna e Sharrit deri sot nuk është hulumtuar sa duhet, mirëpo në bazë të të dhënave të literaturës mund të konstatohet se fauna e Sharrit përbëhet prej: *7 lloje peshq, 9 lloje amfibe, 10 lloje reptilë, 154 lloje shpendë dhe 30 lloje gjitarë.*

Peshqit *(Pisces*)

Territorin e Sharrit e karakterizojnë rrjedhjet e përroskave dhe lumenjve malorë që i takojnë derdhjes së lumit Lepenc, që derdhet në detin Egje dhe derdhjes së lumit Bistrica e Prizrenit, në Adriatik. Në bazë të njohurive të gjertanishme në këto rrjedhje jetojnë këto lloje të peshqve: trofta e përroskave (*Salmo trutta m.faro L.*), mustaku i përroskave (*Barbus fluviatilis Ag*.), ngjala (*Anguilla vulgaris*),mlyshi (*Esox lucius*), krapuliqi, krapi(*Cyprinus carpio*), perka (*Perca fluviatilis*).

Ujëtokësorët(*Amphibia*)

Në "Sharr" prezentohen me llojet: Picrraku*(Salamandra maculosa*),picrraku i zi (*Salamandra atra*), tritoni i zakonshëm (*Triturus vulgaris*), thithëlopa (*Bufo bufo*), thithëlopa e gjelbër (*Bufo viridis*), gargaliq*i* (*Hyla arborea*), bretkoca e pyllit e kuqërremët*(Rana temporaria*), bretkoca kërcimtare*(Rana dalmatina*), bretkoca e përrenjëve (*Rana graeca*)

Zvarranikët **(** *Reptilia* **)** : breshkujza (*Emys orbicularis),* breshka tokësore (*Testudo graeca*), hardhuca e gjelbër (*Lacerta viridis*), hardhuca e mureve*(Lacerta muralis*), hardhuca e përhimë*(Lacerta agilis*)*,* gjarpri i madh i ujit*(Natrix natrix*), gjarpri i vogël i shiut*(Natrix tesselata),* nepërka*(Vipera ammodytes*), nepërka e malit (*Vipera berus*), kokëzogëza (*Anguis fragilis)*

Figura 108. Bretkosa nga Malet e Sharrit *(Rana sp)*

Shpendët (*Aves*)

Shpendët e Sharrit paraqiten në të gjitha biotopet, ndërsa numri i llojeve dhe popullatave të tyre i tejkalon të gjitha klasat tjera të faunës me përjashtim të insekteve. Numri më i madh i llojeve të shpendëve ka përhapje të gjerë, prandaj mund të hasen në të gjitha anët e Sharrit.

Meqenëse në këtë territor jeton numër i madh i shpendëve, në bazë të dispozitave të unionit ndërkombëtar mbi mbrojtjen e shpendëve, "Sharri " duhet të mbrohet si Ornitorezervat.

Tabela 15. Ornitofauna e Sharrit në taksone

Rendi	Fam	lloje
FALCONIFORMES	2	26
GALLIFORMES	1	6
CHARADRIFORMES	3	6
COLUMBIFORMES	1	5
CUCULIFORMES	1	1
STRIGIFORMES	2	8
CAPRIMULGIFORMES	1	1
APODIFORMES	1	1
CORACIFORMES	4	4
PICIFORMES	1	10
PASSERIFORMES	22	86
Gjithsej: 11	39	154

Figura 109. Shqiponja minjengrenese (*Buteo buteo*) nga Malet e Sharrit 2008

Figura 110. Lejleku i bardhë (*Ciconia ciconia*), Shterpce 2008

Gjitarët (Mammalia)

Fauna e gjitarëve të Sharrit është e përfaqësuar gati me të gjitha llojet të cilat jetojnë në Kosovë, si dhe ca lloje të cilat me ekologjinë e tyre janë të lidhura ekskluzivisht me biotopet e viseve të larta malore, ndërsa llojet tjera janë të përhapjes së gjerë. Kështu mund të konstatohet se Sharrin e karakterizojnë edhe lloje endemike të gjitarëve.

Insektngrënës(*Insectivora*): iriqi (*Erinaceus europeus*), urithi (*Talpa europae*), rrëmihësi i rëndomtë (*Sorex araneus*).Brejtës ***(****Rodentia*): lepuri i fushës*(Lepus europaeus*), miu bizam (*Ondatra zibethica*), miu i fushës (*Arvicola terrestris*), miu i shtëpisë (*Mus musculus*), miu me vija*(Apodemus agrarius*), miu i pyllit (*Apodemus silvaticus*), gjeri i madh (*Glis glis*), gjeri i lajthive*(Muscardinus avellanarius*), ketri (*Scirius vullgaris*), qeni i verbër (*Spalax monticola*), *Cricetus vulgaris*,*Cricetus cricetus*,*Castor fiber* .Mishngrënës (*carnivora**):***

Rrëqebulli*(Lynx lynx*), ariu i murrmë (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus),*dhelpra*(Canis vulpes*), macja e egër*(Felis silvestris*),baldosa*(Meles meles*), zardafi (*Martes martes*),

fishnjari(*Martes foina*), lundërza (*Lutra lutra*), bukla e vogël*(Mustela nivalis*), qelbësi*(Putorius putorius*). Jopërtypësit**:** derri i egër*(Sus scrofa*),Ripërtypësit: kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra).*

Lakuriqët (*Chiroptera*) të cilët jetojnë në Sharr deri tani askush nuk i ka studiuar, prandaj nuk dihet numri i tyre.

Fig. 111. Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*) Sharr, 2005

Ruajtja e Shtazëve të Egra ex- situ "MINI - KOPSHTET ZOOLOGJIKE"

Deri më tani nuk janë vendosur praktika institucionale për mbrojtjen e llojeve *"ex situ".* Mirëpo përkundër këtij fakti, kemi disa iniciativa private për mbajtjen e disa lloje të faunës së egër nëpër të ashtuquajturat "mini-kopshte zoologjike".

Gjatë vitit 2005 IKMN-ja ka ndërmarrë një iniciativë për evidentimin e të gjitha këtyre "mini-kopshteve zoologjike", përkatësisht vendet në të cilat mbahen lloje e rrezikuara të faunës sonë. Janë evidentuar llojet, numri i individëve si dhe kushtet në të cilat mbahen këto shtazë. Të gjitha këto nuk i plotësojnë kriteret për mbajtjen e këtyre shtazëve.

Këto kopshte janë të ngritura nëpër restorante të ndryshme dhe janë të hapura për vizitorë. Në to mbahen të izoluara llojet e shtazëve të egra rreptësishtë të mbrojtura, si dhe ato që në vendin tonë kanë një shtrirje të kufizuar si: **Ariu i murrmë** (*Ursus arctos Linn*.), **Dreri** (*Cervus elaphus Linn*.),**Dhelpra** (*Vulpes vulpes),* **Ujku** (*Canis lupus*), v**jedulla** (*Meles meles*), **Shqiponja e maleve** (*Aquila chrysaetos*), **Coftinari** (*Gyps fulvus*), **Shqiponja minjëngrënse** (*Buteo buteo L*.), **Skifteri** (*Falco pelegrinus*),**Kumrija** (*Streptotelia decaocta*), **Skifteri i përhimët** *(Falco pelegrinus)* etj

Figura 112. Tre arinjtë (para ikjes së 2 prej tyre) në Mini-kopshtin zoologjik në Restorant "Freskia" në Gërmi

Figura 113. Dhelpra në Mini-kopshtin zoologjik në Restorant "Freskia" në Gërmi

Figura 114. Ariu i murrmë në oborrin e KB"Agronomi" në Gjinofc – Suharekë



Figura 115. Dreri (Cervus elaphus),restorant të Ariu, Prishtinë

Figura 116. Shqiponja e maleve (Aquila chrysaetos) restorant "Shqiponja" në Prizren

Figura 117. Coftinari (Gyps fulvus) restorant "Shqiponja" në Prizren

Figura 118. Ariu i murrmë (Ursus arctos) restorant "Shqiponja" në Prizren

Figura 119. Ujku (Canis lupus) restorant "Shqiponja" në Prizren

Figura 120. Shqiponja minjëngrënse (Buteo buteo L.) restorant "Shqiponja" në Prizren

Figura 121. Skifteri i përhimët (Falco pelegrinus) restorant "Shqiponja" në Prizren

Në Kosovë është evidente mungesa e Kopshteve Zoologjike të cilat siç dihet përveç vlerave estetike, shkencore, kulturore, rekreacionit etj shërbejnë edhe si mënyrë e ruajtjes "ex-situ" (jashtë vendbanimit të tyre natyror) të disa llojeve të shtazëve, por kjo mungesë nuk i arsyeton veprimet e këtyre individëve për mbajtjen e këtyre shtazëve pa respektuar kriteret për funksionimin e tyre.

Duke marrë parasysh kushtet që duhet plotësuar me rastin e mbajtjes së shtazëve në izolim siç janë: hapësira dhe mjedisi, ushqimi, numri i individëve dhe kushtet për shumim, kontakti me llojet tjera, mundësia e ofrimit të kushteve sa më natyrore, përkujdesja e veterinarit etj. e shohim se shumica e tyre nuk janë të plotësuara në rastin e këtyre Mini-kopshteve.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës, ka të dhëna se në Kosovë ka edhe Mini-kopshte të tjera zoologjike ku mbahen lloje të rrezikuara të faunës së Kosovës dhe është në procedurë të evidentimit të tyre.

Duke përmbushur obligimet që dalin nga Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës si dhe Konventat Ndërkombëtare në lëmin e mbrojtjes së faunës së egër (*Konventa për ruajtjen e florës dhe faunës së egër dhe mjedisit natyror të Evropës - Bernë, 19 Shtator 1979, CITES – Uashington, 3 Mars 1973* etj)

Ministri i MMPH ka nxjerrë vendim [27] për mbrojtjen e disa llojeve të rralluara dhe të rrezikuara të gjitarëve, **Neni 3** ku thuhet se: ***veçanërisht është e ndaluar: çdo kapje e qëllimshme, izolim, mbajtja dhe tregtia e këtyre kafshëve*** si dhe **Neni 5**, ku thuhet se: ***veprimet në kundërshtim me ndalesat e parapara në këtë vendim do të dënohen sipas dispozitave të aplikueshme***.

Sipas këtij vendimi, **si lloje raritet, të rralla, të rralluara dhe të rrezikuara** të gjitarëve në Kosovë janë shpallur **rreptësishtë të mbrojtura** këto lloje:

- Ariu i murrmë (*Ursus arctos),*
- Rrëqebulli (*Lynx lynx),*
- Dhia e egër (*Rupicapra rupicapra),*
- Kaprolli (*Capreolus capreolus),*

27 Vendimi nr.04/03 i MMPH-së, dt. 23 maj 2003

- Macja e egër *(Felis sylvestris),*
- Dreri (*Cervus elaphus),*
- Ketri (*Scirius vulgaris),*
- Kunadhja e artë *(Martes martes*),
- Kunadhja e bardhë *(Martes foina)* dhe
- Gjeri i lajthive (*Muscardinus avellanarius).*

Mbrojtja e llojeve të rrezikuara të faunës "*in situ"* është e rregulluar në atë mënyrë që zonat speciale janë emëruar rezervate të mbrojtura të llojeve të caktuara të faunës (dy rezervate shtazësh). Aktualisht nuk ka ndonjë organizim për menaxhimin e tyre e as plane për mirëmbajtje dhe zhvillim.

Gjendja e faunës së kurrizorëve të lartë në Kosovë sipas të dhënave dhe informacionit të grumbulluar në terren është jo e mirë. Fauna jonë ka pësuar ndryshime me rritjen e intensitetit të ndikimit të aktivitetit të njeriut në zonat natyrore. Zhvillimi i veprimtarive të shumta dhe të ndryshme në natyrë siç janë: ndërtimi i vendbanimeve, zhvillimi i turizmit malorë, ndërtimi i objekteve industriale dhe hoteliere, gjuetia dhe peshkimi i paligjshëm, prerja e pyjeve, shfrytëzimi i inerteve dhe veprimtaritë tjera shpeshherë janë bërë pa kritere të qëndrueshme dhe kanë qenë faktorë kërcënues për biodiversitet. Nga ky ndikim gjithnjë e me shumë janë vërejt humbje dhe copëtim i habitateve, dëmtim dhe degradim i ekosistemeve, shqetësim i kafshëve të egra në natyre, zhdukje e llojeve apo kërcenim për zhdukje.

Peshkataria

Në Kosovë ka vetëm peshkim sportiv - rekreativ që nënkupton peshkimin me grepa për sport dhe rekreacion.

Peshkim ekonomik nuk bëhet, sepse Kosova nuk ka resurse për zhvillimin e këtij lloj peshkimi i cili nënkupton peshkimin me qëllim të përfitimit ekonomik.

Peshkimi sportiv – rekreativ është i organizuar nëpërmjet Federatës së Peshkatarëve e cila e bënë kontrollin nëpërmjet 14 shoqatave lokale të peshkatarëve.

Dukuri shqetësuese paraqet peshkimi ilegal. Kjo veprimtari shpeshherë bëhet gjatë periudhës së riprodhimit të peshqve, gjë qe është në kundërshtim me Ligjin e Peshkatarisë dhe Akuakultures.

Aktualisht në Kosovë prodhohen rreth 500 deri 600 ton peshk të llojit trofta e Kalifornisë (Oncorhnchus mykiss)

Janë gjithsej 13 ferma për kultivimin e troftës dhe një e krapit. Kjo do të thotë që afërsisht përdoren rreth 600 ton ushqim i pasur me proteina

Gjithashtu prodhohen edhe rreth 40 ton krap, që është ndotës me i vogël për shkak të llojit të ushqimit të përdorur (drithëra).

Fondi i kafshëve shtëpiake

Fondi i kafshëve në Kosovë ka shënuar rritje të ndjeshme gjatë viteve. Sipas të dhënave nga Departamenti i Blegtorisë i MBPZHR, numër më të madh të kafshëve përbejnë gjedhët dhe shpezët, ndërsa më të vogël kuajt dhe dhitë.

Sipas të dhënave të regjistrimit të përgjithshëm të blegtorisë të bërë gjatë vitit 2004, vetëm 2 % e numrit të përgjithshëm të gjedhëve i takojnë fermave të specializuara, çka do të thotë se numri më i madh i tyre është i shpërndarë në ekonomitë shtëpiake (fermat e vogla). Numri mesatar i gjedhëve për ekonomit shtëpiake është 1.12 krerë për ferma të vogla dhe15 krerë për ferma të mëdha. Numri mesatar i lopëve qumështore për ekonomi shtëpiake është 1.57 në ferma të vogla, respektivisht 8.5 në ferma të mëdha [28].

Tabela 16: Fondi Blegtoral [29]

Llojet e kafshëve	Numri i krerëve
Gjedhë	256.007
Dele	120.102
Dhi	13.154
Derra	48.000
Kuaj	5.672
Pula - Ferma komerciale	493.900
Shpeze-ekonomi shtëpiake	1.500.000
Koshere bletësh	43.000

Fermat në Kosovë janë kryesisht të vogla dhe gjysmë komerciale. Sipas regjistrimit të bërë në vitin 2005, në Kosovë ka 171.179 ferma. Rreth 80% e fermave janë më të vogla se 5 ha[30]. Kjo nënkupton se zhvillimi i bujqësisë është në shkallë të vogël.

28 ESK-Kosova në shifra 2005

29 MBPZHR-Departamenti i Blegtorisë

30 ESK-Kosova në shifra 2005

Korniza Ligjore dhe Institucionale

Korniza ligjore

Ligj bazë për zonat e mbrojtura dhe biodiversitetin në Kosovës është Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (2006/22) dhe të gjitha udhëzimet që dalin nga ky ligj. Gjithashtu një numër i veprimtarive në natyrë është e rregulluar edhe me ligje të tjera.

Kuvendi i Kosovës deri me sot ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e natyrës dhe ato që ndërlidhen me veprimtaritë në natyrë.

- Ligji për Mbrojtjen e Natyrës (2006/22)
- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (2003/9)
- Ligji për Ujërat e Kosovës (2004/41)
- Ligji për Planifikimin Hapësinor (2003/30)
- Ligji i Parkut Nacional "Mali i Sharrit" (1986)
- Ligji për Pyjet e Kosovës (2003/6),(2004/40)
- Ligji për Gjuetinë (2006/41)
- Ligji për Peshkatari dhe Akuakulturë (2006/58)

Aktet e tjera nënligjore të rëndësishme janë:

- Udhëzimi Administrativ: Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr.09/2004-MMPH)
- Udhëzimi Administrativ: Për Formën dhe Mënyrën e Mbajtjes së Regjistrit Qendror të Zonave të Mbrojtura të Natyrës (Nr.04/2006-MMPH, datë shtator 2006)
- Udhëzimi Administrativ: Për Mënyrën e Shënimit të Zonave të Mbrojtura të Natyrës (Nr.01/07-MMPH , datë dhjetor 2006)
- Udhëzimi Administrativ: Për Planet e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura të Natyrës. Nr 11/07 02/11/2007
- Udhëzimi Administrativ: Për Kriteret dhe Procedurat për Shfrytëzimin e Shpellave.(është në procedim)
- Udhëzimi Administrativ: Për Dhënien e Lejes Ekologjike (Nr.26/05-MMPH, datë 07.11.2005)
- Udhëzimi Administrativ: Për Licencimin e Personave dhe Ndërmarrjeve për Hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (Nr.03/2004-MMPH)
- Udhëzimi Administrativ: Për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Ujore dhe Masat e tyre të Mbrojtjes për Burimet e Ujit që Përdoren për Pije (Nr.13/07-MMPH)
- Udhëzimi Administrativ : Për Zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Mbi Elementet Themelore të Përmbajtjes së Planeve Hapësinore për Zona të Veçanta (Nr.2005/42-MMPH, datë 04.03.2005)
- Vendimet për zonat e mbrojtura (gjithsej ekzistojnë 75 vendime për shpalljen nën mbrojtje ligjore)

Strategjia dhe Plani i Veprimit për Mjedisin

Në qershor të vitit 2004, Qeveria e Kosovës e ka miratuar Strategjinë e Kosovës për Mjedisin (SKM). Objektivat afatgjata për një mjedis të pastër dhe të shëndoshë në Kosovë të dala nga kjo strategji janë:

- Zvogëlimi gradual i ndotjes, degradimit dhe dëmit mjedisor, si dhe minimizimi ose ndalimi i atyre veprimtarive ekonomike dhe të tjera, që përbëjnë një rrezik për shëndetin e njeriut dhe mjedisin;
- Mbrojtja e biodiversitetit dhe përmes saj ruajtja e barazpeshës së përgjithshme ekologjike në Kosovë;
- Shfrytëzimi racional dhe i qëndrueshëm i resurseve natyrore dhe tokës prodhuese,
- Mbrojtja e peizazheve të vlefshme natyrore para së gjithash atyre më reprezentative dhe më të rëndësishme, si: parqet nacionale, monumentet e natyrës etj.

Në mbështetje të këtij dokumenti dhe detyrimeve që dalin nga Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit gjatë vitit 2006 është hartuar edhe Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis 2006 - 2010.

Objektiva kryesore e këtij plani sa i përket mbrojtjes së natyrës është: " Krijimi i një sistemi më efikas ligjor dhe institucional për ruajtjen e biodiversitetit dhe trashëgimisë natyrore, si dhe futja nën mbrojtje e 10% e territorit të Kosovës".

Për arritjen e kësaj objektive përveç të tjerash në kuadër të planit të veprimit për mjedis janë përgatitë disa projekte. Deri më sot asnjë nga këto projekte nuk ka filluar të realizohet.

Po ashtu edhe Ministria e Bujqësisë ka përgatitë Strategjinë e Menaxhimit me Kafshë të Egra.

Tabela 17. Projektet për natyrën nga PKVM

Titulli i projektit	Bartësi i projektit	Koha e propozuar për fillimin e projektit	Kohëzgjatja e propozuar	Shuma e propozuar (€)
Digjitalizimi dhe përtrirja e listave të zonave dhe vendeve ekzistuese të mbrojtura dhe zonave të reja që do të mbrohen në Kosovë.	MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës	2007	18 muaj	**53,800**
Sajimi i një Liste të Kuqe dhe Libri të Kuq të të dhënave për llojet e rrezikuara në territorin e Kosovë	MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës	2007	2 vite	**60,810**
Përgatitja e Strategjisë në nivel të Kosovës për mbrojtjen e llojllojshmërisë biologjike dhe ngritja e vetëdijes së opinionit për këtë qëllim	MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës	2007	15 muaj	**106,000**
Evidentimi (shënimet e detajuara) për florën dhe faunën në Bjeshkët e Nemuna	MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës	2007	2 vite	**126,750**
Evidentimi i florës dhe faunës në Malet e Sharrit	MMPH – Instituti për Mbrojtjen e Natyrës	2006	2 vite	126,750

Institucionet për Mbrojtjen e Natyrës

Kuvendi i Kosovës

Organi më i lartë ligjvënës në Kosovë i përbërë nga 120 deputetë. Në kuadër të Kuvendit vepron Komisioni funksional për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor i cili në vitin 2005 fuzionohet me komisionin për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural me 15 anëtarë. Kuvendi miraton ligjin për mbrojtjen e natyrës, shpallë parqet nacionale, miraton strategjinë e mbrojtjes së natyrës etj

Qeveria e Kosovës e përbërë nga 14 ministri[31] në kuadër të të cilës është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

31 Rreg.2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë , me ndryshimet me Rreg. 2002/5 mbi ndarjen e Ministrisë dhe Planifikimit Hapësinor .

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ndër të tjera është përgjegjëse që "të krijojë politikën, të zbatojë ligjet dhe të mbikëqyr aktivitetet për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe resurset e ujit, ajrin, tokën, bioiversitetin".

Në kuadër të MMPH-së është edhe Drejtoria e Parkut Nacional "Mali Sharr", e cila merret me menaxhimin e territorit të parkut nacional.

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë të tij e bën Ministria përmes inspektorit të mbrojtjes së natyrës në kuadër të Inspektoratit Mjedisor.

Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit

AKMM-ja është themeluar në vitin 2003, pas miratimit të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit[32] nga Kuvendi i Kosovës. Në kuadër të Agjencisë përfshihen: Instituti i Mbrojtjes së Natyrës së Kosovës(IMNK) dhe Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK). Detyrat e Agjencisë janë monitorimi i mjedisit, informimi i publikut dhe institucioneve vendore, por edhe ndërkombëtare për gjendjen e mjedisit në Kosovë, si dhe projekte kërkimore e shkencore nga fusha e mjedisit.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Është themeluar në vitin 1974 me emrin Enti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Instituti i kryen punët profesionale për mbrojtjen e natyrës të Kosovën në kuadër të AKMM-së. [33]. Punët profesionale të IKMN-së janë:

a. mbledhja dhe përpunimi i shënimeve lidhur me mbrojtjen e natyrës;

b. hartimi i bazave të caktuara për llojet e bimëve, shtazëve, kërpudhave, habitateve,ekosistemeve dhe peizazheve;

c. monitorimi e gjendjes të larmisë biologjike dhe peijzazhore dhe propozimi i masave për mbrojtjen e natyrës'

d. kryerja e analizave statistikore, përmbledhja e rezultateve dhe hartimi i raporteve për gjendjen e mbrojtjes së natyrës;

e. zbatimi i akteve ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, harton politikat për bujqësinë, pylltarinë, gjuetinë, peshkatarinë,etj

Agjencioni Pyjor i Kosovës

APK-ja është përgjegjëse për çështjet e ndërlidhura me rregullimin e pyjeve dhe tokave pyjore, administrimin dhe menaxhimin e tokave pyjore publike dhe pyjeve në Parqet Nacionale në Kosovë, përveç atyre çështjeve që ligji në mënyrë të veçantë i cakton ndonjë autoriteti tjetër të Qeverisë.

Muzeu i Kosovës- seksioni i natyrës në kuadër të saj ruan trashëgiminë natyrore të Kosovës.

32 Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit 2003/9

33 Neni 9.2. Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.2006/22

Kuvendet Komunale, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë dhe Planin e Veprimit dhe dokumentet për planifikim hapësinor detyrohen[34] që: të kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peijzazhore në territorin e vet, të shpallin zonat e mbrojtura që janë kompetencë e tyre, të sigurojnë kushtet për mbrojtjen dhe ruajtjen e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre, të marrin pjesë në hartimin e planeve për menaxhimin e zonave të mbrojtura që janë në kompetencën e tyre, të informojnë publikun për gjendjen e natyrës në territorin e tyre dhe masat e ndërmarra për mbrojtjen dhe ruajtjen e saj etj

Institucionet Shkencore

Akademia e Shkencave të Kosovës dhe Universiteti i Prishtinës, merren me kërkime dhe hulumtime shkencore në lëmin e natyrës dhe biodiversitetit.

Organizatat e Shoqërisë Civile Mjedisore

Sipas vlerësimeve të fundit të bëra në vitin 2006, del së në Kosovë aktive janë 30 OJQ mjedisore të regjistruara. Këto OJQ vijnë nga 15 komuna të Kosovës sa i përket shtrirjes, ndërsa më së shumti janë aktive në Prishtinë (6), Pejë (5) në Mitrovicë (3). Nga kjo del së në gjysmën e Komunave të Kosovës nuk ka fare OJQ- mjedisore të regjistruara.

Edhe përkundër numrit të konsideruar të OJQ mjedisore asnjë prej tyre nuk e ka programin e vet të orientuar vetëm për mbrojtjen e natyrës dhe biodivërsitetit.

34 Neni 10 i LMN 2006/22

Problemet dhe Rekomandimet

Problemet

- Mungesa e ligjeve të mjaftueshme për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e ligjit për parqe nacionale;
- Transpozimi i pjesshëm i Direktivave të BE-së në ligjet tona;
- Mungesa e strategjisë dhe planit të veprimit për natyrën dhe biodiversitetin;
- Definimi jo i qartë i kompetencave sipas ligjeve;
- Mungesa e institucioneve të mjaftueshme për natyrën;
- Struktura e pamjaftueshme komunale;
- Mungesa e organeve menaxhuese për zonat e mbrojtura;
- Mungesa e planeve hapësinore për zonat e mbrojtura;
- Implementimi jo i kënaqshëm i ligjeve ekzistuese;
- Definimi jo i qartë i kompetencave të organeve menaxhuese;
- Shfrytëzim i pa pakontrolluar i resurseve natyrore;
- Prerje ilegale të pyjeve;
- Mungesë e iniciativave dhe projekteve për shfrytëzimin e resurseve të ripërtritshme;
- Fragmentimi i eksositemeve dhe habitateve si pasojë e zgjerimit të vendbanimeve dhe infrastrukturës;
- Ndërhyrjet në zonat e mbrojtura;
- Numri i vogël i projekteve në lëmin e mbrojtjes së natyrës;
- Mungesa e inventarit të plotë për florën, faunën dhe habitatet;
- Numër i vogël i hulumtimeve shkencore për biodiversitetin;
- Buxheti i pamjaftueshëm për natyrën;
- Mungesa e një fondi të mjaftueshëm për ruajtjen e natyrës;
- Mungesa e mekanizmave për thithjen e fondeve ndërkombëtare;
- Mungese e programeve monitoruese për biodiversitetin;
- Numri i vogël i broshurave informative;
- Përfshirja e vogël e publikut në debate për çështje të natyrës;
- Mungesa e zyrave informative në zonat e mbrojtura;
- Mungesa e programeve shkollore për natyrën në institucionet arsimore të Kosovës etj.

Rekomandimet

- Zbatimi i ligjit për mbrojtjen e natyrës
- Transpozimi Direktivave të BE-se në ligjin për mbrojtjen e natyrës;
- Hulumtimi, inventarizimi i llojeve dhe habitateve;
- Lista e Kuqe e florës dhe faunës;
- Inventarizimi dhe digjitalizimi i zonave të mbrojtura;
- Vendosja e sistemit kontroll për tregtinë me lloje;
- Shpallja e "Bjeshkëve të Nemuna" Park Nacional;
- Përkrahja e projekteve ndërkufitare për mbrojtjen e natyrës;
- Përgatitja e planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e mbrojtura të natyrës;
- Marrja nen mbrojtje ligjore të shpellës së Gadimes nga qeveria dhe hulumtimi shpellave të tjera;
- Hartimi i një projekti afatgjatë për bifurkacionin e lumit Nerodime, marrja nën mbrojtje ligjore e rezervatit nga Qeveria e Kosovës dhe caktimi i një organi menaxhues,
- Hartimi i programeve dhe projekteve për ngritjen e vetëdijes dhe sensibilizimit për mbrojtjen e natyrës
- Themelimi i zyrës koordinuese për identifikimin, ratifikimin dhe implementimin e konventave dhe marrëveshjeve te tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës.
- Eliminimi i përzierjes se kompetencave ndërinstitucionale dhe ndërshtetërore në Parkun Nacional "Malet e Sharrit".
- Themelimi i organizatave menaxhuese për zonat e rëndësishme;
- Harmonizimi dhe kategorizimi i zonave te mbrojtura sipas ligjit të natyrës

Referencat

1. Arkivi i IKMN-së (-2004): Raportet, Dokumentet dhe aktvendimet për zonat e mbrojtura,
2. IKMN,(2003)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Klinës,
3. IKMN,(2003) Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Gjilanit;
4. IKMN,(2003)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Malishevës
5. IKMN,(2003)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Gjakovës,
6. IKMN,(2003)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Skenderajt
7. IKMN,(2003) Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Rahovecit
8. IKMN,(2004)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Drenasit,
9. IKMN,(2004)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Istogut,
10. IKMN,(2004)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Podujevës
11. IKMN,(2004)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Mitrovicës
12. IKMN,(2005)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Obiliqit
13. IKMN,(2005)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Vushtrrisë,
14. IKMN,(2005)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Vitisë
15. IKMN,(2006)Raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Fushë Kosovës
16. IKMN, (2006) raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Lipjanit,
17. IKMN, (2007) raport i njohjes dhe evidentimit të vlerave të natyrës në territorin e Komunës së Shtimes
18. IKMN, (2005) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Istogut,
19. IKMN, (2005) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Drenasit,

20. IKMN, (2005) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Malishevës,
21. IKMN, (2006) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Podujevës,
22. IKMN, (2006) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Obiliqit,
23. IKMN, (2006)Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Skenderajt,
24. IKMN, (2006) Studimi i arsyeshmërisë për shpalljen e zonave te mbrojtura në territorin e Komunës së Klinës , EKMN (1982): Arsyeshmëria shoqërore e shpalljes së pjesës së Malit Sharr në Kosovë për Park Nacional,Prishtinë,
25. EKMN (1985): Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së një pjese të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, Prishtinë.
26. EKMN (1975): Natyra e Kosovës, publikim për Bjeshkët e Nemuna, Enti për Mbrojtjen e Natyrës së Kosovës, Prishtinë.
27. Grup autorësh (1995): Gjeografia e Kosovës 8, Enti i Teksteve dhe I Mjeteve Mësimore i Kosovës, Prishtinë,
28. IKMN (2005), Vlerat e trashëgimisë natyrore të Kosovës,
29. MTI. Regjioni turistik i Bjeshkëve të Nemuna, 2007, Prishtinë, Broshurë
30. Veselaj, Z., Sherifi, Y. (2001): Llojet e rralla bimore dhe shtazore të Kosovës, publikim Ekoklina &IMNMK, Prishtinë,
31. Blecic, V., Krasniqi, F. (1971): Zajednica endemicnog sibljaka forzicije i krtusca (Polygalo –Forsythietum europaea) u Jugozapadnoj Srbiji. Glas. Repub. Zav. Zas. Prir. Muz., Titograd.
32. Blecic, V., Tatic, B., Krasniqi, F. (1969): Tri endemicne Zajednice na serpentinskoj podlozi u Srbiji. ActaBot. Croat. XXVIII: 43 – 47, Zagreb.
33. Hundozi, B. (1987): Salvio – Scorsoneretum villosae. Bul. Pun. Sh. I FSHMN, Prishtinë.
34. Krasniqi, E. (2003): Flora vaskulare e rajonit të Mirushës, Punim i magjistraturës, UP, FSHMN, Prishtinë.
35. Millaku, F. (1999): Flora subalpike dhe alpine e Alpeve Shqiptare (Kosovë), disertacion I doktoratures UP- FSHMN, Prishtinë
36. Mustafa,B., Hoxha, E. Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë 2003.
37. Rexhepi, F. & Krasniqi, E. (2004): Real Condition of stenoendemic species Aristolochia merxmuelleri Greuter et E. Mayer 1985 after NATO bombing in Kosovo ëar of 1999, Hacquetia 3/1, Ljubljana
38. Rexhepi, F. (1983): Subalpska I alpska flora, vegetacija Osljaka I problemi njene zastite, Novi Sad.
39. Rexhepi, F. (1985/86): Flora e Lubotenit (Malet e Sharrit – Kosovë), Natyra e Kosovës, Prishtinë.
40. Rexhepi, F. (1986): Flora e Maleve të larta të Kosovës, ETMMK, Prishtinë.

41. Rexhepi, F. (1994): Vegjetacioni I Kosovës (1), UP, FSHMN, Prishtinë.
42. R.Pllana, Karakteristikat Hidroklimatike të shpellës së Gadimes dhe mundësia e lidhjeve hidrogjeologjike me lumin Gadime, Natyra e Kosovës, Prishtinë 1981
43. Sherifi, Y., Mustafa,B. (2002):Disa veçori të faunës së Malit Sharr, Studime Gjeografike, Nr. 14. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë,
44. R. Pllana, G. Gashi, F. Bajraktari, S. Behrami, Hidrologig Heritage in the System of Natural Values and its Protection in Kosova, Ballvois, Ohër, 2006
45. Shoqata e Ekologëve të Kosovës (2002): Biodiversiteti i Gërmisë, vlerat dhe rreziqet që e kërcënojnë, publikim, Prishtinë
46. Sherifi, Y., Mustafa,B. (2004): Vështrim i shkurtër i faunës së Bjeshkëve të Nemuna (Alpeve Lindore shqiptare), Studime Gjeografike, Nr. 15. Akademia e shkencave dhe Arteve të Shqipërisë
47. Ligji për mbrojtjen e natyrës (2005/02-L18) Rreg. nr. 2006/22 të datës 24.04.2006
48. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Rreg. 2003/9 (2003):
49. Vendimi per ndarjen e seksionit për mbrojtjen e natyres (“GZK”. 42/74)
50. Ligji për themelimin e Entit Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës (“GZK”. 15/81)
51. Ligji per ligjin për Mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe të vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut (“GZK” 39/88*)*
52. Ligjin për Entin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit (“GZK”nr. 38/89)
53. Ligji për Parkun Nacional “Mali Sharr” GZK. 11/86, Kuvendi i Kosovës, Prishtinë,
54. P.Pllana, Vpruthi. Raporti për shpellat në Kosovë, 2003

RAPORT I GJENDJES SË NATYRËS
2006- 2007

Botues:
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit
Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës

Raportin e përgatitën:
Ylber Sherifi, shef i sektorit për mbrojtjen e natyrës
Afrim Berisha, shef i sektorit për raporte dhe progr.mjedisore
Qenan Maxhuni, zyrtar për biodiversitet
Fadil Bajraktari, zyrtar për zona të mbrojtura

Këshilli redaktues:
Ylber Sherifi,
Sabit Restelica,
Rizah Hajdari,
Tomor Qela

Lektor:
Tone Buzhala-Gashi

Dizajni:
Design house

Ballina:
Ylber Sherifi
Foto nga Faqja e parë dhe e fundit, Parku Nacional "Mali Sharr"

U shtyp në shtypshkronjën:
Design house

® Ndalohet shumëzimi dhe ribotimi i paautorizuar

Katalogimi në botim- (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës